

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 84-të i botimit
Mars 2016/ Nr. 3



Kryeministri Rama:
Me SHBA-në nuk
na ndan asgjë,
na bashkon gjithçka

Vizita në Tiranë

John Kerry: "Unë jam këtu sepse ne jemi miq"

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut
dhe Shtëpive të Pushimit.

Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 84-të i botimit
Nr. 3/ 2016

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfuturi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Përmbajtja

Numri 3

MINISTERIALI

- 16** Kodheli: "Jemi të angazhuar për mbrojtje moderne"

INTEGRIMI

- 18** Sfidat e NATO-s dhe BE-së për Ballkanin Perëndimor

"DITË E HAPUR NË QBO":

- 24** QBO strukturë e rëndësishme e modernizimit të FA

INTERVISTA

- 25** Qendra e Bashkuar Operacionale, pika nevrologjike e komandimit të FA

GATA-ANKARA:

- 28** Aty ku diplomohen mjekët ushtarakë shqiptarë

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Albert ZHOLI
Saimir ALIJA

Redaktore korrektore:
Anila DODA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ



4 VIZITA

John Kerry: "Unë jam këtu sepse ne jemi miq"

Mirëmëngjesi të gjithëve ju, dhe shumë, shumë faleminderit Z. Kryeministër. Është një mundësi shumë e veçantë...



7 KRYEMINISTRI RAMA:

Me SHBA-në nuk na ndan asgjë, na bashkon gjithçka

Kjo vizitë e Sekretarit të Shtetit John Kerry e nis më së miri celebrimin e 25 vjetorit të rivendosjes së marrëdhënieve...



9 SHQIPËRI-SHBA

Në krah të SHBA-ve në misionet ushtarake ndërkombëtare

Vizita në vendin tonë e Sekretarit Amerikan të Shtetit, John Kerry, me 14 shkurt 2016, ishte një vizitë...



20 INTERVISTA

Në ruajtjen e hapësirës detare shqiptare

Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të...

Vizita në Tiranë

Sekretari i Shtetit të
SHBA-ve John Kerry
me Kryeministrin
Edi Rama



**John Kerry: “Unë jam
këtu sepse ne jemi miq”**



Deklarata e Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve John Kerry pas Takimit me Kryeministrin Shqiptar Edi Rama (Tiranë, 14 shkurt 2016)

Mirëmengjesi të gjithëve ju, dhe shumë, shumë faleminderit Z. Kryeministër. Është një mundësi shumë e veçantë të jem sot këtu me ju. Ne të dy jemi takuar edhe më parë. Unë e kam çmuar udhëheqjen tuaj. E vlerësoj shumë kreativitetin tuaj. Dhe jam shumë mirënjohës ndaj mikpritjes së ngrohtë që është kaq e dukshme dhe kaq e prekshme sot në Tiranë, në Shqipëri. Jam gjithashtu shumë mirënjohës që gjetët kohën, së bashku me Ministrin Bushati dhe kabinetin tuaj, për të ndarë me ne të gjitha mendimet tuaja për të cilat ju folët në deklaratën tuaj gjithëpërfshirëse. Presidenti Obama dhe unë dhe populli amerikan jemi shumë mirënjohës për udhëheqjen që ju po ofroni dhe për përpjekjet e ekipit tuaj, jo vetëm në të mirën e Shqipërisë dhe interesave të saj, por edhe në përqafimin e disa vlerave që na përkufizojnë të gjithë ne dhe unë vërtet mendoj se janë baza e miqësisë që Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria ndajnë së bashku.

Unë jam këtu sepse ne jemi miq. Unë dua ta theksoj këtë. Ne jemi aleatë. Ne kemi interesa të mëdha të përbashkëta dhe kemi përshkruar një rrugë shumë interesante dhe të veçantë në marrëdhënien tonë diplomatike, e cila, ashtu siç Kryeministri ia kujtoi të gjithëve, pas një muaji do të festojë 25 vjetorin e saj. Mendoj se mund t'ju them, ashtu si Ambasadori ynë këtu Donald Lu më tha, marrëdhënia jonë është shumë e shëndetshme dhe shumë, shumë e ngrohtë, dhe ne të gjithë jemi shumë mirënjohës për këtë gjë.

Unë e dëgjova me vëmendje Kryeministrin sot në mëngjes, dhe mendoj se ai ngriti çështje të rëndësishme dhe hapi mundësi për Shtetet e Bashkuara dhe Shqipërinë që të punojnë akoma edhe më shumë së bashku. Ne po jetojmë një kohë që mbart një sfidë shumë të madhe globale. Shqipëria i ka kuptuar këto sfida dhe udhëheqja juaj ka qënë shumë e rëndësishme në ndihmën që i ka dhënë Shteteve të Bashkuara dhe shteteve të tjera që të luftojnë këtë provë që kemi përpara: këtë luftë kundër terrorizmit ekstrem, këtë përpjekje për të shtrembëruar një besim të madh dhe për ta përdorur, në shumë raste, për qëllime të këqija që nuk kanë fare të bëjnë me asnjë besim që ekziston



“Shqipëria duhet të jetë e sigurtë në miqësinë dhe mbështetjen e plotë të popullit të Shteteve të Bashkuara dhe qeverisë tone”.

në këtë planet.

Në këtë kuadër, unë sapo jam kthyer nga Mynihu, ku u përqëndruam në përpjekjet në Lindjen e Mesme dhe nevojën për t'u përballur dhe për të mundur grupin terrorist DAESH. Dhe sigurisht që pati shumë diskutime, siç e dimë të gjithë, mbi pasojat e kësaj lufte, si po pasqyrohet në Siri dhe ndikimin e emigrimit në të gjithë rajonin. Ne e dimë se DAESH nuk do të mundet vetëm sepse një vend e kërkon këtë. Kjo kërkon një koalicion të gjerë, dhe ne e kemi ndërtuar këtë koalicion. Dhe them me krenari dhe mirënjohje që Shqipëria është pjesë e këtij koalicioni. Shqipëria ka qënë me ne qysh në fillim, e gatshme për t'u rreshtuar krah të gjitha vendeve që janë kundër DAESH. Dhe është gjithashtu krah nesh në mbështetje të Irakut. Është krah nesh në mbështetje të Afganistanit. Dhe po qëndron krah nesh në sfidën afatgjatë për t'u treguar njerëzve rëndësinë e tolerancës, për të marginalizuar ekstremet e dhunshme, për të kuptuar se është e rëndësishme që të gjithë ne të ndërtojmë shoqëri dhe komunitete në të cilat ju mbase nuk do të jeni dakord me të gjithë, por jeni tolerantë ndaj ideve të tyre, gjithnjë nëse ato respektojnë ligjin dhe rregullat ndërkombëtare të mirësjelljes dhe sjelljes njerëzore.

Shqipëria nuk është thjesht një mike apo thjesht një vend që ka treguar në kaq shumë mënyra një dashuri të veçantë për Shtetet e Bashkuara, por Shqipëria është edhe një aleate e NATO-s, dhe kjo sjell për të përgjegjësi të veçanta në këtë rajon. Dhe ne jemi mirënjohës për anëtarësimin dhe partneritetin e Shqipërisë në këtë aleancë.

Gjatë mbledhjes tonë sot, Kryeministri, Ministri i Jashtëm dhe unë patëm mundësinë për të shqyrtuar zhvillimin e rëndësishëm të Shqipërisë - hapat e vërtetë që Shqipëria po merr bën drejt marrjes së përgjegjësisë të plota në këtë aleancë dhe në këtë miqësi, ashtu si edhe për të arritur gjërat që do të arrijë dhe që ka përqafuar, në mënyrë që të integrohet akoma më thellë shumë në institucionet Euro-Atlantike.

Faktet janë shumë të qarta dhe Shqipëria duhet të jetë shumë e kënaqur me faktin që vendi juaj po ecën në drejtimin e duhur. Juve

jeni në rrugën e duhur dhe unë kam shumë besim se me ndërgjegjësimin që është përqafuar në legjislacionin tuaj ndaj luftës kundër korrupsionit, unë jam shumë, shumë i kënaqur, ashtu si të gjithë janë, që reformat tuaja kanë marrë rrugë. Jam per-

Shqipëria nuk është thjesht një mike apo thjesht një vend që ka treguar në kaq shumë mënyra një dashuri të veçantë për Shtetet e Bashkuara, por Shqipëria është edhe një aleate e NATO-s, dhe kjo sjell për të përgjegjësi të veçanta në këtë rajon. Dhe ne jemi mirënjohës për anëtarësimin dhe partneritetin e Shqipërisë në këtë aleancë.

sonalisht i kënaqur, shumë madje, nga paketa e reformës në drejtësi që po shqyrtohet tani, me synimin për të përmirësuar sistemin gjyqësor dhe për të pasur më shumë mundësi për të mposhtur korrupsionin.

Dhe dua të nënvizoj se kjo është diçka që udhëheqja juaj po përqafon, që ata po punojnë fort për t'ia arritur qëllimit. Dhe ata janë të përkushtuar, për këtë jam i bindur, ndaj luftës për një qeveri më të përgjegjshme, dhe kjo kërkon mbështetjen e çdo qytetari shqiptar. Shtetet e Bashkuara janë absolutisht të gatshëm dhe të vullnetshëm, dhe unë jam këtu për ta pohuar edhe në emër të Presidentit Obama, se ne jemi me ju në këtë ndryshim dhe në këtë rrugëtim.

Por në fund të fundit, vetëm shqiptarët mund t'i bëjnë këto ligje - ligjet e duhura - dhe të këmbëngulin në zbatimin e dobishëm të tyre. Unë e di këtë nga eksperiencia vetjake. Ndava me Kryeministrin rrugëtimin tim si një prokuror i ri i shtetit të Massachusettsit në Amerikë, dhe e di se është e vështirë që të kapësh ata që janë të kënaqur me procesin e shmangies së përgjegjësisë që kanë ndaj një vendi të tërë dhe që përfshihen në veprimtari korrup-

tive. Por sado e vështirë që të jetë, unë jam i bindur se kryeministri dhe qeveria po ecin drejt një rruge e cila do të garantojë që e ardhmja e Shqipërisë të jetë ajo që do ta çojë drejt partneritetit të plotë me Europën dhe pjesën tjetër të botës, drejt një rruge zhvillimi me mundësi më të mira për të gjithë popullin shqiptar.

Njerëzit e këtij vendi e dinë shumë mirë dhe ata duan që të jetojnë në një vend ku respekti ndaj ligjit do të thotë vërtet këtë gjë: është respekt ndaj ligjit që gjykatësit dhe prokurorët duhet t'u binden të njëjtave rregulla ashtu si edhe ai qytetari i thjeshtë në çdo rrugë të vendit, dhe se çdokush duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht se cila parti politike është në pushtet, kujt partie i përket apo çfarë bindjesh politike ka. Dua të theksoj se Shqipëria ka ecur shumë gjatë çerek shekullit të fundit. Dhe, ashtu si mund të dëshmojnë edhe njerëzit në vendin tim, është një punë e vështirë. Nuk është e lehtë të ndërtosh një demokraci të fortë, madje është vërtet një punë që kërkon dekada kohë. Dhe sinjerisht, kjo punë nuk përfundon kurrë. Ne jemi ende duke punuar për ta bërë demokracinë tonë sa më perfekte. Edhe ne kemi sfidat tona. Gjëja më e rëndësishme është që të flasësh për to hapur, dhe që të punosh në mënyra konkrete për të zgjidhur shqetësimet e njerëzve. Shqipëria ka pasur një zhvillim të rëndësishëm dhe është qartësisht e angazhuar - nuk ka asnjë dyshim për këtë - për të arritur akoma më shumë. Dhe në këtë rrugëtim, Shqipëria duhet të jetë e sigurtë në miqësinë dhe mbështetjen e plotë të popullit të Shteteve të Bashkuara dhe qeverisë tone. Dua të them se kam shumë miq me origjinë shqiptare në Amerikë, të cilët gjithnjë më kanë thënë "duhet të shkosh në Shqipëri. Duhet të vizitosh Shqipërinë." Më vjen keq që është një vizitë kaq e shkurtër. Duhet të kthehem dhe do të vij, por ju premtoj këtë: Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria vetëm do ta rrisin dhe forcojnë këtë marrëdhënie të veçantë që kemi sot. Ju falenderoj, Z. Kryeministër, për mikpritjen e ngrohtë dhe zemërgjerë që më bëtë gjatë vizitës sime të parë në Shqipëri.

Faleminderit".

Kryeministri Rama: Me SHBA-në nuk na ndan asgjë, na bashkon gjithçka

Deklarata e
Kryeministrit
Edi Rama
pas takimit
me Sekretarin
e Shtetit të
SHBA-ve John
Kerry (Tiranë,
14 shkurt
2016)

Kjo vizitë e Sekretarit të Shtetit John Kerry e nis më së miri celebrimin e 25 vjetorit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara. Ky fakt e bën të dyfishtë kënaqësinë time për praninë e sotme të Sekretarit mes nesh.

Ne shqiptarët, ndajmë me Shtetet e Bashkuara një histori të re marrëdhëniesh, shumë të ngushta, të cilat në prill të vitit të kaluar njohën një zhvillim të ri, përmes nënshkrimit në Washington të dokumentit të Deklaratës së Partneritetit Strategjik. Ky dokument, ka përcaktuar më së miri piketat për zgjerimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë në 10 vjeçarim e ardhshëm, në fushën e sigurisë, energjisë, sundimit të ligjit dhe mirëqeverisjes, me një theks të posaçëm në fushën e ekonomisë.

Ne ndajmë plotësisht me Sekretarin Kerry, mendimin se zhvillimi i mëtejshëm i partneritetit strategjik midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara do të luaj një rol kyç në rritjen e sigurisë së të gjithë hapësirës së Europës Adriatike. Në Europën e sfidave dhe dilemave të sotme, rajoni ynë ka një rëndësi të veçantë gjeostrategjike dhe shqiptarët janë një faktor kyç brenda tij. Është

e vetëkuptueshme se lidhja jonë speciale me Shtetet e Bashkuara na jep një besueshmëri dhe një përgjegjësi të posaçme në promovimin e paqes, rritjen e sigurisë dhe forcimin e demokracisë në këtë pjesë të Europës.

Prandaj, por natyrisht, jo vetëm për këtë, shqiptarët që të gjithë u janë besnikërisht mirënjohës Shteteve të Bashkuara. Pa Shtetet e Bashkuara në krah, gjatë gjithë këtyre 25 viteve të jashtëzakonshme për historinë e vendit tonë, as Shqipëria dhe as shqiptarët në tërësi nuk do të ishin sot më të respektuar, se kurrë më parë në historinë e tyre. Po ashtu, pa mbështetjen dhe këshillat e çmuara të Shteteve të Bashkuara, Shqipëria nuk do të kishte bërë as në dy vitet e fundit kaq shumë progres në rrugën e reformave.

Ishte kënaqësi, por dhe krenari për mua sot, që ta informoja nga afër Sekretarin e Shtetit për përpjekjen e vështirë, por edhe shumë shpresëdhënëse, në frontin e gjerë të reformave modernizuese. Për rezultatet inkurajuese në luftën kundër krimit dhe drogës, për rimëkëmbjen e sektorit energjetik, për rritjen ekonomike dhe goditjen e informalitetit, e kështu me radhë. Diskutuam në veçanti për reformën në drejtësi. Një reformë kyç për qëndrueshmërinë edhe rezultatet e



çdo reforme tjetër dhe ecurinë në çdo fushë tjetër.

U jemi mirënjohës Shteteve të Bashkuara për ndihmën e çmuar që i kanë dhënë vendit tonë në rrugën e kësaj reforme, që nga dita e parë e fillimit të përpjekjeve, si dhe konkretisht për punën e palodhur të ekspertëve amerikanë, krah për krah me ekspertët europianë dhe shqiptarë, në ekipin teknik të reformës. Objektivi ynë i përbashkët, edhe për shkak të implikimeve të drejtpërdrejta që ecuria e reformës ka në procesin e integritetit europian, është që marsi të jetë muaji i votimit në Kuvend të paketës së ndryshimeve kushtetuese. Kam shumë besim se do t'ia dalim dhe fakti që nuk jemi vetëm, por me Shtetet e Bashkuara në krah, e bën krejtësisht të arsyeshëm optimizmin për sukses, në këtë ndërmarrje historike për Shqipërinë e shekullit të XXI. Si miq, partnerë dhe aleatë të ngushtë, ne kemi punuar, jemi duke punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë ngushtësisht me NATO-n, Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Me Shtetet e Bashkuara nuk na ndan asgjë dhe na bashkon gjithçka.

Trupat tona do të vazhdojnë misionin e tyre në Afganistan, përkrah atyre amerikane, e do të qëndrojnë aty sëbashku me aleatin tonë të madh deri kur të jetë e nevojshme. Me Sekretarin e Shtetit biseduam natyrisht edhe në lidhje me kërcënimin terrorist, dhe thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ekstremizmit të dhunshëm, edhe si pjesë e koalicionit botëror kundër ISIS. E informova Sekretarin për masat e fundit që ka marrë Shqipëria në këtë drejtim, për forcimin e kuadrit ligjor, për punën e agjencive ligjzbatuese, për miratimin së fundmi dhe fillimin e zbatimit të strategjisë kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për bashkëpunimin rajonal në këtë kuadër. Po ashtu, pata kënaqësinë të ndaj me Sekretarin e Shtetit progresin e bërë në muajt që e kanë pasuar takimin me Presidentin Obama në Kombet e Bashkuara, lidhur me idenë tonë të programit të ri shkollor për njohjen e fesë. Kam bindjen se ky program do të jetë një sukses i përbashkët që

do të sjellë progres të rëndësishëm, në aspektin më themelor të luftës ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, që është lufta për mendjet dhe për zemrat e gjeneratës së re.

Biseduam për bashkëpunimin dypalësh në fushën e zhvillimit ekonomik. Nga ana jonë kemi konstatuar me kënaqësi një rritje të interesit të kompanive amerikane ndaj Shqipërisë dhe do të mbështesim fuqimisht shtimin e pranisë së tyre në vendin tonë. Një prej pikave të



bisedës ishte siguria energjetike. E informova Sekretarin e Shtetit për ecurinë shumë pozitive të projektit tonë të ndërveprimit rajonal në këtë fushë dhe rolin që Shqipëria është gati të luajë, si një pikë ndërlidhëse këtu në Ballkan me tregun europian të energjisë, në veçanti nëpërmjet gazsjellësit Trans-Adriatik. Po ashtu, edhe për rëndësinë e veçantë që ne i japim shtrirjes së linjës së gazit, lart në korridorin Adriatiko-Jonian, si një domosdoshmëri strategjike, për integritetin rajonal, në kuadrin më të gjerë të integritetit europian dhe euroatlantik.

Jemi tejet të kënaqur që Mali i Zi është ftuar më në fund për tu anëtarësuar në NATO. Dëshirojmë shumë të njëjtin gjë edhe për Maqedoninë. Prandaj urojmë që Maqedonia të çlirohet sa më shpejt nga ngërçi që e mban bllokuar në rrugën e saj drejt NATO-s, e në ndërkohë të plotësojë çdo detyrim të saj lidhur me Marrëveshjen e Ohrit. Ndërsa

Kosova dhe Serbia do të vazhdojnë dialogun e tyre për të shkuar drejt normalizimit. Nuk është një dialog i lehtë, aq më pak është i lehtë implementimi i gjërave për të cilat bihet dakord gjatë dialogut. Por është pa diskutim e vetmja rrugë drejt suksesit për secilin dhe për rajonin në tërësi.

Ne do ta intensifikojmë bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara për konsolidimin e zhvillimit demokratik, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet fqinje, si një parakusht i sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit rajonal.

Në këtë kontekst, Kosova do të vijojë të ketë mbështetjen e dy aleatëve të saj më të ngushtë, Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara. Edhe për këtë kapitull jemi optimist dhe me plot arsye, flas për rajonin. Edhe vetë kriza e refugjatëve ka nxjerrë në pah një ndërveprim të përforcuar të BE me vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky moment, vlen për të kuptuar që të gjithë, se sa e rëndësishme është që kjo pjesë e Europës, të jetë brenda Europës dhe që integrimi Europian i vendeve tona të mos shihet si rutinë, në vazhden e një rruge që për Europën sot është më e komplikuar dhe me sfida shumë më të vështira.

Së fundmi, në rajonin tonë, rrjeti i bashkëpunimit nuk ka qenë asnjëherë më aktiv. Nismat më të reja në këtë drejtim do të jenë Fondi i Ballkanit Perëndimor dhe Zyra e Bashkëpunimit Rajonal të të Rinjve që do ta kenë selinë këtu në Tiranë.

Tirana ka ambicien të jetë gjithnjë e më shumë zëri i paqes, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në çdo plan, pa asnjë përjashtim të natyrës politike, etnike, fetare, kulturore.

Shumë faleminderit zoti Sekretar i Shtetit!

Nëpërmjet jush një falënderim i posaçëm për presidentin Obama, për angazhimin tuaj dhe kontributin aktiv, jo vetëm në funksion të paqes dhe stabilitetit në këtë kënd të Europës, por mbështetjen dashamirëse për Shqipërinë, për shqiptarët, çka e bën shumë më të plotë rolin tonë dinamik dhe konstruktiv në Ballkanin Perëndimor.

Edhe një herë, faleminderit i dashur Sekretar!"

Në krah të SHBA-ve në misionet ushtarake ndërkombëtare

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli komenton vizitën në Tiranë të Sekretarit Amerikan të Shtetit, John Kerry.

Vizita në vendin tonë e Sekretarit Amerikan të Shtetit, John Kerry, me 14 shkurt 2016, ishte një vizitë historike, për faktin e pozitës lider që ka shteti amerikan në botë, për vetë marrëdhëniet historike të shqipërisë me ameriken dhe rolin që ka luajtur Amerika për shtetformimin dhe për kombin shqiptar që në fillim të shekullit 20-të e deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. E pranishme në takim zyrtar, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli ka komentuar për televizionin Top Channel, vizitën e Sekretarit amerikan të Shtetit në Shqipëri. Ministrja e Mbrojtjes e cilësoi vizitën e Sekretarit amerikan, John Kerry si tejet pozitive për sigurinë në vend, po ashtu edhe në rajon. Ajo tha se Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, ka bërë më të mirën në luftën ndaj terrorizmit, ndërsa shtoi se vendi ynë do ta rrisë prezencën ushtarake në Afganistan.

Duke i bërë një bilanc vizitës së Sekretarit Kerry, çfarë solli ajo në raportet Shqipëri-SHBA?

Vizita është më shumë se sa pozitive. Në fakt, ajo nuk sjell vetëm risi në marrëdhëniet SHBA-Shqipëri, por është diçka pozitive për sigurinë në vend, rajonin dhe më shumë se kaq. Këtë Sekretari Kerry e transmetoi në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet konferencës së tij për shtyp, aq më shumë e transmetoi nëpërmjet bashkëbisedimit që pati me Kryeministrin Rama dhe të gjithë pjesën tjetër të delegacionit.

Lufta e përbashkët ndaj terrorizmit dhe ISIS ishte një nga çështjet kryesore që u diskutuan sot. Si do të vazhdojë partneriteti në këtë drejtim dhe çfarë i kërkohet Shqipërisë?

Shqipëria është vendi i parë që i është përgjigjur koalicionit kundër terrorizmit, vendi i parë nga të gjitha vendet anëtare në NATO. Katër donacione kanë qenë më shumë se sa të rëndësishme për qeverinë Peshmerga në luftën kundër terrorizmit në një zonë të nxehtë. Nuk ka qenë vetëm kjo ngjarje pjesë e falenderimit, pasi Shqipëria është prezente me trupat e saj edhe në Afganistan, ku me shumë mundësi do ta rrisim prezencën në Bagdad, ashtu siç bisedohet se do ta rrisim prezencën edhe në misione të tjera të NATO-s. Nga Sekretari Kerry kemi marrë falenderime dhe superlativa, të cilat realisht i kemi merituar sepse djemtë tanë kanë bërë më të mirën.

Kryeministri Rama theksoi pas takimit me Sekretarin Kerry se Shqipëria do të vijojë të qëndrojë deri në fund krah SHBA-ve në misionet ushtarake ndërkombëtare. Si ministre e Mbrojtjes ç'mund të na thoni më shumë për këto misione?

NATO do të vazhdojë të jetë gjatë në Afganistan. Po ashtu, NATO do të jetë gjatë edhe me misionet e trajnimit në Irak. NATO do të vazhdojë të jetë prezente edhe në Mesdhe, për shkak të problemeve që ka me refugjatët. Dhe sigurisht që do të vazhdojë prezente përgjatë të gjithë kufirit lindor me Rusinë. Kjo e angazhon Shqipërinë në forcën e armatosur të saj, ashtu siç angazhon të gjitha vendet në NATO për më shumë trajnime, për më shumë misione dhe më shumë operacione, për më shumë impenjim. Ndaj edhe Sekretari Kerry ka qenë më shumë se i drejtpërdrejtë kur ka kërkuar se shpenzimet për Forcën e Armatosur, për mbrojtjen dhe sigurinë, duhet të rriten sepse vetë situata gjeopolitike e sigurisë është në pikëpyetje të madhe.





SHBA vlerëson kontributin tonë kundër shtetit islamik

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli gjithashtu zhvilloi një takim në kuadër të Konferencës së 52-të të Sigurisë në Mynih të Gjermanisë, me asistentsekretaren e Mbrojtjes të SHBA-ve për Çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare, Elissa Slotkin. Ministrja Kodheli e falënderoi asistent sekretaren për mbështetjen e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Forcave të Armatosura shqiptare. Asistent sekretarja e Mbrojtjes amerikane, znj. Elissa Slotkin, ritheksoi rëndësinë që qeveria amerikane i ka dhënë dhurimit të pajisjeve ushtarake që Shqipëria ka bërë për peshmergat në luftën kundër të ashtuquajturit shtet islamik. Gjatë punimeve të Konferencës së 52-të të Sigurisë në Mynih, znj. Kodheli zhvilloi një takim të veçantë pune e dhe me ministren e Mbrojtjes të Italisë, znj. Roberta Pinotti. Të dy autoritetet theksuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit mes forcave të armatosura.

Asistent sekretarja e Mbrojtjes amerikane, znj. Elissa Slotkin, ritheksoi rëndësinë që qeveria amerikane i ka dhënë dhurimit të pajisjeve ushtarake që Shqipëria ka bërë për peshmergat në luftën kundër të ashtuquajturit shtet islamik.

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli mori pjesë në Konferencën e 52-të të Sigurisë në Mynih të Gjermanisë. Lufta në Siri, katastrofa me emigrantët dhe kriza e sigurisë evropiane ishin çështjet kryesore në axhendën e kësaj konference, e cila ka nisur më 12 shkurt dhe i mbylli punimet më 14 shkurt. Në këtë conference morën pjesë personalitete botërore si, sekretari amerikan i Shtetit John Kerry, homologu i tij rus, Sergey Lavrov, ministri i Mbrojtjes i Rusisë, Sergey Shoygu, ministri i Mbrojtjes i Britanisë, Mi-



Konferenca e 52-të e Sigurisë në Mynih:

Michael Fallon: Forcat britanike dhe ato shqiptare, stërvitje në territorin shqiptar

Michael Fallon, ai i Francës Jean-Yves Le Drian, italisë si dhe përfaqësues të qeverisë gjermane. Konferenca e 52-të e Sigurisë në Mynih u zhvillua



në drejtimin e ambasadorit gjerman Wolfgang Ischinger.

Forume të tilla të nivelit më të lartë ndërkombëtar janë një mundësi shumë e mirë për takime të homologëve me njëri tjetrin për të biseduar e parashtruar marrëdhëniet reciproke midis vendeve partnere, por edhe si diskutim i problemeve grobale të sugurose që janë primare për kohën e sotme.

Në këtë kontekst Ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, gjatë punimeve të Konferencës së 52-të të Sigurisë në Mynih të Gjermanisë ka zhvilluar më 13 shkurt 2016, disa takime dypalëshe me homologë dhe personalitete të njohur. Kështu, ajo zhvilloi një

takim me sekretarin britanik të Mbrojtjes, Michael Fallon. Gjatë këtij takimi dy homologët diskutuan për marrëdhëniet dypalëshe dhe projektet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes. Ministria Kodheli vlerësoi maksimalisht mbështetjen që Britania e Madhe jep në edukimin dhe trajnimin e ushtarakëve shqiptarë. Sekretari britanik i Mbrojtjes Fallon i konfirmoi ministres Kodheli që Forcat e Armatosura britanike do të vijojnë me stërvitje të përbashkëta në territorin shqiptar. Stërvitja "Albanian Lion" do të zhvillohet në vjeshtën e këtij viti dhe do t'i shërbejë rritjes së ndërveprueshmërisë mes dy forcave tona të armatosura.



SHBA-Shqipëri: Janë përcaktuar piketat për 10-vjeçarin e ardhshëm

Qeveria shqiptare ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e refugjatëve sirianë që mund të zgjedhin vendin tonë si trajektore për të shkuar drejt Europës. Ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli ishte më 22 shkurt 2016, në Komisionin e Sigurisë Kombëtare në Kuvend në një seancë dëgjimore lidhur me çështjet e takimit ministrave të Mbrojtjes së NATO-s dhe vendimin për marrjen e masave ndaj refugjatëve në Mesdheun Lindor nga Gjermania, Greqia dhe Turqia. Temë e seancës dëgjimore ku ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo e drejtori i Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes z. Igli Hasanaj, ishin edhe vizita e sekretarit amerikan të Shtetit z. John Kerry, mesazhet e dhëna lidhur me çështjet e sigurisë ku Shqipëria është e angazhuar, si dhe situata e sigurisë në rajon dhe projeksioni i Shqipërisë përballë rreziqeve që vijnë nga jugu dhe lindja.

Duke diskutuar mbi takimin e ministrave të Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s, ministria Kodheli

foli për vendimet më të rëndësishme të mara në këtë takim. "Vendimi kryesor i marrë gjatë Ministerialit ishte zhvendosja e Grupit të Gatshëm Detar 2 të NATO në Detin Egje, ku do të ndihmojë Greqinë, Turqinë dhe Bashkimin Evropian me trafikun e mijëra refugjatëve që vijnë nga lindja e Aleancës. Në ministerial u ra dakord gjithashtu me rritjen e prezencës dhe gatishmërisë së forcave të Aleancës, shtimin e policimit ajror në Turqi, shtimin e pranisë detare në Detin e Zi dhe atë Mesdhe si dhe forcimin e mbrojtjes ajrore të Turqisë", tha znj. Kodheli, e cila nuk la pa përmendur kontributin e vendit tonë në Aleancë. "Shqipëria po merr pjesë në Task-Forcën e Bashkuar të Gatishmërisë Shumë të Lartë me një kompani këmbësorie çdo vit. Ky kontribut, vlerësohet nga NATO si mjaft i rëndësishëm duke pasur parasysh madhësinë e Forcave tona të Armatosura, por dhe krahasuar me vende të rajonit. Ne gjithashtu kemi marrë vendim për të shtuar kontributin edhe me një togë tjetër këmbësorie në Afganistan, kësaj radhe me aleatët italianë, duke vazhduar angazhimin e nisur që në vitin 2002." - tha ajo.

Vizitën në Tiranë të sekretarit amerikan të Shtetit z. John Kerry, ministria Kodheli e cilësoi si një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet mes dy vendeve. "SHBA dhe Shqipëria kanë nënshkruar një dokument të partneritetit strategjik. Ky dokument, ka përcaktuar më së miri piketat për zgjerimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë në 10 - vjeçarin e ardhshëm.

Shqipëria ka qenë vendi i parë që iu përgjigj thirrjes së SHBA-ve për ndihmë ushtarake ndaj peshmergave kurdë, në luftë kundër të ashtuquajturit Shtet Islamik. Katër donacionet e bëra nga Forcat e Armatosura me armatim lindor, kanë bërë të mundur kthimin e fatit të betejës së Mosulit në gusht-shtatorin e 2014, deklaroi ministria Kodheli, e cila shtoi edhe reformën në drejtësi si një nder temat e diskutuara me sekretarin Kerry. Deputetët e komisionit të Sigurisë kërkuan informacion nga ministria Kodheli lidhur me refugjatët dhe masat e marra nga qeveria shqiptare në rast se fluksi i tyre kalon nga vendi ynë. Ministria Kodheli bëri me dije anëtarët e këtij komisioni se qeveria ka marrë masat e para. "Grupi i punës i përbërë nga ministrinë e linjës nën drejtimin e zëvendëskryeministrit ka bërë një inventarizim të mundësive tona nëse fluksi i refugjatëve kalon nga Shqipëria, që në të gjitha rastet" vijoi Kodheli "do të shërbejë vetëm si vend tranzit." Ministria bëri me dije se ka komunikuar lidhur me këtë temë me komisionerin e BE-së për Migracionin, Punët e Brendshme dhe Shtetësinë, z. Dimitris Avramopoulos, si dhe me homologët e saj italian, malazezë, maqedonas, kroat etj. Kryetari i komisionit, z. Spartak Braho, vlerësoi pozitivisht përgjigjen e Ministres Kodheli për të informuar dhe raportuar në komision e sigurisë, si një proces i domosdoshëm. "Në emër të Komisionit të Sigurisë ne do të jemi palë e punës, reformës të të gjitha institucioneve që mbulon ky komision", tha Braho.



Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli e ftuar në Konferencën e Sigurisë në Mynih në intervistë me DW flet mbi sfidën e terrorizmit dhe politikën shqiptare të mirëpritjes së refugjatëve, në rast të ardhjes nga Maqedonia.

Rreziku nga terrorizmi i të ashtuquajturit “Shteti Islamik” është temë qendrore e Konferencës së Sigurisë në Mynih. A mund të jetë Shqipëria e rrezikuar nga “Shteti Islamik”?

Shqipëria është vend anëtar i NATO-s dhe çdo vend i NATO-s mund të jetë dhe është i rrezikuar nga ky kërcënim, si çdo vend që punon, lufton për vlera pozitive dhe i mbron ato mund të jetë rrezik për një strukturë që nuk ka aspak të bëjë me atë që pretendon së është në mbështetje të fesë islame, ajo është thjesht dhe vetëm një barbari.

Në Shqipëri ka pasur fushata rekrutimi dhe të rekrutuar prej të ashtuquajturit “Shteti Islamik”. A ka rrezik që të shtohet numri i pasuesve shqiptarë të një ideologjie të tillë dhe a ndërmerrni ju diçka kundër këtij fenomeni?

Për fat të keq edhe trevat shqiptare janë pjesë e kësaj historie dhe krahasuar me numrin e popullsisë dhe duke u perceptuar Shqipëria dhe trevat ku banojnë shqiptarë si një popullsi me shumicë myslimane, numri nuk është problematik, nëse hedhim një sy tek numri i luftëtarëve të huaj në vende si Anglia apo Franca. Por kjo nuk do të thotë të mos e kemi nën vëmendjen tonë këtë fenomen. Fenomeni nuk është rritje, por edhe ai numër ekzistues përbën shqetësim e duhet të mbahet nën kontroll e të ndalohej. Kjo kërkon impenjimin e strukturave që merren me sigurinë, por edhe impenjimin politik të qeverisë shqiptare, si edhe të qeverive të tjera, qoftë e Kosovës,



Shqipëria e interesuar për më shumë siguri në ujrat e saj detare

Intervistë e znj. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes dhënë për Deutsche Welle, 13 shkurt 2016

Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës me qëllim të mbajtjes nën kontroll e reduktimit të këtij numri. Problemi nuk është vetëm sa shkojnë, problem përbëjnë ata që kthehen, me çfarë aktiviteti merren, mënyra si rekrutohen adoleshentët, dhe se sa institucionet fetare të fesë mys-

limane punojnë në drejtimin e duhur dhe jo të gabuar.

Ka aktivitete të përbashkëta rajonale për të ndaluar fenomenin e rekrutimit për të ashtuquajturin “Shteti Islamik”?

Strukturat e sigurisë bash-

këpunojnë dhe ndajnë informacionet e duhura, vetëm një bashkërendim i mirë i punëve mund të sjellë sukses në luftimin e këtij fenomeni, por mund të them se bashkëpunimi, sidomos shkëmbimi i informacionit midis vendeve anëtare të NATO-s, apo mes vendeve të rajonit bën të mundur që ky fenomen të përballet. I ashtuquajtur "Shtet Islamik" nuk është ndarë e organizuar si një shtet, ata veprojnë të organizuar mbi një bazë ideologjike, që nuk ka të bëjë me fenë së cilës i përkasin, por që ndërkohë mund të dëmtojë këdo që i vihet kundër.

Një ndër temat e lidhura me këtë është edhe ajo e refugjatëve, temë kryesore në këtë konferencë. Vitin e kaluar Shqipëria ishte një vend burim i emigracionit, tani problemi është tejkaluar, por flitet se mund të kthehet tani në vendkalim refugjatësh, nëse mbyllet kufiri i Maqedonisë. A ka Shqipëria ndonjë plan për ta përballuar apo parandaluar këtë?

Po, Shqipëria ka qenë burim emigrantësh ekonomikë, njerëz që kërkojnë një treg më të madh pune, jetë më të mirë, dhe nuk duhet harruar se Gjermania në vit ka rreth 200.000 emigrantë ekonomikë polakë, e askërkush nuk flet për emigracion polak, se shihet një lëvizje normale aty ku tregu i punës ofron më shumë. Por për të mos u kthyer në problem, sepse pas sirianëve ishin shqiptarët të cituarit si numri më i madh prezent i emigrantëve, kemi marrë masa drastike për të kontrolluar përpara se shqiptarët të dalin nga kufijtë. Nga ana tjetër duhet të punojmë fort që reformat tona të japin fryte, të krijojmë vende pune, në mënyrë që tendenca për t'u larguar nga vendi të jetë në ulje.

Por çdo të bëni nëse përballeni me një fluks refugjatësh?

Shqipëria është e tillë e pozicionuar që lehtë mund të bëhet vend kalimi. Sigurisht përveç faktit që duhet të kesh para dhe logjistike për të përballuar fluksin e refugjatëve,

duhet të kesh politika të drejta për të mos e konsideruar fundin e botës këtë, por për ta parë si një tragjedi biblike, tek e cila duhet të japësh rol pozitiv. Kujtoj luftën e Kosovës, kur në Shqipëri erdhën rreth 1 milionë kosovarë, kur Shqipëria vetë është rreth 2,8 milionë banorë e kjo nuk e bëri Shqipërinë as më të traumatizuar, as më të varfër e as më me probleme, por e ngriti lart imazhin e saj. Njerëzit që ikin nga terrori në shtëpitë e tyre janë të mirëpritur në një vend si Shqipëria, pavarësisht se ne jemi të sigurt se ata nuk duan të qëndrojnë në Shqipëri, por të shkojnë në vende më të zhvilluara. Sigurisht ka një problem logjistik, sepse Shqipëria është vend me rrugë të vogla, sigurisht do të jetë vetëm një vend tranzit. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me fqinjët tanë italianë, maqedonas e kroatë, po ashtu kemi marrë masat tona logjistike nëse ata do duan të kalojnë përmes Shqipërisë.

A mund të thoni konkretisht se çfarë masash janë marrë?

Ne kemi ngritur një grup pune të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë e Transportit, si edhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, emegjenca civile, shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, pra një grup pune që ka bërë përgatitje teorike për të mundësuar kalimin tranzit të refugjatëve të mundshëm.

Në konferencën e NATO-s, të premten (12.02) u fol për kontributin e NATO-s për të rregulluar, kontrolluar apo ndalur fluksin e refugjatëve. Cili do të jetë roli i Shqipërisë?

MINISTRJA KODHELI:

Njerëzit që ikin nga terrori në shtëpitë e tyre janë të mirëpritur në një vend si Shqipëria, pavarësisht se ne jemi të sigurt se ata nuk duan të qëndrojnë në Shqipëri, por të shkojnë në vende më të zhvilluara. Sigurisht ka një problem logjistik, sepse Shqipëria është vend me rrugë të vogla, sigurisht do të jetë vetëm një vend tranzit.

Përgjithësisht ky do të jetë një operacion që ka të bëjë me detin dhe ajrin. Besoj se për momentin nuk do të jetë e nevojshme që Shqipëria të marrë pjesë direkt, sepse ende nuk janë përcaktuar të gjitha praktikat e procedurat nga strukturat e caktuara. Por si vend mesdhetar, Shqipëria është e interesuar në mënyrë të drejtpërdrejtë që të mundësojë një siguri më të madhe në ujërat e detet tona. Kemi kërkuar dhe po shohim bashkëpunimin me misionin Frontex të BE-së.

Shqipëria ka paralajmëruar se do të ofrojë në treg avionët MIG të trashëguar nga komunizmi, a ka interes për këtë?

Shqipëria ka ende mjete fluturuese të vjetra, siç janë avionët MIG, kjo është publike dhe intriguese për një detaj shumë të thjeshtë teknik. Që nga emërimi im si Ministre e Mbrojtjes të gjitha ankadet, qofshin edhe ato për produkte ushtarake janë ankande të hapura. Shqipëria ka shitur edhe më parë, por procedurat kanë qenë të mbyllura. Janë përgjithësisht avionët të dhuruar në vitet 50-të apo 60-të nga rusët apo kinezët.

A janë të interesuar rusët apo kinezët për ta si elementë muzealë?

Ankandi do të jetë i hapur, ne na intereson të pastrojmë tunelet tona që nuk i hyjnë në punë askërkujt, përkundrazi na kushtojnë sepse na duhet t'i mirëmbajmë e interesi ynë është të shtojmë buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

**Deutsche Welle:
13 shkurt 2016**

Sfidat e NATO-s dhe BE-së për Ballkanin Perëndimor



NGA MIMI KODHELI

Ndaj me ju shqetësimin e përbashkët që rrjedh për shkak të situatës jo fort komode të sigurisë. Kur them shqetësimin e përbashkët kjo s'ka të bëjë vetëm me Ballkanin Perëndimor, por ka të bëjë me një shqetësim mbarë botëror, i cili vazhdon të jetë në rritje për shkak të gjithë ngjarjeve dhe situatave aspak të këndshme, madje shpeshherë brutale që ndodhin përrreth nesh dhe sidomos në kufijtë jugore dhe lindore të vendeve të NATO-s dhe të Europës në përgjithësi. Por cilat janë sfidat e NATO-s dhe BE-së kur vjen fjala për Ballkanin Perëndimor? Ku jemi ne? Cila është sfida jonë për të integruar përfundimisht këtë copë të vogël në hartën botërore por që mbart me

vete një pjesë të rëndësishme të historisë, sidomos 100-vjeçarin e fundit?

Sigurisht që ne mund t'i tregojmë botës dhe mund t'i flasim për shumë vlera shpirtërore, filozofike, kulturore, historike, por ndërkohë po aq shumë i kemi treguar botës se dimë edhe ta gjakosim token tonë. Sigurisht nga kjo zonë, nga kjo qoshe e botës kanë filluar dy luftëra botërore. Ndaj shpresoj dhe besoj fort që ne dimë të nxjerrim mësim nga eksperiencia jonë në person të parë, ashtu siç bashkërisht besoj që do të mundohemi të realizojmë detyrat tona të vëna mbi tryezë, me besimin tonë se qoftë NATO qoftë BE, e ka një plan të mirëpërcaktuar për të ardhmen e vendeve tona.

Unë jam plotësisht dakord me Hashimin kur thotë që nëse ne do të lëmë njolla gri në këtë qoshe të botës ku jetojmë, do të kemi shumë

shpejt në mos e kemi prezencën e fuqive të tjera keqdashëse në raport me të ardhmen e popujve tanë dhe të sigurisë. Ballkani Perëndimor sot ka një tendencë, influencë dhe të ardhme totalisht perëndimore, por kjo dëshirë për të qenë pjesë e perëndimit jo e lindjes, për të qenë jo në zgrip, jo në kufi, por thjesht dhe vetëm për të qenë pjesë e perëndimit të zhvilluar, e demokracive të zhvilluara, e tregjeve të zhvilluara, e vlerave pozitive humane të besimit, nuk i rrinë mirë një kryeqyteti si Moska, e cila ka dashuri të vjetra të lidhura me këtë rajon, dhe aq më pak i vjen mirë një shteti të quajtur islamik, i cili tregon çdo ditë e më tepër radikalizmin e tij nëpërmjet barbarisë që ne shikojmë çdo ditë.

Ndaj unë besoj fort se përtej fazave të ndryshme në të cilat ndodhen vendet e Ballkanit Perëndimor, aspirata dhe rruga që duhet ndjekur apo është ndjekur është ekzaktësisht e njëjtë, thjesht dhe vetëm duhet të jemi bashkë në këtë rrugë. T'i tregojmë njëri - tjetrit si i kemi bërë detyrat e shtëpisë, në rastin e Shqipërisë, si ajo ka mundësuar anëtarësimin në NATO para 6 vjetësh, apo eksperiencën pozitive të Kroacisë dhe Sllovenisë, dy vende që janë në BE dhe NATO.

Apo të tregojmë punën e jashtëzakonshme dhe mbështetjen e madhe që ne i dhamë Malit të Zi duke qenë pjesë dhe zë i fuqishëm i politikës së dyerve të hapura NATO. Për shkak se Mali i Zi i ka bërë detyrat e shtëpisë dhe për shkak të mbështetjes së Shqipërisë dhe Kosovës dhe vendeve të tjera padyshim, Mali i Zi mori ft-

(vijon në fq. 19)

Shqipëria dhe Kroacia-rol kyç për balancat rajonale

Gjatë qëndrimit në Bruksel në kuadër të Ministerialit të Mbrojtjes, ministrja e mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zhvilloi takime me homologë. Kështu në takimin me ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë z. Josip Buljević, znj. Kodheli e uroi për marrjen e detyrës së re dhe shprehu vendosmërinë e vendit tonë për të vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyer me Kroacinë, në fushën e mbrojtjes dhe më gjerë. "Shqipëria dhe Kroacia janë dy vende kyçe për ruajtjen e balancave në rajon dhe si rrjedhojë ne jemi të angazhuar për të mbështetur kontributet tona të përbashkëta në operacione dhe misione, si ai në Afganistan", tha znj. Kodheli. Nga ana e tij, ministri Buljević e falenderoi ministren Kodheli për këtë takim dhe siguroi se Kroacia është e interesuar për të vijuar trendin pozitiv të bashkëpunimit, midis vendeve tona. Gjithashtu, dy ministrat diskutuan mbi ambientin e ri të krijuar të sigurisë dhe implikimet që ajo ka për rajonin e Ballkanit Perëndimor, forcimin e iniciativave rajonale, mbështetjen për vendet e rajonit në rrugën Euro-Atlantike, përfshirë Kosovën, etj.

Në takimin me homologun e saj rumun, znj. Kodheli, e uroi gjithashtu z. Mihnea Motoc për marrjen e detyrës si ministër i Mbrojtjes i Rumanisë dhe nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të Shqipërisë me Rumaninë. "Jemi të interesuar të forcojmë nivelin e angazhimit midis ministrave të Mbrojtjes respektive dhe Forcave të Armatosura,"- tha ajo.

Ministri rumun u shpreh i kënaqur për mbajtjen e këtij takimi, gjatë punimeve të Ministerialit të Mbrojtjes dhe falenderoi ministren Kodheli për kontributin që Shqipëria jep me dy oficerë shtabi në strukturat e krijuara së fundmi në Rumani, në kuadër të Planit të Veprimit të Gatishmërisë. Në fund, ministrat ndanë të njëjtin mendim mbi sfidat dhe rreziqet në rritje për drejtimin jugor të NATO-s, si terrorizmi, migracioni, luftëtarët e huaj terroristë, etj.



Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli mori pjesë më 10 shkurt 2016, në punimet në Ministerialit të Mbrojtjes, që u zhvillua në Bruksel, ku u trajtuan dhe u morën vendime mbi forcimin e mbrojtjes kolektive të NATO-s. Gjatë kësaj dite, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s, diskutuan veçanërisht mbi parimet bazë të ndërtimit të konceptit të ri të NATO-s për frenimin e rreziqeve dhe mbrojtjen. Gjithashtu u bë dhe një përditësim mbi implementimin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë (RAP) të NATO-s, si dhe u shpërnda një informacion njohës mbi investimet e Mbrojtjes. "Shqipëria mbetet e angazhuar për të dhënë kontributin e vet në ndërtimin e një mbrojtjeje moderne dhe efikase të NATO-s, për të luftuar rreziqet ak-



NATO: Ministeriali i ministrave
të Mbrojtjes në Bruksel

Kodheli: “Jemi të angazhuar për mbrojtje moderne”

tuale dhe ato të ardhshme. Në pritje të zhvillimit të Samitit të Varshavës, duhet të synojmë një qasje të re për mbrojtjen e Aleancës, ku një nga shtyllat më të rëndësishme mbetet zbatimi i Planit të Veprimit për Gatishmërinë”, nënvizoi ministria Kodheli në ndërhyrjen e saj në këtë

pikë, e cila solli në vëmendje rritjen e Buxhetit të Mbrojtjes për vitin 2016 si një tregues pozitiv për vendin tonë dhe që mbështet vendimet e marra në Samitin e Uellsit. “Këto para do të përdoren në mënyrë efikase, në veçanti për rritjen e kapaciteteve dhe modernizimit të Forcave të

Armatosura”, tha znj. Kodheli. Në mbyllje, ajo nënvizoi se vendi ynë do të vijojë të luajë një rol aktiv në Aleancë duke mbështetur kontributet në kuadër të Planit të Veprimit të Gatishmërisë, mbajtjen e niveleve të larta të plotësimit të pozicioneve në strukturën komanduese të NATO-s dhe forcës së saj, rritjen e bashkëpunimit ndërqeveritar për përgatitjen e emergjencave civile, zhvillimin e kapaciteteve, në harmoni me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s (NDPP) etj.

Gjithashtu ministrat e Mbrojtjes, në praninë e përfaqësuesve të Bashkimit European dhe një grupi partnerësh (Enhanced Opportunity Partners) Australi, Finlandë, Gjeorgji, Jordani dhe Suedi, u adresua mënyra dhe mjetet e nevojshme për të rritur ndërveprimin ndërmjet NATO-s dhe partnerëve të saj. Në këtë drejtim, ministrat ndanë të njëjtin mendim mbi sfidat e sigurisë dhe kërkuar më shumë kujdes për rreziqet komplekse që burojnë nga drejtimi jugor i NATO-s. Së fundmi, partnerët u shprehën të gatshëm për të rritur bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët, ku u përmend lufta hibride si dhe paketat e ndërtimit të kapaciteteve të mbrojtjes për vendet në nevojë.

Në fjalën e saj, ministria e Mbrojtjes, u ndal në mundësitë e mëdha për një bashkëpunim në rritje, me grupin e larmishëm të partnerëve të NATO-s. Si element kryesor, ajo theksoi shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës mbi luftën hibride, si dhe angazhimin në mbështetjen e vendeve të

Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, me paketa individuale për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes. “Shqipëria është e gatshme të japë kontributin e vet për iniciativë të reja, siç po bën aktualisht në disa vende të tjera partnere si Gjeorgjia dhe Ukraina”, - mbylli fjalën e saj znj. Kodheli.



Të gatshëm për personel shtesë në Afganistan

Në ditën e dytë të punimeve të Ministerialit në Bruksel, më 11 shkurt 2016, ministrat e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s adresuan elementë të rëndësishëm, që kontribuojnë në rritjen e gatishmërisë dhe aftësisë ripërtëritëse të Aleancës. Ministrat u njohën me ecurinë e punës në zhvillimin e disa kapaciteteve kyçe si mbrojtja kibernetike, mbrojtja raketore, adaptimi institucional i NATO-s, lufta hibride, etj. Ministrat e Mbrojtjes deklaruan kapacitetin fill-estar operacional të Inteligjencës së Bashkuar, Rikonicionit dhe Survejimit (JISR) të NATO-s dhe ranë dakord për të ndjekur punën mbi aftësitë ripërtëritëse, si një kontribut për frenimin e rreziqeve dhe mbrojtjes të NATO-s. Në fund të sesionit, disa vende prekën shkurtimisht dhe zhvillimet në Afganistan.

Ministria Kodheli mirëpriti progresin e arritur në zhvillimin e kapaciteteve të NATO-s dhe theksoi se Shqipëria, me një buxhet të mbrojtjes në rritje, mbetet e përkushtuar në zhvillimin e kapac-



iteteve të përbashkëta dhe ato kombëtare, në harmoni me procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s. Ajo shprehu mbështetjen për adresimin e disa elementëve të rëndësishëm si lufta hibride dhe "elasticiteti" i Aleancës për t'iu përshtatur ndryshimeve në ambientin e sigurisë. Ministria Kodheli theksoi

gjithashtu gatishmërinë e vendit tonë edhe për rritjen e numrit të ushtarakëve shqiptarë në misionet ndërkombëtare. "Shqipëria është duke ndjekur me vëmendje situatën në Afganistan dhe mbetet e gatshme të rrisë kontributin me personel shtesë në misionin 'Resolute Support'." - u shpreh znj. Kodheli.

Gjeorgjianë në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Në formatin e komisionit NATO-Gjeorgji, ministri i Mbrojtjes së NATO-s, në prezencën e homologes gjeorgjiane znj. Khidasheli trajtoi implementimin e paketës thelbësore NATO-Gjeorgji, e miratuar në Samitin e Uellsit. Ministria e Mbrojtjes Kodheli, mirëpriti zhvillimin e kësaj seance të dedikuar Gjeorgjisë, duke rikujtuar takimin bilateral që zhvilloi në Tiranë, në muajin dhjetor 2015, me Ministren Khidasheli. "Shqipëria mbështet integritetin territorial të Gjeorgjisë", - tha znj. Kodheli, e cila përgëzoi palën gjeorgjiane për reformat e ndërmarra në fushën e mbrojtjes. Në mbështetje të implementimit të paketës thelbësore NATO-Gjeorgji, Shqipëria do vijojë të ruajë kontributin e vet me një këshilltar të Planëzimit



Strategjik/Operacional në zyrën e ndërtimit të kapaciteteve të mbrojtjes të NATO-s në Tbilisi. Në mbyllje, znj. Kodheli inkurajoi ministren gjeorgjiane për të rritur bashkëpunimin bilateral dhe në këtë drejtim vendi ynë do vazhdojë të mirëpresë personel/studentë gjeorgjianë në Kursin e përvitshëm të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, që zhvillohet pranë Akademisë së Forcave të Armatosura të RSH-së.

(vijon nga fq. 15)

esën për t'u anëtarësuar dhe besoj në Samitin e Varshavës thjesht dhe vetëm do bëhet realitet edhe me letra. Sigurisht rruga jonë për në BE është e gjatë, por nëse ne do kemi bashkë me Europën një plan të mirëpërcaktuar me detyra të mirëpërcaktuara, pa vënë kushte të pamundura siç është në rastin e Kosovës, një kusht që zëvendëskryeministri Thaçi e përmendi drejtpërdrejt, të një marrëveshjeje, e cila jo domosdoshmërisht ekziston edhe mes vendeve të tjera të BE-së, pra të gjejmë "casus belli", të tilla për të justifikuar një gjë që qytetarët e Kosovës e kanë gëzuar dhe merituar kur ishin pjesë e federatës, dhe po këta qytetarë nuk e gëzojnë dhe nuk e meritojnë sot që janë një vend i pavarur, dhe kjo është qesharake.

Kosova ka bërë përparime të jashtëzakonshme, ka shumë detyra përpara për të bërë, por pa dyshim në Kosovë në përgjithësi si në disa treva të Ballkanit Perëndimor. Më lejoni të them se ka disa institucione fetare me axhenda të ndryshme dhe jashtë kontrollit. Institucione të cilat mundësojnë thithjen e njerëzve krejt të rinj në moshë në adoleshencë, mbase dhe më të vegjël, në radhët e disa grupimeve organizmave, njësisive të cilat largohen nga vendi i tyre për të bërë luftën e dikujt tjetër, radikalizohen ndërkohë rrugës pa pasur idenë farë se çfarë janë duke bërë dhe e bëjnë këtë në emër të një zoti i cili i mëson ata ndryshe. Por ja që kjo zonë është edhe burim i këtij fenomeni, i cili duhet luftuar në rrënjë por jo ta përballim vetëm kur e kemi tek dera. Ne akoma nuk dimë pse një qytetar i zakonshëm, normal i ndershëm me principe, një besimtar i mirë madje kthehet nga një qenie humane, në një djall. Dhe për këtë duhet punuar shumë bashkërisht dhe Shqipëria si një vend anëtar në Aleancë ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë fort në këtë drejtim ashtu siç kanë punuar dhe të gjithë vendet anëtare. Pavarësisht nga background-et e ndryshme, pozicionet e ndryshme ku vendet anëtare të NATO-s janë të vendosura, ato ngrihen mbi bazën e disa principeve dhe veprojnë, punojnë planëzojnë mbi bazën e disa gjerave të përbashkëta që i lidhin dhe i bëjnë ata të qëndrueshëm, madje kaq të qëndrueshëm dhe unifikuar, sa deri më sot për fat të mirë nuk ka një forcë tjetër që të përballet me ta.

"Resolute Support": Me të kthyerit nga Afganistani

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, takuan më 9 shkurt 2016, në hollin e Ministrisë së Mbrojtjes ushtarakët e sapokthyer nga misioni i NATO në Afganistan, "Resolute Support". "Ju përgëzoj pafund për vlerësimin dhe përkushtimin tuaj në zbatimin dhe përfaqësimin dinjitoz tuajin individual, por dhe përfaqësimin që i keni bërë Forcave tona të Armatosura", iu drejtua gjeneralmajor Bazo ushtarakëve që morën pjesë në misionin "Resolute Support". Ministria Kodheli duke iu uruar edhe njëherë mirëseardhjen u



shpreh: "Pa rezerva ndihem krenare për përzgjedhjen që kemi bërë, për përkushtimin tuaj, për punën për vlerat që keni treguar dhe që na keni bërë të ndihemi krenarë për vlerësimet që kemi marrë nga komandanti i Komandës

së Resolute Support". Prandaj, u shpreh ministria Kodheli, ju kemi mbledhur sot këtu, për t'u thënë faleminderit që na keni bërë krenarë dhe vazhdoni ta mbani këtë përkushtim dhe përgjegjësi për detyrën dhe transmetojeni atë në komandat, shtabet dhe të kolegët tuaj.

Ndaj bazuar në mbrojtjen e përbashkët, bazuar në bashkëpunimin për sigurinë dhe menaxhimin e krizave. NATO i ka shumë të qarta detyrat e shtëpisë së saj, por njëkohësisht duke qenë i ndryshëm nga BE-ja ka të qartë rrugën sesi vendet do të vinë tek kjo organizatë pa i detyruar.

Unë jam e bindur që në Ballkanin Perëndimor mund të ketë ndonjë vend që nuk ka dëshirë të bëhet vend anëtar i NATO-s. Do të bëhet anëtar i BE-së por jo domosdoshmërisht i NATO-s. Është i lirë të vendosë për këtë gjë vetë, ndërkohë që influenca Euro-Atlantike në Kosovë, në Shqipëri, në Malin e Zi, vazhdon të mbetet e lartë, e fortë, e madhe sepse falë njerëzve që na votojnë, falë qytetarëve tanë, ne akoma besojmë tek këto struktura tek këto organizma dhe vlerat që ata përfaqësojnë. Dy shqetësimet më të mëdha që vinë sot e theksoj janë shqetësime madhore me të cilat ne do duhet të përballemi gjatë. Radikalizmi islamik vazhdon të rritet dhe të jetë shqetësim për të gjithë, ashtu si dhe ndikimi rus në kufi me Ukrainën dhe e gjithë situata në Lindje e Mesme shpeshherë e paqartë

për diplomacinë perëndimore apo diplomacinë botërore në përgjithësi, i ngatërron pak letrat. E bën situatën, mjedisin botëror më të ngarkuar dhe kjo ndoshta na i vonon pak hapat, vendeve si ne në Ballkanin Perëndimor që i kanë të qarta idetë. Unë do të kërkoja dhe do të vazhdoj të kërkoj nga përfaqësuesit më të lartë të BE-së ashtu si dhe të Aleancës, më shumë vëmendje ndaj vendeve që realisht e dëshirojnë këtë gjë, që kanë akoma besim pavarësisht se rruga është bërë e lodhshme edhe shpeshherë lodhja nuk sjell entuziazëm, nuk sjell optimizëm. Por në fund të ditës besoj se shoqëritë tona, ekonomitë tona, demokracia jonë e re dhe e brishtë janë një bazë gjithsesi e mirë për një të ardhme të mirë, thjesht dhe vetëm se kjo qoshe e botës është një qoshe shumë e mirë për të rritur fëmijët. Ka lashtësi, ka histori brenda, ka diell, ka det, ka mal, ka borë, ka njerëz entuziastë ka talente, dhe mbi të gjitha di të mësojë nga gabimet e të tjerëve dhe nga gabimet e veta.

Mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare të Sigurisë "Germia Hill 2016", Prishtinë 2 shkurt 2016.

Intervista

Në ruajtjen e hapësirës detare shqiptare

Intervistë me gjeneralbrigade Ylber Dogjani, komandant i Forcës Detare

MIMOZA GOLIKJA

Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimi i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëveprim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare, është misioni i Forcës Detare. Ajo përgatit dhe vë në dispozicion kapacitetet e saj për përmbushjen e misionit kushtetues, nëpërmjet prezencës në det dhe kryerjes së operacioneve të sigurisë detare, të cilat i kryen më vete, në bashkëpunim me strukturat e FA, aleatët dhe me institucionet e zbatimit të ligjit që kanë interesa në det. Intervistën që po sjellim më poshtë për revistën "Mbrotjtja" e realizuam me komandantin e Forcës Detare, gjeneralbrigade Ylber Dogjani.

Zoti gjeneral, Ju tashmë jeni në krye të detyrës së komandantit të Forcës Detare. Kush janë disa nga problemet me të cilat jeni përballur kur morrët detyrën? A e keni gjetur veten këtu në dhe çfarë prioritetesh keni pasur kur erdhët në drejtim të Forcës Detare?

Të them të vërtetën për periudhën që shërbej në Komandën e Forcës Detare, nuk jam ndeshur me probleme dhe shqetësime serioze. Kjo falë punës së kryer nga paraardhësit e mi, të cilët kanë drejtuar me profesionalizëm këtë strukturë. Gjatë kësaj periudhe, pri-



GJENERALBRIGADE DOGJANI:

Forca Detare ka disa platforma për përgatitjen profesionale të personelit të saj. Njëra prej tyre është Programi vjetor i stërvitjes i cili është i ndarë në dy faza. Faza e parë është përgatitja individuale e efektivave të anijeve sipas specialiteteve dhe faza e dytë është stërvitja në nivel çift dhe grup anijesh.

oritet i punës sime ka qenë njohja me punën dhe arritjet e KFD-së, ndjekja dhe zbatimi i projekteve të parashikuara, si dhe hartimi i një planëzimi sa më real në interes të rritjes së kapaciteteve operacionale të FD-së. Falë dashurisë dhe mikpritjes së treguar nga efektivit i FD-së e kam gjetur veten dhe ndjehem mjaft mirë në ushtrimin e funksionit tim kushtetues në këtë strukturë.

Jemi futur në muajt e parë të vitit 2016. Mendoni se keni përmbyllur me sukses vitin paraardhës 2015? Cilat kanë qenë disa nga realizimet të efektivit të Forcës Detare në përbushjen e misionit kushtetues nën drejtimin tuaj?

Për periudhën 1-vjeçare, Komanda e Forcës Detare, ka mjaft arritje ku ndër më të kryesoret mund të veçoja:

Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë si dhe zbatimi i ligjshmërisë në det, në bashkëveprim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare. Zbatimi i detyrave të parashikuara për Forcën Detare, në Direktivën e Mbrotjtjes 2015. Ndjekja e planeve të implementimit të Objektivave të Kapaciteteve, përbushja e objektivave dhe detyrimeve të parashikuara për integrim, si dhe aplikimi i procedurave standarde të Aleancës në spektrin e fushës së detarisë. Realizimi në kohë i planeve të arsimimit dhe trajnimit të personelit të FD-së. Pjesëmarrja me anije dhe drejtimi me staf të



Stërvitjes Rajonale "ADRION LIVEX-15". Zhvillimi i Stërvitjes Rajonale "ADRION CAX 2015", nën drejtimin e Forcës Detare, për herë të parë në Qendrën e Simulimit të FA-së. Zbatimi i planit të modernizimit të sistemeve dhe pajisjeve kryesore të FD-së. Sigurimi i mbështetjes logjistike të efektivave për krijimin e kushteve sa më optimale për punë, jetesë dhe stërvitje.

Planifikimi i burimeve njerëzore, financiare dhe materiale të FD, me qëllim sigurimin e kapaciteteve të nevojshme operacionale për përbushjen e misionit kushtetues.

Dhenie kontributi, pranë grupit ndërinstitutional të ngritur me urdhër të Kryeministrit, për hartimin e kuadrit rregullues për përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave të lundrimit të anijeve turistike/jahteve për gjatë sezonit turistik në ujrat teritoriale shqiptare.

Zbatimi i ligjshmërisë detare dhe operacionet SAR janë detyrat kryesore të FD-së. A zotërojnë strukturat e FD-së kapacitetet e nevojshme për planëzimin, organizimin e këtyre operacioneve?

Forcat Detare disponojnë kapacitetet e nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe të zbatimit të ligjshmërisë në det. Për përballimin e operacioneve SAR, Forca Detare ka hartuar plane konkrete reagimi me njësitë në vartësi të saj, si dhe plane bashkëpunimi me strukturat e tjera të FA-së.

Sa efektiv ka qenë kontrolli i hapësirës detare gjatë vitit të kaluar nga personeli i FD-së? A ka pasur vështirësi dhe si janë tejkaluar ato?



Kontrolli i hapësirës detare gjatë vitit 2015 ka qenë mjaft efektiv. Gjatë këtij viti nuk kemi asnjë ngjarje në det. Forca Detare në çdo rast ka qenë në gatishmëri dhe ka ndihmuar subjektet e ndryshme për përbalimin e emergjencave të krijuara si rezultat i motit të keq.

Si ka bashkëpunuar FD me strukturat e tjera për zbatimin e legjislacionit kombëtar e ndërkom-bëtar në hapësirën detare?

Bashkëpunimi ndërinstitutional ka qenë i mirë, por mendoj se duhet rritur në shkallë më të lartë bashkëpunimi me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare, siç është Policia Kufitare, Kapiteneria, Inspektorati i Peshkimit, etj.

Forca Detare është organizuar e funksionon sipas konceptit “Një Forcë Dy Misione”. Çfarë nënkupton kjo?

Koncepti “Një Forcë Dy Misione” është një koncept që e ka zanafillën e tij në vitin 2002 me krijimin e Rojes Bregdetare dhe dhënien e kësaj detyre Forcës Detare. Pra do të thotë një strukturë që kryen dy misione, atë të Forcës Detare, ruajtjen e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të Rojes Bregdetare, të zbatimit të gjishmërisë në det.

Vendi ynë duke qenë një vend i vogël nuk mund të mbajë dy flota të ndara, atë të Forcës Detare dhe atë të Rojes Bregdetare. Kështu që, duke qenë se Forca Detare disponon kapacitetet e nevojshme operacionale (mjetet lundruese, bazat dhe personelin e përgatitur profesionalisht), u vendos që asaj ti ngarkohej edhe detyra e Rojes Bregdetare.

Si është gjendja e gatishmërisë teknike të mjeteve dhe sistemeve që përdor Forca Detare për realizimin e detyrave të përditëshme dhe përbalimin e emergjencave detare?

Aktualisht gjendja e gatishmërisë



teknike në Forcën Detare është në nivele të kënaqshme. Forca Detare tashme zotëron një flotë me anije relativisht të reja, gjë që ka ndikuar pozitivisht në gatishmërinë teknike. Por edhe përsa i përket anijeve më të vjetra, janë marrë të gjitha masat që të kryhen shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes dhe të dokimit të tyre. Mjetet lundruese të Forcës Detare kanë qenë të gatshme nga ana teknike që të përballojnë të gjitha sfidat e ngarkuara. Përveç mjeteve detare Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) është një system i rëndësishëm që ndikon në realizimin e detyrave të përditshme të Forcës Detare. Ai është në gatishmëri dhe i shërben jo vetëm Forcës Detare, por edhe institucioneve të tjera që kanë interesa në det dhe që janë të përfaqësuara në QNOD.

Çfarë pune bëhet për përgatitjen e aftësimit të personelit të Forcës Detare në zbatimin e detyrave funksionale?

Forca Detare ka disa platforma për përgatitjen profesionale të personelit të saj. Njëra prej tyre është Programi vjetor i stërvitjes i cili është i ndarë në dy faza. Faza e parë është përgatitja individuale e efektive të anijeve sipas specialiteteve

dhe faza e dytë është stërvitja në nivel çift dhe grup anijesh. Gjithashtu gjatë vitit stërvitor në fazën e dytë janë të parashikuara stërvitje edhe në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA-së si, Forcën Ajrore, Batalionin e Forcave Speciale, si dhe me institucionet e tjera që kanë interesa në det siç janë Policia Kufitare dhe Antikontrabanda.

Një tjetër platformë për përgatitjen e personelit në FD janë edhe kurset e trajnimit e zhvilluara në Qendrën Stërvitore gjatë gjithë vitit. Në qendër zhvillohen kurse si për personelin oficer ashtu edhe për personelin nënoficer e detar. Forca Detare përveç trajnimeve të përmendura më sipër trajnon personelin e saj edhe në trajnimet e kurset e organizuara në kuadër të planeve të bashkëpunimit dy palësh me vendet aleate.

Lexuesit dhe opinioni publik janë të interesuar për të ardhmen e FD-së, kapacitetet operacionale, modernizimin. Cilat janë disa nga planet e projektet kryesore të zhvillimit të Forcës Detare?

Në 7-8 vitet e fundit Forca Detare ka pësuar një ndryshim rënësor duke futur në inventarin e saj 11 anije të reja dhe duke ndërtuar Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të

hapësirës Detare. Sigurisht modernizimi i Forcës Detare do të vazhdojë. Prioritet kryesor për FD-në është ruajtja e këtyre kapaciteteve operationale si dhe përmirësimi i tyre. Në planin afatshkurtër të zhvillimit të Forcës Detare është parashikuar kompletimi me pajisje dhe armatim modern të Grupit të Bordingut. Për informacionin tuaj Grupi i Bordingut kryen detyrat e inspektimit të mjeteve detare, mbi zbatimin e ligjit të detit. Një tjetër projekt modernizimi është pajisja e anijeve të klasit "ILIRIA" me Sistemin e Identifikimit Automatik Ushtarak (Ë-AIS). Kjo gjë do të rrisë ndërveprueshmërinë e anijeve tona me anijet e vendeve aleate. Në planin afatmesëm Forca Detare ka planifikuar pajisjen e anijeve të klasit "ILIRIA" me sistem armatimi modern dhe zëvendësimin e disa anijeve që do të dalin jashtë përdorimit me anije të reja me qëllim ruajtjen e gatishmërisë operationale të saj. Ndërsa në planin afatgjatë Forca Detare ka si ambicjen e saj rritjen e kapaciteteve luftarake duke u pajisur me dy anije patrulluese të mëdha. Kjo edhe për të rritur kapacitetet e saj të reagimit në kushtë të vështira të motit, por edhe me qëllim dhënien e kontributit në sigurinë rajonale në detet Adriatik dhe Jon.

Tashmë Forca Detare merr pjesë aktive e bashkëpunon ngushtësisht me Flotat partnere të NATO-s. Ku përqendrohet ky bashkëpunim në të ardhmen?

Forca Detare çdo vit zhvillon stërvitje të planifikuara me Flotat partnere rajonale dhe ato të NATO-s. Një ndër stërvitjet më të rëndë-



sishme detare rajonale është stërvitja "ADRION". Siç e përmenda edhe më sipër, kjo stërvitje vjet u zhvillua në vendin tonë dhe u drejtua nga Shtabi i Forcës Detare. Në skenarët e stërvitjes zhvillohen të gjitha llojet e stërvitjeve, që nga manovrimi taktik në grup, embargo detare, kërkimshpëtim (SAR), bordim e komunikim

detar. Forca Detare gjithashtu çdo vit zhvillon stërvitje me anijet e Grupeve të Gatshme Patrulluese të NATO-s, SNMG2 dhe SNMCMG2. Një tjetër partner i rëndësishëm me të cilën stërvitet Forca Detare është edhe Flota e VI-të Amerikane. Përveç stërvitjeve të mësipërme, anijet e Forcës Detare zhvillojnë stërvitje edhe me anijet e Flotave aleate gjatë vizitave portuale të tyre në portet e vendit tonë.

Forca Detare nuk ka bashkëpunim vetëm në aspektin stërvitor me Flotat partnere të NATO-s, por dhe në drejtim të shkëmbimit të informacionit detar. Ne kontribuojmë në Operacionin "Active Endeavor" të NATO-s duke dhënë informacion mbi anijet që lundrojnë në ujërat tona dhe që futen në portet shqiptare. Gjithashtu një tjetër iniciativë rajonale dhe transrajonale ku Forca Detare shqiptare

është anëtare dhe kontribon, është Iniciativa "Virtual - Regional Maritime Traffic Centre" (V-RMTC) dhe "Trans-Regional Maritime Network" (T-RMN). Të gjithë vendet anëtare të kësaj iniciative shkëmbejnë informacionin detar për të krijuar një tablo sa më të qartë të njohjes së situatës detare.

Pra siç e shikoni Forca Detare është mjaft aktive dhe bashkëpunon ngushtë me Flotat partnere. Ky bashkëpunim nuk do të ngelet vetëm në këtë stad. Në të ardhmen Forca Detare do të shtojë aktivitetet e bashkëpunimit duke qenë akoma më aktive. Një ndër projektet më konkrete dhe që do të fillojë që nga ky vit është ngritja e "Grupit të Gatshëm në Thirrje" në kuadër të Iniciativës ADRION. Ky grup në fillim do fillojë patrullimet në detin Adriatik dhe Jon, me qëllim stërvitor dhe më pas do të konsolidohet që të jetë i gatshëm të aktivizohet në çdo rast emergjence që do të ketë një nga vendet e Adrionit.



“DITË E HAPUR NË QBO”:

QBO strukturë e rëndësishme e modernizimit të FA

Qendra e
Bashkuar
Operacionale
në 14 vjetorin
e krijimit të saj

Në kuadër të ditës së krijimit të Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO), si dhe të përmbylljes së projektit për modernizimin e infrastrukturës së saj, u zhvillua më 16 shkurt 2016 aktiviteti “Ditë e Hapur në QBO”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i ambienteve të reja dhe i demonstrimit të disa veprimtarive të QBO-së, si pjesë e misionit të saj. Në aktivitet morën pjesë ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantë forcash, si dhe drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm. Fjalën hapëse e mbajti komandanti i QBO-së, kolonel Ahmet Leka i cili i njohu pjesëmarrësit me historikun, misionin, organizimin dhe përgjegjësitë kryesore të kësaj qendre.

Nga ana e tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo, shpjegoi veprimtarinë e kësaj qendre edhe në rastet e përkeqësimit dhe përshkallëzimit, gjatë së cilave rrjedhimisht rritet edhe niveli i komandimit. “Qendra e Bashkuar Operacionale është një vend komandë, është një forcë përdoruese në emër të drejtimit unik dhe komandimit unik, është syri, veshi ose pika nevralgjike e komandimit të Forcave të Armatosura”, -tha gjeneralmajor Bazo.

Në fjalën e saj ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli falënderoi personelin e kësaj qendre për punën dhe ndihmën që ata kanë dhënë gjatë gjithë këtyre viteve të funksionimit, si dhe bashkëpunimin e ngushtë të saj me institucionet e tjera. “Kjo qendër bashkë me të FA, i janë përgjigjur qytetarëve shqiptarë në gjithë këto vite të emergjencave të natyrave të ndryshme, duke filluar që nga përmbytjet, tek zjarret, tek problemet që kanë pasur në lidhje me detin, tek fatkeqësitë e tjera, procesi i kërkim shpëtimit e kështu me radhë. Kjo qendër është sot shumë herë më e strukturuar dhe më e fokusuar tek detyrat e aj primare dhe ajo çka është më e rëndësishme, është që kjo qendër sot është më bashkëpunuese me gjithë strukturat e tjera

institucionale të cilat shteti ka të ngritura për të gjitha rastet e emergjencave të çfarëdolloj natyre. Është më vendimmarrëse dhe më e pavarur përgjatë zinxhirit të komandimit, nga çka qenë deri dje.” - tha ministria Kodheli.

Ministria Kodheli foli gjithashtu edhe për ndryshimet dhe investimet që janë bërë në me qëllim funksionimin sa më efikas të qendrës. “Vëmendja që i është dhënë kësaj qendre, na ka shtyrë të riformatojmë këtë qendër nëpërmjet edhe një investimi prej 12 milionë lekë të reja, të cilat kanë bërë të mundur përmirësimin e kushteve të punës, kanë bërë të mundur



përmirësimin e mjediseve dhe mënyrës se si sot përgjigjemi ndaj emergjencave të çfarëdolloj natyre dhe sigurisht që kjo është pjesë dhe vazhdimësi e të gjithë procesit të modernizimit të FA-ve, në të cilin ne tashmë i jemi futur kësaj rruge të pandalshme dhe pa kthim, çka i bën mirë FA-ve vetë, i bën mirë përgjigjes që ne japim për detyrimet kushtetuese dhe angazhimit në NATO.” - tha ajo.

Për të pranishmit u bë testimi i komandim-kontrollit (C2) nëpërmjet zhvillimit të një VTC-je (videotelekonferencë) në kohë reale me forcat kryesore. Zgjidhja e një detyre (situatë) në rast emergjence civile, ishte programi në vazhdim i “Ditës së Hapur në QBO”. Në fund pjesëmarrësit vizituan ambientet e Qendrës së Bashkuar Operacionale dhe panë nga afër punën e personelit të saj.

Qendra e Bashkuar Operacionale, pika nevralgjike e komandimit të FA

Intervistë me kolonel Ahmet Leka, komandant ie Qendrës së Bashkuar Operacionale

MIMOZA GOLIKJA

Ditë e Hapur në QBO", ishte një aktivitet që Qendra e Bashkuar Operacionale organizoi në kuadër të ditës së krijimit të saj, por edhe të përmbylljes së projektit për modernizimin e infrastrukturës. Gjatë zhvillimit të aktivitetit jo vetëm u promovuan ambientet e reja por edhe u demonstruan para ministres së Mbrojtjes, zonjës Kodheli, shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralëve të pranishëm dhe të ftuarëve të tjerë, disa veprimtari të QBO-së, si pjesë e misionit të saj. Pas përfundimit të aktivitetit i morrëm komandantit të kësaj qendre kolonel Ahmet Leka këtë intervistë për shtypin ushtarak.

Zoti komandant, Ju sot zhvilluat aktivitetin "Dita e hapur në QBO". Cili ishte qëllimi për këtë aktivitet?

Dita e sotme ishte një ditë feste dhe gëzimi për personelin e Qendrës së Bashkuar Operacionale, që tashmë është organizuar e funksionon si simotrat e saj në vendet e NATO-s. Sot ne festuam 14 vjetorin e krijimit të kësaj qendre, si dhe përmbylljen me sukses të projektit për modernizimin e infrastrukturës, krijimin e ambienteve të reja komode dhe ngritjen e sistemeve moderne në QBO. Atmosferën e bëri më të gëzueshme edhe pjesëmarrja në aktivitet e ministres së Mbrojtjes, zonjës Mimi Kodheli dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo, të cilët vlerësuan



KOLONEL AHMET LEKA:

QBO mbështet procesin e komandim-kontrollit në nivelin operativo-strategjik për veprimtarinë operacionale të FA, si dhe koordinon kryerjen e operacioneve të kërkim shpëtimit dhe EC në RSH nëpërmjet delegimit të autoritetit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe të ministrit të Mbrojtjes Përgjegjësitë e QBO-së janë të shumta.

lart punën e QBO-së në përmbushje të misionit të saj.

Ju sot festuat 14 vjetorin e krijimit të QBO-së. Kaq e re është kjo strukturë?

Si strukturë vërtetë është e re, por zanafillat e saj i ka që mbas çlirimit të vendit ku për ndjekjen e pa ndërprerë të situatës tokësore, ajrore dhe detare dhe të gjithë vepërimitarisë, së Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes tradicionalisht ka funksionuar Shërbimi i Grupit të Drejtimit. Ky shërbim përbëhej nga Përgjegjësi i Grupit të Drejtimit (PGD) dhe ndihmësi i tij. Drejtorët e drejtorive kryenin shërbimin si Përgjegjës të Grupit të Drejtimit (PGD), ndërsa instruktorët si ndihmës përgjegjës të Grupit të Drejtimit. Shërbime të veçanta si ai i zbulimit, ndërlidhjes për forcat ushtarake detare e ajrore mbulohehin nga strukturat përkatëse. Ndryshimet strukturale të Forcave të Armatosura pas viteve 90, por edhe nevoja për përshtatje me strukturat homologe të vendeve partnere, solli domosdoshmërinë e riorganizimit të Shërbimit të Drejtimit në Forcat e Armatosura. Në prill të vitit 1994 Shërbimi i Drejtimit u disiplinua në TOP "Përgjegjës Grupi Drejtimi" dhe "Ndihmës Përgjegjës Grupi Drejtimi", ndërsa në vitin 2002 me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.75 datë 14.02.2002 u krijua

Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura.

A mund të na jepni një panoramë të shkurtër të reformimit të QBO-së në këto 14 vjet?

Qendra e Bashkuar Operacionale ka pësuar ndryshime të herpashërëshme në raport me reformimin e Forcave të Armatosura, në interes të konsolidimit të saj. Nga dita e krijimit deri më sot, Qendra e Bashkuar Operacionale është riorganizuar disa herë si në vitin 2004, 2006, 2010, 2012 dhe së fundi në vitin 2014. Akti i parë për krijimin e QBO-së është urdhri Nr.75 datë 14.02.2002 i Ministrit të Mbrojtjes të asaj kohe "Për organizimin e Qendrës së Bashkuar Operacionale të Shtabit të Përgjithshëm të FA", akt i cili shënon dhe ditën e krijimit të QBO-së. Me krijimin e Qendrës së Bashkuar Operacionale të Shtabit të Përgjithshëm të FA si strukturë e veçantë, u shkrinë të gjitha strukturat e shërbimit të përmendura më lart dhe në përbërje QBO-së u ngritën katër zyra si Zyra Operacionale, Zyra e Zbulimit, Zyra e Ndërlidhjes dhe Zyra e Kushtrim-Lajmërimit.

Zyra e Kushtrim Lajmërimit në përbërje të Qendrës së Bashkuar Operacionale lindi si domosdoshmëri nga nevoja për bashkëpunimin, komunikimin dhe koordinimin efektiv me Qendrat Operacionale homologe, si dhe komunikimi në vijimësi me

trupat tona paqeruajtëse jashtë vendit si, Irak, Afganistan, Boshje-Hercegovinë, etj. Kjo strukturë ka funksionuar deri në Maj të vitit 2005. Organizimi dhe funksionimi i saj pa dyshim ishte një hap shumë i rëndësishëm përpara, pasi u krijua mundësia e veprimit të përbashkët të ish zyrave të ndara dhe në varësi të ndryshme.

Në vitin 2004, lidhur me disa probleme e shqetësime që kishin lindur për mbulimin e koordinimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe sigurimin e komandim kontrolit pa ndërmjetësim, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.448 datë 20.07.2004 "Për krijimin e grupit të punës për riorganizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR) në Forcat e Armatosura" u ngrit një grup pune për këtë qëllim i cili pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjitha të dhënat e vepërimitaritë e strukturave të kërkim-shpëtimit, propozoi që në Qendrën e Bashkuar Operacionale, të ngrihet sektori (qendra) i koordinim-shpëtimit (RCC), propozim i cili u miratua. Në këtë kuadër pësoi ndryshime edhe struktura e QBO-së. U krijuan dy sektorë operacionale dhe sektori i kërkim-shpëtimit. Në Qershor të vitit 2005 u bë ç'vendosja e RCC nga Rinasi në ambientet e QBO dhe mori drejtimin nga venddislokimi i ri qershor 2005

Në vitin 2006 u krijua Forca e Bashkuar dhe në këtë kuadër riorganizohet edhe QBO-ja. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 26, datë 17.01.2007 krijohet Qendra Operacionale e Mbrojtjes me Sektorin e Forcës së Bashkuar, Sektorin e Strukturave Mbështetëse, Sektorin e Strukturave Civile dhe Sektorin e Kërkim Shpëtimit. Aktivizimi i kësaj strukture u bë në shtator të vitit 2007.

Në vitin 2010 suprimohet Komanda e Bashkuar. Në këtë kuadër me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr 151/5, datë 24.12.2009 suprimohet dhe Qendra Operacionale e Mbrojtjes dhe organizohet Qendra e Bashkuar Operacionale me sektorë sipas forcave: Sektori i Operacioneve Tokësore, Seksioni i Operacioneve Detare, Seksioni i Operacioneve Ajrore, Seksioni i Strukturave Mbështetëse dhe Autonomeve të MM dhe SHP. Në



këtë strukturë për herë të parë u ngrit Sektori i Emergjencave Civile, dhe Sektori i Vendit Pritës.

Reforma e thellë në NATO në vitin 2012, solli reformim edhe të Forcave tona të Armatosura. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr 434, datë 06.06.2012, u bënë përmirësime edhe në strukturën e Qendrës së Bashkuar Operacionale duke kaluar në përbërje të QBO-së Seksionin e Vendit Pritës.

Në vitin 2014, në strukturën e QBO-së për herë të parë u ngrit Sektori i Planëzimit dhe Vlerësimit të Rrezikut, Sektori i Operacioneve të Bashkuara, Sektori i Kontrollit të Lëvizjes dhe Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit.

Megjithëse është folur shpesh për të, çfarë është QBO-ja dhe cili është vendi dhe roli i saj në strukturën e Forcave të Armatosura?

Qendra e Bashkuar Operacionale është strukturë e veçantë, permanente e Shtabit të Përgjithshëm të FA, në vartësi të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në mbështetje të detyrave të komandim-kontrollit për administrimin e operacioneve në kohë paqe, krize e lufte, me veprimtari të pandërprerë në 24 orë.

Ajo është strukturë operacionale për monitorimin dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë dhe në të njëjtën kohë strukturë administrative për ndjekjen e veprimtarive të përditshme gjatë dhe pas orarit të punës.

Pas kompletimit me përfaqësues të drejtorive të SHPFA, QBO koordinon planëzimin, organizimin dhe koordinimin e operacioneve të FA, për rastet e emergjencave e situatave kritike humanitare në të gjitha format që shfaqen dhe fazat e zhvillimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e detyrave të planëzuara dhe të miratuara për njësitë e repartet e FA.

Përsa i përket vendit dhe rolit QBO-ja është qendër e nivelit operativ - strategjik, është pjesë integrale e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të përgjithshëm dhe instrumenti kryesor i SHSHP dhe Ministrit të Mbrojtjes për drejtimin operacional të FA. Ajo ushtron au-

toritet të deleguar nga Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Cili është misioni i QBO-së dhe cilat janë përgjegjësitë kryesore të saj?



QBO mbështet procesin e komandim-kontrollit në nivelin operativ-strategjik për veprimtarinë operacionale të FA, si dhe koordinon kryerjen e operacioneve të kërkim shpëtimit dhe EC në RSH nëpërmjet delegimit të autoritetit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe të ministrit të Mbrojtjes Përgjegjësitë e QBO-së janë të shumta, por më kryesoret janë menaxhimi i informacionit, menaxhimi i situatave gjatë krizave dhe emergjencave civile, kërkim shpëtimi, procedurat e vendit pritës (HNS), kontrolli i lëvizjes dhe detyra të tjera administrative.

Shpesh po flitet për vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e EC dhe krizave. Cila është risia e këtij vendimi?

Para se të flas për këtë dua të theksoj se QBO-ja mund të jetë ndër strukturat e vetme në Forcat e Armatosura, që për veprimtarinë e saj ka më shumë akte ligjore e nënligjore si: Ligji nr. 64/2014, datë 26.06.2014 për "Pushtetet

dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të FARSH"-i ndryshuar, ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", ligji nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të Forcave Ushtarake të huaja në territorin e RSH, si dhe për dërgimin e Forcave Ushtarake

Shqiptare jashtë vendit", ligji nr. 10435, datë 23.06.2011 "Për shërbimin SAR në RSH", VKM nr. 742, datë 16.10.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e QKKSH", VKM nr 965, datë 2.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e EC dhe krizave", Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes, nr 12, datë 08.01.2016 "Për delegim të autoritetit të komandimit e kontrollit në rastet e emergjencave civile dhe krizave" etj.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.965, datë 2.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e EC dhe krizave" është me të vërtetë një vendim mjaft i rëndësishëm. Mbi bazën e këtij vendimi mundësohet një përgjigje më e shpejtë edhe më efikase në rastet e emergjencave civile dhe krizave.

Sipas këtij vendimi ngrihen struktura të drejtimit dhe të menaxhimit të krizave dhe emergjencave civile, si dhe sigurohet bashkëpunimi ndërinstitucional i qendrave operacionale/ zyra e informacionit dhe menaxhimit të emergjencave dhe krizave, nëpërmjet delegimit të kompeten-

cave nga ministrat, si dhe rritet efica e strukturave reaguese për përballimin e krizave dhe emergjencave civile.

Ky vendim reduktoi burokracinë për përdorimin e strukturave operacionale në përgjigje të situatës nëpërmjet delegimit të kompetencave QBO-së për përdorimin e asetëve të caktuar të Forcave të Armatosura me kërkesë të Drejtorisë së përgjithëshme të Emergjencave

e angazhimit të QBO-së dhe FA në Emergjencat Civile e kodifikuar EC-328/11; PSV "Për shërbimin e Kërkim-Shpëtimit" e kodifikuar PSV-332/10; PSV "Mbështetja e Vendit Pritës" e kodifikuar PSV-480/10; PSV "Procedura standarde për kontroll-lëvizjen e mjeteve të transportit" e kodifikuar KL-490/20; PSV "Përngjarjet e jashtëzakonshme" e kodifikuar NJ-322/10 etj



Ju sot promovuat dhe përmblylljen me sukses të projektit për modernizimin e infrastrukturës, krijimin e ambienteve të reja komode dhe ngritjen e sistemeve moderne në QBO. Diçka në lidhje me këtë?

Vitin e kaluar QBO-ja u vendos në ambientet ku jemi sot, por jo në këto kushte. Falë

Civile.

Dalja e këtij vendimi plotësoi boshllëkun ligjor për përdorimin e kapaciteteve ushtarake për periudhën deri në shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Po me procedurat Standarde të Veprimit si punohet në QBO?

Të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura duhet të punojnë me Procedura Standarde Veprimi, por për QBO-në, kjo është domosdoshmëri në kuptimin e vërtetë të fjalës. Situatat që përpunohen e vlerësohen në QBO nuk pranojnë hutim e paqartësi në reagim. Për to kërkohet shpejtësi, saktësi, radhë punë standarde. Për këtë qëllim në QBO janë përgatitur e miratuar rreth 12 Procedura Standarde Veprimi (PSV) ku më kryesoret mund të përmendim: PSV për "Emergjencat Civile" të kodifikuar EC-328/10, PSV për nivelet

investimit për këtë qëllim, sot, QBO ka ambiente mjaft komode për punë, ka një sallë operacionale bashkëkohore për shërbimin në detyrë (24/7/365), sallën VIP, një sallë të vlerësimit të rrezikut, një sallë të planëzimit operacional dhe ambiente pune komode për të gjithë personelin me sistem ajrimi e kondicionimi. Në QBO janë ngritur e funksionojnë sisteme moderne bashkëkohore si ai i pasqyrimit dhe vëzhgimit të situatës ajrore dhe detare, sigurisë dhe vëzhgimit me kamera, komunikimit dhe internetit etj.

Duke përfunduar, cilat janë projektet tua për të ardhmen?

Ne shikojmë vetëm përpara duke përmirësuar aktet ligjore e nënligjore, procedurat standarde të veprimit, infrastrukturën dhe trajnuar me tej personelin për të qenë gjithmonë në gadishmëri të plotë.

Kolene RAZIE MEHMETI
Atashe e Mbrojtjes në Ankara

Në bazë të Protokoll-marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë në vitin 1992 kanë filluar studimet në Universitetin Mjekësor Ushtarak GATA në Ankara tre studentë nga Shqipëria ku sot janë mjekë shumë të zot në spitalin Ushtarak në Tiranë, nga të cilët mund të përmendim Arian Hodo apo dhe mjekë në spitale të tjera civile në Shqipëri.

GATA (Gulhane Askeri Tip Akademisi) është themeluar në 18 Maj 1898 nga doktori gjerman Robert Rieder me kërkesë të perandorisë osmane. Universiteti u hap zyrtarisht në 30 dhjetor 1898, datë kjo që përkon me ditëlindjen e sulltanit të fundit osman, Abdulhamitit të dytë. GATA është universiteti i parë turk që përdori sistemin perëndimor të arsimit. Profesorët e parë të universitetit deri në vitin 1918 ishin profesorë gjermanë të ardhur në bazë të marrëveshjes midis Prusisë dhe Perandorisë Osmane. GATA është bërë i njohur për popullin turk gjatë Luftës së Parë Botërore, gjatë



GATA-Ankara:

Aty ku diplomohen mjekët ushtarakë shqiptarë

së cilës personeli mjekësor përveç trajtimit të të plagosurve mori pjesë aktive në betejën e Çanakalesë.

Në vitin 1980 universiteti u zhvendos nga Stambolli në Ankara. GATA është një shkollë e mirënjohur në Turqi dhe më gjerë. Gjatë vitit akademik 2015-2016 numri i studentëve në degën e mjekësisë ushtarake është 852 nga të cilët 11 studentë janë shqiptarë. Programi për marrjen e studentëve të huaj ka nisur në vitin 1986. Studenti i pare i huaj, është me origjinë nga Malajzia dhe është diplomuar në vitin 1992.

Në vitin 1994 ka filluar studimet Valbona Mataj ku ka përfun-

duar shkollën dhe ka ndjekur master për Kontrollin e Infeksioneve Spitalor edhe sot ndjek Doktoraturën: "Shkenca për mikrobiologji", si dhe këtë vit ka filluar specializimin toger Ardi Rekasi specialist për kardiologjinë. Në çdo moment këta dy mjeke do t'i gjesh në krye të detyrës të veshur me uniformën e bardhë të mjekut.

Në spitalin GATA (Gylhane Askeri Tip Akademisi) përveç arsimimit të studentëve tanë është dhe protokoll-marreveshja për kurimin falas të ushtarakëve dhe familjarëve të tyre. Ndhima që jepet nga spitali GATA për pacientët shqiptarë është

e pa kysyer si nga mjekët dhe nga Komandanti i GATA-s Korg. Gjeneral Omer Paç i cili për pacientët shqiptarë është i interesuar personalisht që të jepej ndihma maksimale.

Po kështu në ambjentet e spitalit GATA do të ndeshemi dhe me studentët shqiptarë që përveç studimeve që kanë në jetën e përditshme, ato ndihmojnë pacientët shqiptarë. Ata mund ti gjesh duke ndihmuar pacientët shqiptarë në çdo moment edhe kur ata janë në kohën e lire si: Fjoralba, Ervini, Hygerta, Dajana, Marisa, Nertila dhe Kristi.

Por këtë vit kemi katër student që përfundojnë shkollën e lartë mjeksore në GATA dhe titullohen mjekë të ardhshëm ushtarak për ti shërbyer vendit të tyre në Shqipëri me njohuritë dhe praktikën e marrë në një spital bashkëkohor dhe shumë të dëgjuar për ndihmën e dhënë për pacientët shqiptarë.

Në vitin 2009 kanë nisur studimet studentët Rialda Myrtaj, Anri Bello, Larisa Shehaj dhe Sivi Kuci dhe këtë vit më 31 gusht 2016 do të diplomohen. Pas përfundimit një vjeçar të gjuhës turke, ata kanë filluar studimet mjeksore. Në tre vitet e para të shkollës janë marrë lëndët bazë teorike mjekësore. Krahas arsimimit bazë mjekësor, në fund të vitit akademik studentet kanë marrë pjesë në kampin një mujor ushtarak. Kampi ushtarak është pjesë e programit mësimor të GATA-s gjatë të cilit studentët përgatiten për emergjencat ushtarake. Në vitin e katërt dhe të pestë të shkollës krahas teorisë fillohet ti jepet më shumë rëndësi anës praktike. Në vitin e fundit të shkollës studentët marrin statusin e ndihmës-asistentit. Studentët përveç anës mësimore kanë marrë pjesë dhe në aktivitetet e shumta sociale ndër të cilat më e spikatura është prezantimi vjetor i kulturës shqiptare në ditën e huajve në Turqi. Pas mbarimit të studimeve synimi i studentëve tanë është kthimi për ti shërbyer vendit të tyre si dhe vazhdimi i specializimit aty ku ata kanë marrë përgatitjen bazë që ti shërbejë vendit të tyre në mënyrë më profesionale. Dëshira e tyre është marrja e specializimeve në degët ku Spitali Ushtarak në Tiranë ka më tepër nevojë, ndër të cilat rradhiten kirurgjia e përgjithshme, ortopedia, pediatria, kardiologjia dhe degët laboratorike (patologji, mikrobiologji, biokimi).



Rekrutimet në FA, angazhohet pushteti lokal

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Erion Veliaj u takuan në 8 shkurt me 24 administratorët e njësive administrative të kryeqytetit, lidhur me fushatën e aplikimit për ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura. Qëllimi i takimit ishte sensibilizimi i komunitetit dhe sidomos të rinjve, që të marrin në konsideratë rekrutimin në Forcat e Armatosura. Ministrja Kodheli i kërkoi administratorëve kontakte me të ngushta me të rinjtë në komunitetin që ata administrojnë, me qëllim që në FA të vijnë më të mirët e mundshëm. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli foli gjithashtu edhe për privilegjet që një i ri gëzon pasi rekrutohet në FA. "Dikush që pranon të bëhet pjesë e FA ka mundësi të jashtëzakonshme në jetë. Studentët tanë studiojnë në




akademitë më të mira dhe më të rëndësishme botërore ushtarake. Profilizohen dhe marrin specialitete nga më të rrallat, gjë që i bën ata të pazëvendësueshëm. Ka mundësi të rriten në gradë. Kanë mundësi të trajnohen edhe mbasi shkollohen. Por kanë edhe mundësi të një shërbimi shëndetësor të një natyre të veçantë, shumë të privilegjuar. Po kështu më të privilegjuar mund të

jenë edhe për sa i përket strehimit apo të trajtimit të tyre, për gjithçka që në jetën e përditshme mund të kthehet në problem kur nuk merr një zgjidhje."-tha ajo. Duke folur për reputacionin që sot FA gëzojnë në botë si pjesë e NATO, kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Erion Veliaj, u shpreh gjithashtu krenar që vinte nga një familje ushtarakësh dhe përgëzoi ministren Kodheli për reformat.

Veliaj: 600 mundësi punësimi për djem e vajza

Z.Erion Veliaj, në prani të ministres Kodheli, tha se: "Sot flasim për rekrutime profesioniste, për një punë nga më të mirëpaguarat në Republikën e Shqipërisë dhe unë i shoh këto dy faza, rekrutimin e pranverës dhe vjeshtës, si një mundësi fantastike për 600 të rinj të qytetit të Tiranës. Ndaj, do të ftoja 24 administratorët që, bashkë me drejtoritë arsimore, ndërlidhësit e komunitetit, kryepleqtë në zonat e fshatit, të identifikojmë më të mirët", u shpreh Veliaj. Sipas tij, shembulli kur "dështakët" visheshin policë apo ushtarakë, ka ndryshuar: "Për një ushtri që është pjesë e NATO-s, duhet të zgjedhim më të mirët. Këto janë 600 mundësi punësimi për djem e vajza që kanë pasion dhe zell për t'i shërbyer vendit, që preferojnë të lënë kafën, bingot e skedinën, për uniformën dinjitoze të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave tona të Armatosura", tha Veliaj. Duke iu drejtuar administratorëve të njësive, kryebashkiaku i Tiranës tha se, kjo është një mundësi për ato familje që shikojnë te fëmijët e tyre mundësinë që të dalin nga kurthi i varfërisë. "Është një mundësi e jashtëza-



konshme ekonomike që këta djem dhe vajza të fillojnë një karrierë dhe një punë dinjitoze, e cila inkurajohet, jo vetëm nga reformat e ministres, por edhe nga një traditë që tashmë, në këto 2 vjet e gjysmë, është krijuar për profesionistët, që i bashkohen

Forcave tona të Armatosura", tha ai. Kryetari i Bashkisë së Tiranës propozoi hartimin e një plani për të shkuar në çdo gjimnaz të qytetit, bashkë me menaxhuesit e procesit të rekrutimit, për t'u siguruar që djem dhe vajza me nota të mira të ndjekin arsimin e tyre ushtarak. Kryebashkiaku falenderoi Ministrinë e Mbrojtjes për mbështetjen që i ka dhënë komunitetit të Tiranës mbi përballojmë krizave të emergjencave

civile. "Ndaj, shikojmë te këta 600 rekrutë edhe 600 investime, që secili prej nesh bën në komunitet, që kjo dije që vjen nga puna në ushtri, të jenë pranë komuniteteve tona, ku mësojmë më shumë se si të përballojmë krizat, si të përballojmë emergjencat në një mot që bëhet gjithmonë e më i pabesë, si një resto për mënyrën se si jemi sjellë gjatë këtyre viteve", përfundoi Veliaj.

Kodheli në gjimnazin: “Babë Dudë Karbunara”, në Berat

Fushata e rekrutimeve në FA; 60 aplikime nga Berati

Fushata e rekrutimit për ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura u ndal më 5 shkurt 2016, në qytetin e Beratit. Vetë ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli u takua dhe bisedoi nga afër me nxënësit maturantë të gjimnazit “Babë Dudë Karbunara” të këtij qyteti. Fillimisht ishin drejtori i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Leonard Çoku dhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, ata bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me këtë fushatë dhe procesin e aplikimit. I pranishëm në takim ishte edhe zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi.

Më pas e mori fjalën ministria Kodheli, e cila pasi i përgëzoi nxënësit se mësojnë në një prej gjimnazeve më të mira në vend, u foli për avantazhet dhe arsyet përse një i ri duhet t'i bashkohet Forcave të Armatosura. “FA janë një mundësi e jashtëzakonshme për punësim, një mundësi e jashtëzakonshme për t'u shkolluar në akademitë më të mira botërore, duke filluar që nga SHBA, e deri në vendet fqinje. Kush do të vendosë ta sfidojë të ardhmen, ta sfidojë opinionin dhe ta ketë të sigurt rrugën në karrierë, është i mirëpritur të vijë të konkurrojë, të aderojë, të mësojë, të trajnohet, të edukohet, të përparojë në FA të Republikës së Shqipërisë. Është pa as më të voglin dyshim pjesa më e elitë, më e mirë, më e dedikuar e shoqërisë shqiptare. FA janë një mundësi e jashtëzakonshme për të përparuar në karrierë”, tha ministria Kodheli, e cila i konsideroi yje pjesëtarët e FA. “Vajzat dhe djemtë në uniformë janë yje për shkak të sakrificës që bëjnë, yje për shkak të vetëmohimit, yje për shkak të mundit për të mbërritur



atje ku mbërrinjë, të devotshmërisë, disiplinës, sinqeritetit me të cilin punojnë, që e dallon këtë strukturë nga gjithë strukturat e tjera dhe nga profesionet e tjera”, u tha ministria, maturantëve.

Krahas ambicies për të vazhduar një shkollë të lartë dhe mundësive të jashtëzakonshme që FA ofrojnë, ministria Kodheli u foli nxënësve të këtij gjimnazi edhe për vështirësitë që paraqet ky impenjim. “Për t'u futur nuk është aq kollaj, por për të gjithë ata që do t'ia mbërrinjë, do shikoni që do të keni shumë më tepër respekt për veten, dhe të tjerët për ju, dhe kjo është shumë e rëndësishme për njeriun. Ndaj unë ju ftoj, patjetër dhe ju sfidoj në pozicionin e ministrit, ta tentoni. Do të gjeni drejtësi, dashamirësi dhe oportunitete e shanse shumë të mëdha. Uroj që një ditë të riktheheni në qytetin tuaj duke e gjetur veten gjeneralë, kolonelë, drejtues forcash, përfaqë-

sues të Republikës së Shqipërisë në të gjithë strukturat e NATO, me eksperiencë të mëdha edhe të rikujtoni me shoqërinë e vjetër këtë bisedë modeste”, përfundoi fjalën e saj ministria Kodheli.

Pas takimit ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dha një intervistë për gazetën e këtij gjimnazi si dhe iu përgjigj interesit të mediave, lidhur me këtë proces, ku bëri të ditur se nga qyteti i Beratit deri tani, janë paraqitur rreth 60 aplikime. Fushata e rekrutimit për ushtarë/detarë aktivë që ka nisur në FA dhe përfundoi më 25 shkurt 2016.

Për vitin 2016 është planifikuar që në FA të rekrutohen 600 ushtarë/detarë aktivë. Plani i rekrutimit është konceptuar të realizohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në dy faza, ku faza e parë shtrihet në muajt mars-maj dhe faza e dytë në muajt tetor-dhjetor 2016. Në çdo fazë do të rekrutohen 300 vetë.

Monitorimi detar:

Shqipëria ka përmbushur detyrimet

Një delegacion i Bashkimit Evropian vizitoi Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD). Vlerësohet puna e bërë nga institucionet e shtetit shqiptar për monitorimin e situatës detare.

SHEFQET KERCELLI

Paraditen e datës 5 shkurt 2016, një delegacion i Bashkimit Evropian i kryesuar nga Europarlamentarët Romana Vlahutin (Ambasadore e BE në Shqipëri) dhe Lars Wigemark (Ambasador i BE në BosnjëHercegovinë) zhvilluan një vizitë në Qendrën tonë Ndërinstitucionale Operacionale Detare. Fillimisht Delegacioni i BE u prit nga Drejtori i QNOD, Gjeneralmajor(R) Maksim Malaj dhe Kordinatorët e Institucioneve pjesmarrës të kësaj Qendre. Sipas programit mbas fotos së përbashkët, Delegacioni i BE i ndarë në dy grupe u njoh me Organizimin, Përbërjen e Misionin e Qendrës si dhe funksionimin e Sallës Operacionale. Mbas i uroi mirëseardhjen, zoti Malaj i prezantoi pjesmarësve qëllimin e krijimit të QNOD në maj të vitit 2010, konceptimin e saj si institucion kryesor për monitorimin e situatës detare, ministrinë pjesmarrëse, bashkëpunimi midis tyre, stafi operacional, kapacitetet operationale dhe drejtimi i operationeve, rregjimet juridike, sistemet dhe asetet në përdorim, shtrirja

e tyre, shkëmbimi i informacionit dhe analiza e riskut. Në vijim Gjeneral Malaj evidentoi disa nga operationet kryesore të kryera gjatë vitit të kaluar dhe aktualisht, si ato antidrogë, trafikun e paligjshëm të mallrave dhe njerzve, operationet humanitare për shpëtimin e personave dhe mjeteve në rrezik, etj. Në organizimin, certifikimin dhe funksionimin normal të QNOD ka shërbyer dhe asistencë e Ambasadës së SHBA, BE dhe NATO-s, nëpërmjet strukturave të tyre, ICITAP, EXBX, PAMECA dhe atasheve ushtarakë të vendeve partnere, theksoi zoti Malaj. Ndërkohë për trajnimin, standartizimin dhe përgatitjen e personelit përbërës të QNOD ka qenë efikas bashkëpunimi dhe zhvillimi i stërvitjeve me Flotën e 6-të dhe Rojen Bregdetare të SHBA, me Qendrën e Simulimeve të Forcave të Armatosura, Guardia di Financën dhe Institucionet Shtetërore me interesa në det si, Forcën Detare, Policinë Kufitare, Antikontrabandën Detare, Kapitanerinë e Porteve, Inspektoriatin e Peshkimit dhe atë Mjedisit. Gjatë prezantimit Ambasadore Vlahutin u interesua për operationet e kryera në zbatim të ligjshmërisë detare, kryesisht trafikut të paligjshëm dhe përballimin e situatave emergjente në det. Në zbatim të programit, delegacioni i BE u njoh konkretisht me funksionimin e Sallës Operacionale të QNOD. Kapiten i Rangut të I-rë, (R) Astrit Aliaj, Zv/drejtor i QNOD, e njohu delegacionin e BE me organizimin e Sallës Operacionale, ndjekjen dhe monitorimin e situatës detare nga personeli i saj, sistemet dhe aparataturat që përdoren, bashkëveprimi gjatë operationeve. Këtu zyrtarët e BE bënë pyetje dhe ndoqën nga afër mënyrën e monitorimit dhe ndjekjes së lëvizjes së anijeve të peshkimit, për të cilat morën përgjigje nga specialistët përkatës. Në fund të vizitës Ambasadorja e BE në vendin tonë, zonja Romana Vlahutin vlerësoi punën e bërë nga personeli dhe institucionet e shtetit shqiptar për organizimin, pajisjen dhe forcimin e institucioneve ligjzbatuese në det. "Shqipëria ka bërë hapa para dhe i ka përmbushur detyrimet e standartet e kërkuara nga BE për kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare", u shpreh ambasadorja Vlahutin. Po këtë ditë Delegacioni i BE zhvilloi vizita në objektet muzeale të qytetit të Durrësit.





Përkujtohet 35- VJETORI i 11 Dëshmorëve të Fekenit

Komandanti i batalionit Dushan Shametaj, shef i Planëzimit në Degën e Arsimit Çlirim Pulaj, pedagogu i taktikës Nikollaq Bero, studentët Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa dhe Bujar Ago, ishin oficerë dhe studentë me shpirt dhe zemër heroike, të gjithë të rinj që e kishin të shenjtë dashurinë për atdheun dhe për shokët deri në sakrificën supreme.

Më 6 shkurt 2016, u mbushën plot 35 vjet nga dita e rënies në krye të detyrës të 11 studentëve dhe pedagogëve të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve në stërvitjen dimërore që zhvillonin në rajonin e malit të Fekenit. Me këtë rast, Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, organizuan një ceremoni përkujtimore ku ishin të pranishëm ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralë të FA, të afërm dhe familjarë të dëshmorëve, si dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, ministria Kodheli pasi falënderoi të pranishmit, kujtoi misionin fisnik për të cilin ata ranë dëshmorë. "Kjo është një ngjarje që ka prekur zemrat e kujtdo që në ato vite mësoi për këtë ngjarje të rëndë, dhe që vazhdon t'i prekë sot edhe pas 35 vitesh. Por kjo na bën më të fortë për të parë përpara, për të ecuar në rrugën e treguar prej tyre, dhe shumë e shumë të tjerëve që ranë në krye të detyrës në respekt të misionit fisnik që kishin; mbrojtjes së atdheut. Ndaj sot përveç një ditë përkujtimore, kjo është një ditë që na mbush me krenari, se ne i përkasim akoma atij brezi që di të respektojë dhe të përkujtojë të gjithë

të rënë. I përkasim atij brezi në uniformë ose jo, që akoma ka besim dhe mbështetet tek vlerat më sublimë, siç është ajo e dashurisë për atdheun dhe detyrën, të cilën na kanë caktuar", tha ministria Kodheli. Pas vendosjes së kurorave me lule pranë memorialit të ngritur në nder të të rënëve të kësaj tragjedie, ministria Kodheli ftoi të pranishmit të mbanin 1 minutë heshtje në kujtim të tyre.

Tragjedia e 6 shkurtit 1981 që ndodhi në stërvitjen dimërore që zhvillonin studentët e ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Feken është një ngjarje e skalitur në memorien e gjithë ushtarakëve dhe më gjerë. Studentët dhe pedagogët e kësaj shkolle shkonin çdo vit në stërvitje dimërore në këtë rajon malor, madje këtu kishin të ngritur edhe kampingun e tyre dimëror me të gjithë parametrat dhe elementët e duhur. Por dimri i atij viti erdhi më i ashpër dhe më i ngarkuar me dëborë. Dhe pikërisht 6 shkurti, një ditë tepër e vështirë u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare është quajtur "Tragjedia e Fekenit". Komandanti i batalionit Dushan Shametaj, shef i Planëzimit në Degën e Arsimit Çlirim Pulaj, pedagogu i taktikës Nikollaq Bero, studentët Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa dhe Bujar Ago, ishin oficerë dhe studentë me shpirt dhe zemër heroike, të gjithë të rinj që e kishin të shenjtë dashurinë për atdheun dhe për shokët deri në sakrificën supreme.

4 vjet pa “Dëshmorin e Atdheut”, kapitenin Feti Vogli

Duke përkujtuar kapitenin e lavdishëm Feti Vogli, jemi në krah të atyre djemve që vazhdojnë misionin në Afganistan, në Mali apo në ndonjë vend tjetër.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura përkujtuan më 20 shkurt 2016, 4-vjetorin e rënies së “Dëshmorit të Atdheut”, kapiten Feti Vogli gjatë misionit Combat “Eagle 4”, në Kandahar të Afganistanit.

Në ceremoninë e zhvilluar në mjediset e Batalionit të Forcave Speciale në Zall-Herr, morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, familjarë, të afërm, ish-kolegë të dëshmorit si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Fjalën e rastit në këtë ceremoni e mbajti zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, i cili vlerësoi veprën e kapiten Feti voglit dhe të kolegëve të tij që vijnë angazhimin në misionet ndërkombëtare.

“Sot jemi mbledhur këtu për të përkujtuar veprën e “Dëshmorit të Atdheut” kapiten Feti Vogli. Ne humbëm një koleg të shkëlqyer, një koleg me veti të rralla, siç ishte kapiten Feti Vogli. Kjo është një ditë prove, se Shq-

ipëria jo vetëm me fjalë e me fjalime, është e përkushtuar për paqe stabilitetin dhe lufta ndaj terrorizmit në botë, por është e përkushtuar me vepra. Kjo është një ditë vendosmërie, sepse ne sot deklarojmë me zë të fortë se Shqipëria do të vazhdojë të investohet për paqen. Do të investohet për të luftuar terrorizmin kudo në botë. Ne sot japim një provë tjetër se jemi një vend dinjitoz anëtar i NATO-s. Ne jemi në krah të aleatëve të mëdhenj të Shqipërisë, SHBA-ve dhe të gjitha vendeve të NATO-s. Duke përkujtuar kapitenin e lavdishëm Feti Vogli, jemi në krah të atyre djemve që vazhdojnë misionin në Afganistan, në Mali apo në ndonjë vend tjetër. Ne jemi këtu sot për të qenë në krah të çdo familjeje të ushtarakëve të Forcave tona të Armatosura”, -tha zëvendësministri Koçi.

Në përfundim të ceremonisë zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bazo bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule pranë bustit të Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, i cili ra dëshmor më 20 shkurt të vitit 2012, pjesë e misionit Combat “Eagle 4”, në Kandahar të Afganistanit.





Joint Effort 2016 dhe Albania Lion 2016

Stërvitje të përbashkëta Shqiptaro-Britanike

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani ka pritur në 4 shkurt 2016 atasheun e Britanisë së Madhe të akredituar në vendin tonë, nënkolonel Richard Parry. Takimi u fokusua në marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes mes dy vendeve dhe forcave tona të Armatosura dhe konkretisht në bashkëpunimin e shkëlqyer që Forca Tokësore ka me ushtrinë britanike.

Gjeneral Cahani pasi vlerësoi ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm midis reparteve të ushtrive tona si dhe asistencën e vyer në stërvitjet dhe angazhimet tona luftarake të deritanishme, me anë të një prezantimi të shkurtër e njohu atasheun anglez me kontributet dhe arritjet e FT, duke u ndalur në vazhdimin e misioneve në Afganistan, si një angazhim real në luftën globale kundër terrorizmit. Më tej, gjeneral Cahani theksoi edhe përfshirjen dhe vlerësimin serioz që qeveria shqiptare dhe të gjitha strukturat e FA si dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese,

“Duhet të thejtmë tabutë dhe përgatitjen dhe zhvillimet tradicionale të stërvitjeve. Duhet të jemi më aktualë, më bashkëpunues, më të zhdërvjellët dhe fleksibël duke futur elementë të rinj në stërvitje, të cilët i përgjigjen stadi aktual të kërcënimeve dhe rreziqeve që NATO po përballlet sot”

po i bëjnë kërcënimit terrorist ndaj ISIS.

Nga ana e tij atasheu anglez, nënkolonel Parry, pasi falënderoi dhe vlerësoi me nota pozitive bashkëpunimin e deritanishëm, shprehu nevojën e zhvillimit të stërvitjeve më të shumta midis dy vendeve, për t'u njohur dhe adoptuar më mirë, duke shkëmbyer përvojën e secilës palë. Nënkolonel Parry përgëzoi edhe një herë performancën e treguar nga trupat shqiptare, si në misionet ushtarake ashtu edhe në stërvitjet dypalëshe të zhvilluara me

homologët anglezë. “Përvoja juaj nuk është vetëm vlerë për juve, por unë them me bindje, që kjo përvojë i nevojitet edhe ushtarëve britanikë në kryerjen e stërvitjeve Joint Effort - 2016 dhe Albania Lion 2016”, u shpreh nënkolonel Parry

Të dy bashkëbiseduesit u ndalën dhe në parapërgatitjen e strukturave të FT, për të bashkëpunuar me ato britanike në kuadër të dy stërvitjeve të përbashkëta të planifikuara për vitin 2016. Stërvitjet Joint Effort 2016 dhe Albania Lion 2016, të cilat për kohën dhe situatën kur ato do të kryhen, marrin një rëndësi të veçantë pasi kërcënimi terrorist ndaj ISIS në veçanti, kërkon një bashkëveprim dhe kooperim ndërinstytucional dhe ndërkombëtar. “Duhet të thejtmë tabutë dhe përgatitjen dhe zhvillimet tradicionale të stërvitjeve. Duhet të jemi më aktualë, më bashkëpunues, më të zhdërvjellët dhe fleksibël duke futur elementë të rinj në stërvitje, të cilët i përgjigjen stadi aktual të kërcënimeve dhe rreziqeve që NATO po përballlet sot”, theksoi ndër të tjera gjeneral Cahani në takim.



MFSK-Hungari: Gati Memorandumi i Bashkëpunimit

Ministri i ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Haki Demolli me bashkëpunëtorë, priti më 2 shkurt 2016 në takim zyrtar zëvendës ministrin e Mbrojtjes të Hungarisë, Tamas Vargha. Fillimisht, Ministri Demolli në emër të Ministrisë dhe FSK-së e falënderoi zëvendës ministrin e Mbrojtjes të Hungarisë për interesimin e vazhdueshëm që po tregon Ministria e Mbrojtjes së Hungarisë për vazhdimin e thellimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit me ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës si dhe mbi hapat që do të ndërmerren në vazhdim në drejtim të zyrtarizimit dhe konkretizimit të bashkëpunimit. Ministri Demolli gjithashtu u shpreh se Ministria për FSK-në është angazhuar me seriozitet rreth finalizimit të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për FSK dhe Ministrisë të Mbrojtjes të Hungarisë. Ministri i FSK-së tha se krahas bashkëpunimit me ministri të mbrojtjes të shumë vendeve tjera që aktualisht ka Kosova, zyrtarizimi

i marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes të Hungarisë ka rëndësi të madhe. Nga ana e tij, zëvendës, ministri i Mbrojtjes të Hungarisë, Tamas Vargha tha gjithashtu se edhe Ministria e Mbrojtjes është në përfundim të punës për finalizimin

e marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë për FSK dhe se Ministria e Mbrojtjes e Hungarisë do të angazhohet më tutje për ta mbështetur Ministrinë për FSK dhe Kosovën në iniciativat rajonale dhe më gjerë.



Turqia: Donacione dhe trajnime për efektivat e FSK-së

Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama priti më 2 shkurt 2016, në takim komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë, gjeneralin Salih Çolak, i cili në krye të një delegacioni të lartë zhvilloi një vizitë zyrtare në Kosovë. Komandanti i Forcave Tokësore të Turqisë u prit me ceremoni ushtarake nga Njësia Ceremoniale dhe Trupa muzikore e FSK-së. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama falënderoi komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë, gjeneralin Çolak dhe përmes tij Qeverinë e Turqisë për përkrahjen e madhe që ata po japin jo vetëm në fushën e arsimit, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së me donacione, në kuadër të bashkëpunimit të gjerë mes dy ministrive dhe dy shteteve mike. Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama, e njoftoi komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë dhe delegacionin që ai drejton me zhvillimet aktuale dhe



sfidat që e presin FSK-në, duke nënvizuar transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK). Gjithashtu, gjeneral Rama, e njoftoi gjeneralin Çolak edhe lidhur me bashkëpunim e mirë të FSK-së me NATO-n, KFOR-in dhe partnerët tjerë strategjikë. Komandanti i Forcave Tokësore të Turqisë, gjenerali Salih Çolak prem-

toi thellimin e bashkëpunimit mes Ushtrisë së Turqisë dhe FSK-së, si dhe angazhimin e vendit të tij në përkrahjen e Kosovës dhe të FSK-së, drejt anëtarësimit në organizmat ndërkombëtarë dhe në NATO. Gjatë qëndrimit në Ministri, delegacioni i Ushtrisë së Turqisë u prit edhe nga Ministri i FSK-së, Haki Demolli.

Garda Kombëtare e IOWA-s: Përfundon trajnim “Menaxhimi i Fatkeqësive”

Më 12 shkurt 2016, në kazermën “Adem Jashari” të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, përfundoi trajnimi njëjavor “Menaxhimi i Fatkeqësive”, i realizuar nga ekipi i instruktorëve të Gardës Kombëtare të IOWA-s të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë trajnim morën pjesë 15 pjesëtarë; tetë nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), pesë nga Agjencia

për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe dy nga Policia e Kosovës. Fillimisht, instruktori i Gardës Kombëtare të IOWA-s, koloneli Adams i njoftoi të pranishmit me ecurinë e trajnimit. Ai njëherësh shprehu kënaqësinë e tij për suksesin e treguar të pjesëmarrësve gjatë këtij trajnimi. Ndërsa, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, falënderoi instruktorët për vull-

netin dhe gatishmërinë e tyre në mbështetje të FSK-së, “Shfrytëzoj rastin të falënderojë ekipin e instruktorëve nga IOWA, që na mundësuan shkëmbimin e përvojave të tyre, të cilat janë mjaft të rëndësishme për vendin tonë, duke pasur parasysh eksperiencat e jashtëzakonshme që ka shteti i IOWA-s me fatkeqësi të ndryshme natyrore”. Ai falënderoi edhe komandantin e Gardës Kombëtare të IOWA-s, Gjeneralin Orr, për bashkëpunimin e deritashëm dhe u shpreh i bindur se ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej në të ardhmen. Në fund të ceremonisë, gjeneral Hazrolli, në shenjë respekti për punën e instruktorëve amerikanë ndau për ta mirënjohje, ndërsa për pjesëmarrësit e trajnimit certifikata.



Ministria e FSK: 365 ditë me homologët ndërkombëtarë

Gjatë vitit 2015 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka arritur rezultate në fushën ndërkombëtare. "Kemi zhvilluar procesin e koordinimit, hartimit dhe finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit bilateral me Republikën Çeke, Ministrinë Federale të Mbrojtjes dhe Sportit të Austrisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Zvicrës. Pastaj, thellimin e bashkëpunimit bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës të Kroacisë, Ministrinë Federale të Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë, Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Letonisë, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovenisë. Janë koordinuar të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të planeve bilaterale për vitin 2015 me vendet partnere. Është bërë koordinimi i të gjitha trajnimeve dhe aktiviteteve të shkëmbimit të përvojave me vendet me të cilat MFSK dhe FSK zhvillojnë bashkëpunim bilateral. NATO



me Ekipin Këshillëdhënës (NAT) në nivel të MFSK-së dhe me Ekipin Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës (NLAT) në nivel të FSK-së, edhe gjatë vitit 2015 ka dhënë kontribut tejet të rëndësishëm në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale në të gjitha fushat dhe nivelet", ka deklaruar z. Haki Demolli, Ministër i Forcës

së Sigurisë së Kosovës. Oficerët në përgjithësi në të gjitha trajnimet dhe shkollimet në qendrat arsimore ushtarake kanë treguar rezultate të larta e për këtë vit. Përmendet suksesi i oficerit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Toger Ismail Hoxha, i cili është shpërblyer me "Shpatën për studentin më të mirë", çmim të cilin ia dhuroi në mënyrë ceremoniale Princi Charles. Kjo është hera e parë që Akademia Mbretërore Ushtarake e Britanisë së Madhe jep këtë çmim për një oficer nga Ballkani.

Ministri Demolli thotë se: "Gjatë të vitit 2015, pjesëtarët e FSK-së kanë marrë pjesë në trajnime të mbajtura në Kosovë, SHBA dhe vende të tjera. Një numër i konsiderueshëm i këtyre trajnimeve kanë qenë të ofruara nga SHBA-të përmes ODC-s. Gjatë periudhës kohore shtator 2014-shtator 2015 trajnimet të cilat kanë qenë të planifikuara në Programin Shtetëror (SPP) në mes Kosovës dhe Iowa-s, përkatësisht Forcës së Sigurisë

së Kosovës dhe Gardës Nacionale të Ilova-s janë realizuar sipas planifikimeve fillestare. Trajnimet apo seminarët që janë mbajtur në bashkëpunim me Gardën Nacionale të Ilova-s janë përqendruar në mbrojtjen kibernetike, menaxhimin e resurseve njerëzore, zhvillimin profesional ushtarak, ndërveprueshmërinë dhe dislokimin e forcave të kombinuara tokësore, zhvillimet strategjike, kapacitetet reaguese gjatë fatkeqësive natyrore, partneritetit dhe bashkëpunimit 31 regjional, kapacitetet operacionale të logjistikës, zhvillimin e doktrinës, planifikimin dhe ekzekutimin e ushtrimeve fushore të realizuara në Kosovë dhe Ilova si dhe vizita të niveleve të ndryshme me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të FSK-së".

Pjesëmarrja në iniciativat rajonale dëshmon se trendi për procesin e anëtarësimit është në rrugë të mbarë. Gjatë vitit 2015 evidentohet prania në Seminarin "Qasja rajonale në reduktimin e armëve të tepërt-RASR" e organizuar nga RACVIAC-Kroaci; Konferencën "Joint Reaction 2015"-Shqipëri; Konferencën lani-fikuese të paraparë për ushtrimin "Immediate Response 2015"-Slloveni/Kroaci; pjesëmarrjen në takimin vjetor të shefave të logjistikës të forcave të armatosura në kuadër të Kartës së Adriatikut- A5-Maqedoni; Sesionin trajnues për "Rolin e Shoqatave dhe Asociacioneve të Ushtrive në Shtetet e Ballkanit" EUROMIL-Maqedoni; Konferenca e Muniht "European Defence Summit 2015"-Bruksel; Konferencën e Shefave të Mbrojtjes në kuadër të Kartës së Adriatikut A5-Maqedoni; Takimi vjetor i drejtoreshave të politikave të Mbrojtjes të organizuar në kuadër të A-5 Kartës së Adriatikut-Bosnje dhe Hercegovinë; Seminari "Zhvillimi i Nënoficerëve"-Bullgari; Konferenca për Siguri të Evropës të organizuar nga Komanda Evropiane e ShBA-ve për Evropë (EUCOM), zhvilluar në Qendrën "George Marshall", në Garmisch të Republikës Federale Gjermane; Konferenca „ShBA-Karta e Adriatikut 5”, me temë "Barazia Gjimore, Integrimi dhe Perspektiva



Ambasadorja e Kroacisë, Kapitanovic: Bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen

Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli priti më 12 shkurt ambasadorën e Republikës së Kroacisë në Kosovë, znj. Marija Kapitanovic. Fillimisht ministri Demolli i uroi ambasadores kroate detyrën e re, dhe pasi i dëshiroi mirëseardhje e falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që Kroacia po jep për Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Demolli, me këtë rast, e njoftoi ambasadorën Kapitanovic me zhvillimet e përgjithshme të Ministrisë që ai drejton, si dhe me zhvillimet e deritashme rreth transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosura të Kosovës. Gjithashtu ministri i FSK-së i shprehu ambasadores Kapitanovic dëshirën e tij për të rritur bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes mes dy vendeve nëpërmjet edukimit dhe trajnimeve të përbashkëta. Nga ana e saj, ambasadorja Kapitanovic, shprehi kënaqësinë për vizitën e saj në Ministrinë e FSK-së, duke nënvizuar bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve, veçanërisht në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë. Ajo vlerësoi lartësidomos bashkëpunimin e dyanshëm në mes dy forcave, si dhe premtoi rritjen e nivelit të bashkëpunimit në të gjitha fushat që janë me interes edhe për FSK-në. Po ashtu ambasadorja Kapitanovic edhe një herë theksoi se ky bashkëpunim do vazhdojë edhe në të ardhmen në mes dy vendeve dhe dy ministrive.

në Strukturat Ushtarake"-Shqipëri; Samiti i II-të Evropian i Mbrojtjes, në organizimin e Konferencës për Siguri të Mynihut, Bruksel; Konferenca në kuadër të SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), të shefave të Mbrojtjes të shteteve të rajonit dhe të Komandës Amerikane në Evropë (USEUCOM)-Maqedoni; Takimi gjithëpërfshirës regjional i ministrave të mbrojtjes (Comprehensive Regional Ministerial-CMR)-Kroaci; Konferenca vjetore e ushtrive të shteteve të Evropës, sponsorizuar nga Komanda e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Evropë (U.S. Army Europe), në Wiesbaden të Gjermanisë; Konferenca e 10 e sigurisë "Konferenca e Rigës" (Riga Conference), Letoni, dhe-pjesëmarrjen në Konferencën "Avancimi

i sigurisë nga vizioni modern", organizuar nga Forumi Ndërkombëtar i Halifaksit për Siguri, në Halifaks të Kanadasë". ku është diskutuar për bashkërendimin e asistencës së ofruar FSK-së nga vendet partnere. Tërë këto angazhime politiko-ushtarake të evidentuara gjatë vitit 2015, që nënvizuan më sipër tregojnë se rruga e Forcës së Sigurisë së Kosovës është në konsolidimin e saj si një forcë progresive, aleate e forcave ndërkombëtare dhe e besueshme për ruajtjen e sigurisë në rajon, por edhe e aftë për të marrë pjesë në misione ndërkombëtare. Mbi këtë bazë pritshmëritë për vitin 2016 janë edhe më të mëdha".

Jolevski në SHBA: Mbështetja amerikane është e plotë

Në fillim të muajit shkurt 2016, Ministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, z. Zoran Jolevski ka zhvilluar vizitë në SHBA i pranishëm edhe në mengjezin e lutjeve, ku mbështetja amerikane nuk ka munguar. Gjatë takimeve bashkëbiseduesit dhanë mbështetje të plotë për anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancën e NATO-s, ndërsa shprehën edhe mirënjohje për mbështetjen shumëvjeçare të Maqedonisë në vendosjen e paqes, sigurisë dhe demokracisë në suaza globale.

Në Shtëpinë e Bardhë ministri Jolevski realizoi takim me Celeste Valender, këshilltar special i Presidentit Barak Obama dhe drejtor në Këshillin për Siguri të SHBA, ndërsa në Departamentin Shtetëror ministri u takua me Hojt Ji, zëvendësndihmës sekretar për Evropë dhe Euroazi. Në takimet e ndara ministri Jolevski dhe bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime për integrimin e Republikës së Maqedonisë në NATO, për proceset reformuese brenda Armatës, si dhe për gjendjen e sigurisë në rajonin e Evropës Juglindore dhe me gjerë. Në kuadër të vizitës, në Pentagon, ministri Jolevski u takua me Drejtorinë për Rusinë, Ukrainën dhe Evropën, Laura Gros, ku u bisedua për ndërmarjet reformuese brenda Ministrisë. "Prioriteti i yni është të ruajmë dhe avancojmë kapacitetet e Armatës së Republikës së Maqedonisë, ndërsa kjo nënkupton investime në arsimim dhe trajnime, si dhe investime në pajisje", tha ministri. Drejtorja Gros theksoi se SHBA-të vazhdojnë të mbështesin Maqedoninë në rrugën



drejt anëtarësimit të plotë në NATO. Njëkohësisht, ajo falënderoi pjesëmarrjen në Afganistan dhe ndihmën bujare në vendosjen e paqes, demokracisë dhe sigurisë në këtë pjesë të botës.

Në takimin me senatorin Xhon Mekejn, ish kandidatët presidencial, ministri Jolevski tha se ka ardhur koha që Republika e Maqedonisë të marrë vendin e saj të merituar si anëtare e plotë e NATO-s. Senatori Mekkej u pajtua plotësisht me faktin se Maqedonia ka përfunduar me reformat e duhura për anëtarësim. Ai theksoi se bashkëpunimi midis Maqedonisë dhe SHBA-së si partnerë strategjikë është e dobishme për të dyja vendet dhe shprehu mirënjohje që e njëjta frymë zhvillohet në kontinuitet. Ministri Jolevski

u takua edhe me kongresmenen Valorski, si dhe me këshilltarët kryesorë të kandidatit presidencial, senatorit Marko Rubio, me këtë rast theksoi se Maqedonia është e përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit bilateral me SHBA, e cila është përforcuar me nënshkrimin e Deklaratës për Partneritet Strategjik, të nënshkruar në vitin 2008. Delegacioni nga ministria pati edhe një drekë pune me përfaqësues të shquar të grupeve "think-tank" më me emër në Uashington, ku morrën pjesë edhe nëpunës nga Pentagoni dhe Departamenti i Shtetit. Ajo që vlen të përmendet është se përfaqësuesit e komunitetit "think-tank" theksuan mbështetjen për integrimin sa më të shpejtë të Republikës së Maqedonisë në NATO.

Ndërkohë në datën 3 shkurt ministri, Zoran Jolevski bëri një prezantim në tryezën e rrumbullakët pranë Komitetit për Forca të Armatosura në Senatin e SHBA-së, ku folës ishin shumë senatorë, kongresmenë dhe përfaqësues nga Evropa Juglindore. Fjalën përmbyllëse në tryezën e rrumbullakët e mbajti senatori Mekejn. Gjatë diskutimit u konstatua se bashkëpunimi ndërmjet shteteve është kyç në përballjen me kërcënimet asimetrike me të cilat ballafaqohet bota. Ministri Jolevski theksoi se integrimi i vendeve të rajonit në NATO dhe në Bashkimin Evropian do të kontribuojë për përforsimin e mëtejshëm të vendeve të rajonit dhe do të ndikojë pozitivisht në stabilitetin dhe prosperitetin e vendeve nga Evropa Juglindore. Njëkohësisht, Jolevski kërkoi që sa më parë Republikës së Maqedonisë t'i jepet ftesa për anëtarësim në NATO.

Në Uashington ministri Jolevski realizoi takime edhe me zëvendësndihmës sekretarin për politika mbrojtëse të Evropës dhe NATO-s, Daniel Fata. Gjatë takimit ministri Jolevski tha se anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në NATO do të kontribuojë në vendosjen dhe ruajtjen e një klime sigurie stabile në rajon dhe më gjerë. Fata theksoi se Republika e Maqedonisë dhe Armata e Republikës së Maqedonisë me pjesëmarrjen në misionet paqeruajtëse në ISAF deri në vitin 2015, ndërsa më tej edhe në „Mbështetje e Vendosur“ është dëshmuar si mbështetëse e vërtetë e vlerave globale për paqe dhe demokraci. Gjatë diskutimit në temën „Siguria dhe Kriza e Migrantëve në Ballkanin Perëndimor“ të organizuar nga Fondi Gjerman „Marshall“ ministri Jolevski tha se: „Kriza me migrantët është sfidë e përbashkët e Evropës dhe prandaj ka nevojë të shtohet bashkëpunimi dhe koordinimi midis shteteve të prekuara nga ajo. Ngjarjet e fundit imponuan domosdoshmëri për mbështetje, bashkim, jo vetëm në BE, por edhe më gjerë. Z. Zoran Jolevski është takuar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork edhe me ndihmës zëvendës sekretarin për operacione paqeruajtëse pranë Kombeve të Bashkuara, El Gasim Uejn.

“Balkan Medical Task Force” projekt norvegjezo-amerikan:

Shkupi do jetë qendra e mjekësisë ushtarake rajonale

Në këtë qëndër do jenë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina (BeH), Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Sllovenia

Projekti “Forcat Mjekësore Ballkanike (Balkan Medical Task Force BMTF)” është i rëndësishëm jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për rajonin”, deklaroi ministri i Mbrojtjes të Maqedonisë, Zoran Jolevski sipas të cilit kjo gjë bëhet në frymën e “mbrojtjes së mençur”. Jolevski bashkë me zëvendës shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, Muhamed Racaj, kanë diskutuar për statusin, planet, detyrat dhe obligimet e Forcave Mjekësore Ballkanike të cilat janë të përfshira në këtë projekt. Njëri nga momentet më të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të projektit është nënshkrimi i marrëveshjes ndërkombëtare- ratifikimi i së cilës pritet në vazhdim me çka projekti do të fillojë të zbatohet zyrtarisht. Selia e Shtabit do të jetë në Shkup, njofton Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë. Nisma “Balkan Medical Task Force” (BMTF) është projekt i iniciuar nga Mbretëria e Norvegjisë dhe SHBA-të, ndërsa vendet e pjesëmarrëse janë Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina (BeH), Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Sllovenia. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i kapaciteteve mjekësore për punë në suaza të njësitit multinacional rajonal, përforsimi i kapaciteteve ushtarake-mjekësore të standardizuara dhe në nivel të lartë interoperues me OKB-në, NATO-në, BE-në dhe Partneritetin për Paqe.



Ohër: Shkollë javore kundër kërcënimeve në EJT

Në Ohër të Maqedonisë u hap “shkolla” një javore e NATO-s për përballje me kërcënimet nga terrorizmi në Evropën Juglindore. Duke u drejtuar para të pranishmëve në këtë tubim ministri i Mbrojtjes Zoran Jolevski tha se ky takim dhe trajnim do të jetë një mundësi e mirë për shkëmbimin e përvojave dhe përpunimin e metodave për veprim sa më efikas në luftën kundër terrorizmit. Ministri shtoi se diskutimet mes pjesëmarrësve në këtë tubim, kontaktet personale, do të japin kontribut në bashkëpunimin sa më efikas midis shteteve të rajonit për përmirësimin e gatishmërisë sonë në përballjen me sfidat e sigurisë si që është terrorizmi ndërkombëtar. Trevis Moris, profesor nga Qendra për Luftë dhe Paqe pranë Universitetit „Noruiç“ nga SHBA theksoi se nëpërmjet këtyre trajnimeve lidhen aktivitetet e të gjitha institucioneve shtetërore përgjegjëse për sigurinë në shtetet e rajonit. Këtu shpresojmë të dëgjojmë praktika dhe propozime dhe të njëjtat t'i inkorporojmë në sistemin rajonal të sigurisë,” tha Moris. Dekani i Akademisë Ushtarake, koloneli Orce Popovski shprehu kënaqësi që ky institucion për herë të katërt në dy vitet e kaluara fiton besimin dhe nderin për të organizuar një ngjarje të këtillë, kurs të avancuar për ekspertë ushtarak dhe të sigurisë nga të gjitha vendet e rajonit. Kursi i avancuar i mbështetur nga Aleanca e Atlantikut të Veriut në Ohër mbahet me organizim të Akademisë Ushtarake nga Shkupi dhe Qendra për Luftë dhe Paqe pranë Universitetit „Noruiç“ nga SHBA. Në kurs morrën pjesë rreth pesëdhjetë përfaqësues të institucioneve nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes të dhjetë vendeve të rajonit, si dhe ekspertë nga SHBA dhe Kanada.

NATO planifikon forcimin e pranisë në Lindje

Aleanca ushtarake ka marrë masa për të siguruar anëtarët e saj në kufijtë lindorë, të cilët ndihen të kërcënuar nga Rusia. Plani i ri ka për qëllim ta çojë më përpara këtë siguri, me një kombinim të trupave tokësore dhe shtimin e dislokimeve për parandalimin e çdo agresori të mundshëm.

"Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s kanë miratuar një plan për të forcuar praninë e aleancës më të fuqishme ushtarake të botës në lindje të Evropës", deklaroi me 10 shkurt në Bruksel, Sekretari i Përgjithshëm i saj, Jens Stoltenberg, në një lëvizje për parandaluar sulmet nga vende të tilla si Rusia. Marrëdhëniet mes NATO-s dhe Rusisë në dy vitet e fundit kanë arritur nivelin e tyre më të ulët që nga periudha e Luftës së Ftohtë, pas veprimeve të Moskës në Ukrainë, ku ajo akuzohet për mbështetje të separatistëve prorusë dhe aneksimin e Gadishullit të Krimesë. Aleanca ushtarake ka marrë masa për të siguruar anëtarët e saj në kufijtë lindorë, të cilët ndihen të kërcënuar nga Rusia. Plani i ri ka për qëllim ta çojë më përpara këtë siguri, me një kombinim të trupave tokësore dhe shtimin e dislokimeve për parandalimin e çdo agresori të mundshëm. "Ne duam krijimin e një pranije shumëkombëshe me trupa, që do të dërgojë një sinjal shumë të fortë të unitetit të NATO-s", theksoi Stoltenberg. "Një sulm kundër një aleati është një sulm kundër të gjithë aleatëve. Ne do t'i

përgjigjemi njëzëri çdo akti agresioni", shtoi ai. Detajet e këtij plani-përfshirë numrin e trupave-do të përpilohen nga ushtarakët gjatë muajve të ardhshëm, në prag të samitit të NATO-s në Varshavë, në korrik.

Sidoqoftë, ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov e akuzoi NATO-n për përhapjen e frikës ndaj një kërcënimi rus për të justifikuar ekzistencën e saj dhe për t'u zgjeruar drejt Lindjes. "NATO-ja duhet të qëndrojë brenda kufijve të saj. Veprimet e NATO-s po krijojnë një faktor destabilizimi për sigurinë globale", deklaroi Lavrov, i cituar nga agjencia zyrtare ruse e lajmeve, TASS. Lavrov kritikoi ashpër edhe ftesën që aleanca i bëri Malit të Zi për anëtarësim. Vendi i NATO-s vjen pasi presidenti amerikan, Barack Obama njoftoi se do të kërkojë një rritje të ndjeshme të fondeve të Uashingtonit për sigurinë e Evropës, që shkojnë deri në 3,4 miliardë dollarë. "Këto para do të përdoren, veç të tjerash, edhe për praninë e 3.000 trupave amerikane në Evropë si edhe për dislokimin e pajisjeve ushtarake dhe armatimeve në rast emergjence", deklaroi një zyrtar amerikan në kushte anonimat.



Piloti Niazi Nelaj, që la gjurmë në aviacionin ushtarak shqiptar

ALBERT Z.ZHOLI

Me ish-pilotin veteran Niazi Nelaj, bise-
dojamë më shumë në FB. Ai është një
enciklopedi më vete për gjithë brezat e
pilotëve ushtarak shqiptarë. Herë pas
here më sjell në vëmendje shumë por-
trete të pilotëve që kanë lënë gjurmë
në aviacionin luftarak shqiptar. Një ndër ta është dhe
Mustafa Bajram Gjokutaj. "Kur morën udhën për në
Moskë, më 26 gusht të vitit 1960, me një aeroplan të
tipit Tu-104, nga aerodromi ushtarak i Rinasit, në bordin
e aeroplanit ishin mjaft adoleshentë që u drejtoheshim
shkollave sovjetike, për t'u bërë oficerë, në specialitete
të ndryshëm. 36 djem, mbasi kishin kaluar në sitën e
testeve ushtarako-mjekësore të kohës, shkuam në
shkollën e aviacionit, në qytetin e Batajskut, qarku i
Rostovit mbi Don. E kishin ndarë mendjen, për t'u bërë
pilotë", më thotë Niazi Nelaj.

**Si qëndronit në avion kur u nisët, çfarë përcillnit
në mendje?**

Qëndronim disi të ndrojtur, ndoshta si pasojë e
ndarjes me tanët; nga rrugëtimi ajror, të cilin e pro-
vonim për herë të parë apo ngaqë po shkonim larg, në
dhe të huaj, por 4 djem veçoheshin nga të tjerët. Ata
ishin ish "Skënderbegas"; të katër e kishin përfunduar.
Po të gërmojmë në listat e asaj kohe, do të gjejmë
identitetet e tyre të cilët, edhe pse të paktë mes asaj
mase studentësh të larmishëm do të lexojmë emrat e:
Ahmet Sulejman Zogut, nga Valikarda e Dibrës; Bashkim
Dervish Kozeli, nga Kozeli i Kolonjës; Fadil Nexhip Nenaj
(Braho), me origjinë nga Gjirokastra dhe Mustafa Bajram
Gjokutaj, nga Kuçi i Kurveleshit. Mes grupit tonë, të
shumtë në numër, ata nuk u shkrinë, si kripa në ujë, por
ruajtën identitetin e i dhanë tonin jetës së grupit. Çdo
njeri që përpigjej të vrojtonte grupin tonë, nuk e kishte
të vështirë të shquante "ish-skënderbegasit" të cilët,
në çdo rast "dilin mbi ujë".



**Po çfarë i mundësonte që ata të shqueshin mes
jush?**

Para së gjithash, ata dalloheshin nga mënyra si ec-
nin. Ata gjatë kohës kur mësonin në shkollën ushtarake
"Skënderbej" ishin "përpunuar"; ishin të zhdërvjellët;
ecnin të lirshëm e të kapardisur; uleshin lehtë-lehtë, si
pupël, qëndronin drejt kur uleshin e nuk lejonin që trupi
i tyre të dukej i gërmuqur; dinin ta mbanin të pastër
e të rregullt uniformën, e cila u qëndronte bukur në
trup. Vështrimi i tyre i mprehtë e tejshpues krijonte

përshtypjen e njerëzve të zgjuar e të shkathët. Ata e njihnin rregullin e disiplinën ushtarake dhe ishin rritur me to. Karakteristikë dalluese ishte lidhja e ngushtë me njëri-tjetrin dhe miqësia e çiltër që ishte vendosur mes tyre. Gjykuar nga këta pozicione, mund të arrihet në përfundimin se, të katër djemtë azganë, të ardhur nga Shkolla Ushtarake "Skënderbej", shpejt u bënë pjesa jonë e pandashme dhe, në një farë mënyre, morën rolin e liderit, në kuptimin e pikës së referimit. Ata u bënë udhëheqje, për sjelljen tonë. Ndonëse ata kishin mjaft tipare të përbashkëta, secili prej tyre kishte identitetin dhe integritetin e vet. Ahmeti: i urtë; i qetë; i sjellshëm; fjalëpak; i "shkëlqyer" në mësim, dashamirës e i shkuar, me të gjithë. Bashkimi: botë më vete. i zhytur në labirintet e poezisë, shquhej për zgjuarsin e shkathtësinë, për kapjen në kohë të problemeve. Fadili: njeri serioz, kurajoz, sqimatar, tip sportiv e me dashamirësi dhe Mustafai, brenda të cilit fshihej një botë tejet e pasur e interesante.

Mund të flasësh pak më gjerë për Mustafanë?

Mustafain, ne, shkurt e thërrisnim Musto, siç e quanin dikur, në shkollën "Skënderbej". Mustua, në trup nuk ishte "gjigand" por mesatar; i ngjeshur, muskuloz e i shëndetshëm. Konstruksioni dhe shëndeti i tij, ishin si ata që kërkohen për pilotët. Nuk ishte e lehtë të depërtoje në botën e tij të brendshme, edhe pse, në karakter ish i çiltër. Mustua shfaqej dalëngadalë, si ajo nëndetësja kur del nga uji. Ai nuk shquhej për shkathtësinë e sportivitetin por kishte disa vlera të rralla. "Pasuritë" e Mustafa Gjokutës ishin: zgjuarsia, mençuria, të qenit tip i shoqërueshëm, mprehtësia dhe reflektimi i shpejtë, vështrimi i mprehtë e depërtues. "Mustua" ta blinte mendjen e të peshonte", me një të parë, si një psikolog i mirë. E veçanta e Mustos, ajo që e dallonte edhe mes, shokëve të tij "ish-Skënderbegas" ishte të qenit gaztor e njeri me humor të pëlqyeshëm. E donim dhe e respektonim, të gjithë. Ndoshta dhe për shkak të humorit të tij, apo kryesisht, nisur nga sjellja me dashamirësi. Pinte shumë duhan dhe e zgjidhte të fortë. Sytë e tij të kaftë ishin shumë vrojtues e reflektonin zgjuarsin. Balli i lartë e flokët të rëna, përpara, dëshmonin fisnikërinë e tij që nga burimi. Mustua ishte një tregimtar i përkryer. Në netët kur nuk na flihej e mezi na merrte gjumi, Mustua, me rrëfimet e tij, të larmishme, na vinte në gjumë. Na tërhiqnin rrëfimet e tij e ne e dëgjonim, me gojën hapët e veshët ngrëhtë. Ai na dëftonte, me humor, ndodhitë e shkollës ushtarake "Skënderbej"; jetesën, personelin, kuadrot dhe qyfyret që bënin, ai e shokët e tij. I kam të ngulitura, sot e kësaj dite rrëfimet me humor të këndshëm të Mustos. Mustua ishte kurajoz. Kur e gjykonte se e kishte të drejtë mendimin, ai ngulte këmbë për ta mbrojtur atë, përballë kujtdo njeriu. Rrëfimet e tij ishin të ngrohta, na përshtateshin sipas moshës dhe origjinës, na dukej sikur ishim në familje, pranë tanëve, na vinin të ngrohta, prindërore dhe na krijonin ndjesinë se preknim një copë Shqipëri. E them, krenari e nostalgji përzier se isha me fat që u ndodha mes atij kolektivi të rrallë, ku dashuria për njëri-tjetrin ishte si ajo e të rinjve të asaj kohe, pa asnjë fare interesi e paragjykim. Prandaj arrij në përfundimin logjik se Mustafa Gjokutaj, kur ishim larg vatrave tona, na u bë "jatak" e ne, të gjithë, ndiheshim ngrohtë, nën të. Në vitet e fundit, një ditë, pasi ishte bërë një festë përkujtimore në shkollën "Skënderbej", një

ish-Skënderbegas, kur më pa në rrugë, më ndaloi e tha: "Nuk të pashë dje, ku ishe, në festën e shkollës"? Me çiltërsi i thashë: "Po unë nuk kam qenë Skënderbegas, ato që di për atë institucion, m'i ka thënë Mustafa Gjokutaj. Tjetri bëri të habiturin.

Çfarë dallohej në rrëfimet dhe punën e tij?

Në rrëfimet e Mustos, shquaje, me lehtësi të folurën labçe, artikulin e fjalëve, vënge, me një llasim karakteristik e më një fjalor të pasur. Nga goja e Mustafa Gjokutaj dilnin vetëm fjalë të mençura e të gjetura. Ai, kur rrëfente, të linte përshtypjen sikur sapo kishte zbritur nga stani. Në Batajsk, kur studionim për t'u bërë pilotë, u lidhëm aq shumë me Muston, sa nuk na dalloje lehtë, kush kish qenë Skënderbegas e kush jo. Ishte aftësia e pazakontë e tij, që na afronte e na bënte të "shkriheshim" nga shakatë që bënte. Edhe kur ndonjë shaka e tij dukej e rëndë; e "lyer" me humorin e Mustos, nuk lëndonte njeri. Ndonjë herë na kaplonte mërzitia. Qeshnim me shakatë e tij dhe e harronim objektin e mërztisë. Mustua kishte aftësi të veçanta për ta transformuar gjendjen amorfe të shokëve, në një gaz, i cili nuk mbaronte kurrë. Në mësimet teorike, Mustua nuk shkëlqente. Ai ishte pak "dembel" e përtonte të



shfletonte. Por, kur u erdhi radha e fluturimeve, pamë tjetër Mustafa. Siç duket, këtu ai ra në fushën e tij dhe shpërtheu bota e tij, me aftësi të padukura deri atëherë. Sikur ishte i prerë për të fluturuar, ai djalë. Shpejt i shpalosi prirjet dhe aftësitë, "të fshehura" brenda qenies së tij interesante. Ai u rendit në vendin që meritoi; mes më të përparuarve të grupit të studentëve për pilotë të Batajskut. Dikush, mund të mendojë se kemi të bëjmë me një rast të rrallë, në të cilin nuk përkon niveli teorik me aftësitë praktike. Si rregull, ato shkojnë paralel, por ka raste, si ky që po ju paraqesim, kur ato nuk përkojnë. Mundet të jetë ashtu, por, nga sa e njoh unë, shokun tim, ai ishte mjaft i zgjuar e i mprehtë dhe i aftë për të menaxhuar "pasurinë" mendore të tij. E kishte bezdi Mustua të merrej me teorira. Edhe kur ishte në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", siç më rrëfeu një shoku i tij, kur bënin provim në matematikë, kushëriri i tij Fadil Leli, nxënës i "shkëlqyer", përgatiste dy fletë; një në vintë emrin e Mustos. Mësuesi i matematikës, Cinxua, i cili e dinte kapacitetin e Mustos, dhe e kuptonte lojën që luhej, nuk i vinte Mustos notë më të lartë se shtata. Cinxua ishte i saktë e i rreptë por Muston e donte dhe e çmonte shumë edhe për humorin e tij.

Si do ta pëcillnit jetën e tij studendore në ish-BS?

Në Batajsk, Mustua kish shoqëri me të gjithë dhe të gjithë e donim. Më ngushtë ai u lidh me Pandeli Lëngun, me Zydi Meçen etj, pa llogaritur ish-Skënderbegasit. Punët rrodhën mbrapsht e Mustua dhe shokët e tij, nuk e përfunduan shkollën e aviacionit në Bashkimin Sovjetik, por në muajin shtator të vitit 1961, ai dhe shokët e tij, u përzunë, me dhunë, nga ajo shkollë e u kthyen në Atdhe. Mustua dhe 16 të tjerë u diplomuan pilotë, në shkollën e aviacionit, në Vlorë. Në Shkollën e Aviacionit, në Vlorë, ku mësoi përdorimin e aeroplanit reaktiv Mig-15, në aerodromin e Pishëporos, mësimet e fluturimit, Mustua i mori nga i talentuari Azbi Seranaj. Në grupin e instruktorëve pilotë që përgatitën grupin e studentëve të kthyer nga Batajsku bënë pjesë dhe "heroi" i gjallë, piloti nga Maminasi Mahmut Hysa. Në vjeshtën e vitit 1963 dhe në pranverën e vitit 1964, vetë i njëmbëdhjetë, u emëruan pilotë gjuajtës-bombardues, në Regjimentin e Rinasit, ku komandonte, piloti guximtar, kolonel Niko Hoxha.

Në Regjimentin e Rinasit

Në Regjimentin e Rinasit, Mustua dhe shokët e tij u caktuan në Skuadrilen e dytë, ku ishte komandant Kosta Neço Dede, njëri nga pilotët më të zotë të aviacionit shqiptar. Aty, gjatë dy viteve Mustua u stërvit në aeroplanët gjuajtës-bombardues Mig-17 F. Ai u shqua për teknikë pilotimi të spikatur dhe u piketua për t'u avancuar në aeroplanë më të sofistikuar. Viti 1966, ishte vit me fat, për Muston. Ai bëri kalimin, në aerodromin e Rinasit, në aeroplanët supersonikë Mig-19 S ku pati tregues në rritje. E nisi kalimin, fillimisht duke sqaruar veçoritë e avionit të ri, në klasë e, në pranverë të vitit 1966, nisi praktikën fluturuese, pa avion dyvendësh.

Kush ka qenë dita më e vështirë e tij si aviator?

Në kohën kur Mustua punonte për rritjen e aftësive profesionale dhe kur akoma nuk e kish përvojën e nevojshme praktike, për pilotimin e avionit supersonik Mig 19S, në një ditë vjeshte të atij viti, në një fluturim rutinë në zonë, duke u stërvitur, në drejtim të përvetësimit të pilotazhit, në rrafshin vertikal, në rajonin e Zonës së pilotimit me numër 2 të aerodromit të Rinasit, mbi Çermë të Lushnjës, ndodhi ajo që nuk pritej e vështirë të konceptohet. Aeroplani Mig 19 S, në një kompleks vertikal, pa dëshirën e pilotit, ra në një pozicion të panjohur e të padëshiruar, të cilin pilotët e quajnë shtopor. Si rregull, kur aeroplani reaktiv, bie në të tillë pozicion të vështirë, nga i cili, piloti nuk mund ta nxjerrë aeroplanin, makina luftarake, duhet braktisur, duke u hedhur me katapultë. Lartësia në të cilën Mustua, pilotonte -4500m, ishte e pamjaftueshme për ta nxjerrë aeroplanin nga ai pozicion i vështirë, edhe sikur të mendosh se kushtet e tjerë ishin ideale. Prandaj është taksativ katapultimi në raste e në aeroplanë të tillë, si rruga e vetme për të shpëtuar jetën. Mustua, kur pa se aeroplani, të cilin ai pilotonte, nuk u bindej komandave (veprimeve) të tij, i raportoi udhëheqësit të fluturimeve, në aerodrom, se në Zonën 2, në lartësinë 4000 m.aeroplani i tij kishte rënë në shtopor. Një situatë mjaft e rëndë, nga ato që pilotët i quajnë: "Rast i jashtëzakonshëm". Kërkohej ndërhyrje e shpejtë dhe e saktë. Rasti fatkeq kish trokitur,

aeroplani duhej braktisur. Për fat të mirë, në mikrofon ishte i madhi Haki Jupasi; njëri nga talentet e rrallë të aviacionit shqiptar, në fushën e pilotimit, i cili kishte dhe disa tipare të veçanta si drejtues i fluturimeve. Hakiu e çmoi shpejt dhe realisht situatën e krijuar, në ajër, i dha Mustos urdhër të prerë: "Hidhu me katapultë"! Urdhrin, e braktisjes së avionit e pasoi me udhëzimin:"Merr pozën e katapultimit; mblihd këmbët"! Mund të themi, pa mëdyshje se këto fjalë "të arta" të Haki Jupasit, i cili shquhej për qetësi, saktësi, kompetencë profesionale dhe syçeltësi, e shpëtuan Muston, nga katastrofa e sigurt e mbarsur me rrezikun për jetën e tij. Kur u bënë analizat e ngjarjes dhe Mustua dëgjoi incizimin; ai dhe të tjerët, nuk e njohën zërin e transformuar të tij, nën efektin e situatës që u krijua në disa të dhjeta të sekondës. Në një rast të tillë, tejet të rëndë fitoi qendrueshmëria, burrëria, gjakftohtësia dhe saktësia në veprime e Mustos. Ai nuk ra në panik por përcaktoi, me saktësi pozicionin ku kishte rënë; raportoi: shkurte saktë dhe kreu veprimet e vetme që mund të kryheshin në atë situatë-katapultoi. Mustua katapultoi. Për fatin e tij të mirë mekanizmat që hapin parashutën funksionuan normalisht e Mustua takoi me tokën, në arat e punuara rishtas të sektorit të Çermës. Zhveshi parashutën, mënjanoi kokoren dhe u ul mbi një plis e ndezi cigaren. Ai e pinte rëndshëm duhanin. Në këtë rast fatkeq, cigarja i erdhi në ndihmë; si shok e si ngushëllim. Udhëheqësi i fluturimeve në aerodrom, Haki Jupasi, urdhëroi njërin nga pilotët që ndodheshin në ajër, në atë çast, të shkonte mbi Çermë e të vrojtonte. Piloti raportoi : "nuk shikoj asnjë shenjë jete"! Pilotët e helikopterit që shkuan, pas pak , në venin e ngjarjes, pa u ulur në tokë raportuan:" Shikojmë një gjë të bardhë, të hapur(ishte parashuta), një gjë të errët që nuk lëviz(ishte piloti) dhe një gropë nga e cila del tym i zi". Një shpresë jete lindi tek stafi që drejtonte fluturimet. Ndërkohë ia behën njerëzit që punonin aty pranë. Ata ishin stalliere të kompleksit të gjedhëve, aty pranë. Në duar mbanin sfulq, me grepa hekuri, nga ata që u jepnin zaire lopëve. Dy syresh kishin në dorë kova me qumësht. Kujtuan se kishin të bënë me ndonjë pilot të huaj. Kur i pikasi Mustua , u foli, shqip, jo pa humor:" Nuk dua qumësht, jo, por më jepni duhan"! Loparët nxorën nga xhepat cigare, nga paketat e tyre dhe ia drejtuan Mustos, i cili e ndezi cigaren, pareshtur, me zjarrin e njëri-tjetrit, derisa erdhën shokët dhe e morën, me helikopter. Punonjësit prisnin të shikonin ndonjë gjigant, për nga trupi dhe kur panë Muston me trup mesatar, pa kërkuar shpjegime, e përqafuan atë, si vëllanë e tyre. Me një helikopter Mi-4, Muston e morën dhe e çuan, tek shokët, në aerodrom. Ata ishin në ankth, për fatin e shokut të tyre, të dashur. E pritën si hero, me të gjitha nderet që i takonin. Përpara mensës së pilotëve, kur një helikopter e solli Muston dhe ata që shkuan për ta marrë, pilotët që u ndodhën aty, pa u dhënë njeri komandë, formuan dy rreshta , mes të cilëve kaloi Mustua "hero"! E përqafuan dhe e uruan, të gjithë pjesëmarrësit, mes tyre dhe kamerierja, Selime Caushi, e cila na ishte bërë si nënë. Mustafa Gjokutaj kishte kaluar një test të rrallë trimërie; ai kishte braktisur aeroplanin supersonik në një situatë të vështirë shtopori. Pas analizave që u bënë, Mustafa Gjokutaj, edhe pse ishte fort i ri në moshë, për atë që i ndodhi, situatë në të cilën mund të bierë çdo pilot, nuk u lejua të fluturonte më, në aeroplanët reaktivë. Mustua u caktua në Regjimentin e Helikopterëve Mi-4, ku shërbeu me devotshmëri dhe, me aftësi, e arriti në detyrën e lartë të zëvendëskomandantit të Skuadriles.

Çerçiz Topulli dhe çeta flamur lirie

Me rastin e 110 vjetorit të krijimit të çetës së Çerçiz Topullit



Ernest Koliqi (nga fjala e lamtumirës): “E ju, o ju Hije madhore të Çerçiz Topullit e të Mustafa Qullit, nishju kah vendet jueja tue ngjallun nëpër të gjitha buzët një kangë shprese. Zgjoni në kalim zemrat e fjetuna; fuqizoni shpirtrat e ligshtuem. Shka kërkon djalëria prej Shqypnisë? Drejtësi të plotë shoqnore. O ti, Çerçiz, o ti Mustafa Qulli, që ma t’kuq e batë flamurin tonë me gjakun e pastër t’uj, shpall-nja djalëris se përparimi më i drejtë se drejtësia ma e plotë shoqnore mund t’arrihen n’emën të Shqypnisë...”.

Kolonel Prof. Asoc. Dr. ZAHO GOLEMI
Akademia e Forcave të Armatosura

Çeta e Çerçiz Topullit dhe Bajo Topullit këtë vit ka përvjetorin e 110-të të krijimit të saj. Emri i ndritur, pishtar lirie dhe bëmat e Çetës së Çerçiz Topullit janë të njohura në luftë kundër pushtuesve osmanë dhe andartëve grekë në fillim të shek.XX. Çerçiz Topulli është një emër i mirënjohur i historisë sonë kombëtare, veprimtar i spikatur i Rilindjes Kombëtare shqiptare. Çerçiz Topulli me të vëllanë një shekull e një dekadë më parë themeluan çetën e tyre në jug të vendit, që u bë krenari dhe flamur lirie i shqiptarizms. Çeta e Topullarëve e kishte kaluar dimrin e 1906-s në Sofje të Bullgarisë dhe në Bukuresht, ishte bashkuar me çetën edhe Mihal Gramenoja, një emigrant që jetonte që prej dy dekadash në Rumani. Pas shumë peripecish, çeta me një grusht burrash kishte mbërritur në Brindizi, në prill 1907. Ata u vinin rreth anijeve të vjetra e të vogla me vela, në pritje që të qetësohej deti që të zbarkonin në Shqipëri, për të ndezur flakën e kryengritjes popullore. Çerçizi priste të niste udhëtimin historik për të ndezur zjarrin e kryengritjes; Bajo Topulli, kishte marrë udhën drejt Parisit e më tej në Amerikë si një ndër veprimtarët e komitetit të fshehtë për “Lirinë e Shqipërisë”, i cili ishte krijuar në Manastir. Kapiteni ulqinakas Ahmet Shqiptari (mbiemrin ja vendosi Çerçizi), më 16 maj 1907 e solli çetën e Çerçizit në afërsi të Dhërmiut, ku streha ishte e sigurt në malet e Jugut, në Bregdet, në Piluir e Kuç, në Golem, Fushëbardhë, Kardhiq, në Mashkullorë, në Lunx-

hëri, Gjirokastër e Zagori, në Libohovë, Tepelenë, Përmet, Ersekë e Korçë e deri në Prespë e Devoll. Çeta ishte dhe mbeti një epike trimërie për Shqipërinë. Çeta në një kohë të shkurtër krijoi dhjetra çeta të tjera, kreu aksione të armatosura si dhe luftoi trimërisht në Gjirokastër në Mashkullorë dhe në mjaft beteja me andartët grekë ku e kërkonte çështja e madhe e lirisë dhe indipendencës kombëtare. Në vjeshtën e vitit 1906, Çerçizi dhe Bajo Topulli shkojnë në Gjirokastër, për të organizuar aty në fshehtësi, çetat e jugut. Por bëmat e tyre kanë alarmuar Stambollin dhe katër vëllazërit Basriun, Dautin, Banushin dhe Halilin nuk i gjejnë në shtëpi. Mytezarifi i qytetit, lidhur me pranga i kishte dërguar në burgun famqer të Janinës. Arrestimet nuk i trembin dy vëllazërit. Gjakra ndizen edhe në keq nga këto veprime barbare të pushtuesave. Ata nisen sërish në fshehtësi për në Manastir. Gjatë udhëtimit çeta e Çerçiz Topullit bie disa herë në prita me ushtaraët osmanë duke luftuar trimërisht kundër tyre. Osmanët i ndjekin trimat këmba-këmbës, edhe në trevat e Manastirit, Strugës e Resnjës, Tetovës e Shkupit dhe falë komiteteve të këtyre trevave, Çerçiz Topulli mbëriti në Sofje, ku pritet shqiptarisht. Ai dhe patriotë të tjerë janë të bindur në idealet e kombëtare, të betuar se do të ecnin në rrugën e ndriçuar për liri e bashkim kombëtar, nga jugu në veri, nga lindja në perëndim, për një komb dhe një shtet. Çeta e Çerçiz Topullit përmes Bajram Ligut dhe Hito Labit shtrinë bimbashin osman në kalldrëmet e Gjirokastrës duke tundur fort themelet e pushtimit osman katër vjet para shpalljes së pavarësisë. Në fakt bimbashi kishte kryer disa arrestime, kishte marrë masa të forta shtrënguese ndaj popullsisë në prefekturën e Gjirokastrës dhe për këtë Komiteti i Gjirokastrës dhe Komiteti, "Për Lirinë e Shqipërisë" e dënoi me vdekje binbashin (majorin). Në masat e fundit, Çerçizi, u takua me vëllain e madh, Kapo Topullin, i cili ju përgjigj: "Në se vrisni ju të çetës, do ta vras unë". Çeta kish tentuar dy herë me Hajredin Tremishti dhe komitin Asllan, por pa rezultat, sepse binbashi ruhej mire. Herën e tretë, në dorë e morën leberit, Hito Lekdushi, (ose Hito Kërma) dhe Barjam Ligu (Prongjia). Dy luftëtarët u përgatitën bën qitje në baltën e kuqe të Dunavatit, ku provonin pistoletat, u përgatitën për vrasjen dhe, u veshën si tregtar. Pas dy ditësh të qëndrimit në qytet, ditën e hënë më 9 mars 1908, që ishte dhe ditë pazari, në mëngjes herët dy atentatorët, të veshur si tregtarë, hynë në qytet dhe kishin qëndruar përballë shtëpisë së binbashit në Lagjen Hazmurat (në rrugën që të shpie në Qafën e Pazarit). Komitet e tjerë kishin zënë pozicione rreth e rrotull që të mbulonin ikjen e dy guximtarëve. Në 11.15 binbashi dhe xhandar Lamçja gjirokastrit që e shoqëronte dolën në rrugën e kalldrëmtë. Leberit me gjakftohtësi me koburet në dorë u dolën përpara dhe qëlluan mbi binbashin dhe (bodigardin gjirokastrit) që tentoi të mbronte bimbashin. Bimbashi mbeti i vrarë ndërsa, bodigardin Lamçe gjirokastritin, Hito Labi e qëllloi në dorë, për të mos vrarë një shqiptar, dhe për ta nxjerrë jashtë mundësie për të reaguar. Çeta që kishte zënë pozicione rreth qytetit dhe në bregun e Teqesë së Baba Manes (Teqeja e Shtufit, aktualisht mbi Universitetin "Eqerem Çabej"), i ndihmoi luftëtarët të dilnin nga qyteti dhe zmbropsi askerët, që ju vunë mbrapa atentatorëve. Çeta e Çerçizit qëllonte mbi godinën e xhandarmërisë tërheqja e çetës u bë drejt Mashkullorës dhe më tej në Kardhiq. Në Kardhiq, Çerçizi kishte dajallarët sepse nëna e tij Hasua ishte bija e trimit Laze Mullai.

Këtu çeta me 11 vetë u nda në dy çeta. Çerçizi në drejtim të Mashkullorës si dhe Abdyl Mersini vetë i katërt në tjetër drejtim. Çerçiz Topulli, vetë i shtatë, qëndroi në Mashkullorë tek Mirtja që ishte babai i Zeman Mashkullorës. Këtu do të shkruhej edhe epikeja e nderimit të armëve të Shqipërisë. Në përvjetorin e Luftës së Mashkullorës, 82 vjet më parë, më 18 mars 1934, në Gjirokastër u përurua monumenti i kryetrimt shqiptar, Çerçiz Topullit, vepër e skulptorit të shquar Odise Paskali me kontributin financiar të shqiptarëve brenda, por edhe jashtë vendit. Shqiptarë e të huaj që shkelën në truallin shqiptar njohën veprën e patriotit dhe luftëtarit të madh gjirokastrit dhe ngeli në memorie të kombit. Por për një çerek shekullin e fundit, që nga viti 1990 kjo figurë kombëtare pushtetarët dhe politikanët harruan atdhetarin gjirokastritë. Nga Shkodra eshtrat e Çerçiz Topullit prehen aktualisht në varrezat e Rilindësve; ndërsa vëmëndja e fundit shtetërore i përket vitit të 100 vjetorit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit, më 1978-tën, vit në të cilin luftëtarit, shkrimtarit, atdhetarit dhe veprimtarit të spikatur të Rilindjes, udhëheqësit të luftës së armatosur të çetave kundër sunduesve osmanë e grekë për çlirimin e lirinë e vendit, Çerçiz Topullit ju akordua dekorata e lartë "Hero i Popullit", pas vdekjes. Çeta e Çerçiz Topullit u bë prijëse e çetave popullore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në jug të vendit, Çeta e Çerçizit zgjoi interesimin mbarëpopullore në qarqet e rrethet patriotike, që prinin një shkëndi për të filluar zgjimin e madh e të gjerë. Ndër figurat kryesore shqiptare, që la gjurmë të thella në histori dhe vazhdon të jetë në fokus të studiuesve, është Çerçiz Topulli. Karakteri luftarak dhe personaliteti atdhetar i Çerçiz Topullit zgjoi prushin e atdhetarisë. Çerçiz Topulli, në historinë e popullit shqiptar është padyshim ndër figurat më të spikatura dhe të vlerësuara për shpirtin e flaktë atdhetar, protagonizmin e shquar dhe të veçantë në rrugën e gjatë për formësimin, çlirimin, pavarësinë kombëtare dhe krijimin e shtetit shqiptar. Ai përshfaqti në të gjithë veprimtarinë e tij të gjatë dhe të pasur luftarake edhe një dimension tjetër të veçantë, të njohur por, gjithsesi, pak të rrahur dhe analizuar, në të cilin spikatin cilësitë e rralla si një strateg lufte për liri, komandant dhe prijës i suksesshëm, ndonëse nuk ishte një ushtarak i karrierës. Ky dimension përfshin cilësitë e tij të rralla prej prijësi ushtarak të lindur e popullor. Çerçiz Topulli ishte lavdia dhe nderi i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai ishte dëshmitari i shqiptarizmit e gdhendur në historinë e këtij kombi. Institucionet historiografike kanë heshtur gjatë, gati një shekull mbi personalitet me përmasa epokale për Shqipërinë, sikurse ishte pushka e ngrehur për Shqipërinë që sillte flakë kryengritjeje kundër pushtuesve shekullor osmanë, por edhe andartëve grekë. Dëshmitë historike nuk rreshtin, mbi kontributin e oxhakut "Topulli" në Gjirokastër, si derë e parë nëpër shekuj, që ka respektuar traditat me fisnike të racës arbërore. Babai i Çerçizit e Bajos ishte Ago Topulli, një burrë i mençur e trim, bashkëpunuar me Abdyl Frashërin, miku i ngushtë me Koto Hoxhin, pishtar të çeljes së shkollave shqipe në gjithë jugun e Shqipërisë, me plot 18 fëmijë, nga të cilët 16 djem pasurinë dhe jetën e tij dhe të bijëve të tij e vuri në dispozicion të tokës arbërore dhe të lirisë së Shqipërisë. Prandaj emri i Çerçiz Topullit u gdhënd në histori përjetësisht për tu nderuar si dëshmor i shekujve në gjithë përvjetorët historikë të kombit shqiptar. Heronjtë dhe dëshmorët e kombit shq-

iptar i ka bashkuar ideali kombëtar dhe trualli amtar shqiptar. Viti 1915 do të shuante dy korifenjtë e shqiptarizms, Çerçiz Topulli dhe Muço Qulli, që ngelën përjetësisht në panteonin e kombit shqiptar.

Çerçiz Topulli udhëheqës i shquar i çetave

Çerçiz Topulli lindi në qytetin e gurtë të Gjirokastrës më 20 shtator 1880. Shkollën fillore e bëri në Janinë ku mbaroi tri klasë të gjimnazit. Ishte mjaft i gjallë, i shkathët, i guximshëm dhe më i përkëdheluri i gjithë fëmijëve të Ago Topullit. Ka udhëtuar shumë që i vogël tek të afërmit e vëllezërit në Turqi, Bejrut, Bagdat, Nikozia. Vëllai i madh Kapua do ta merrte në Selanik dhe Janinë. Me Bajon shkonte shpesh në Stamboll, Selanik etj. Në moshën 16 vjeçare ishte djali i gjatë, i shkathët, truplidhur, kishte një precision e sy të mprehtë si qitës si dhe lëvizte shpesh mbi një kalë "kara". Ishte valltar elegant dhe këngëtar pasionant i këngës labe. Çerçizi revoltuhej që osmanët nuk ja njihnin shqiptarëve as kombësinë, as gjuhën, as shkollën dhe as kulturën shqiptare. E ëma e Çerçizit, Hasua nga Kardhiqi i fisnikërisë sipas zakonit e martoi djalin që në moshën 24 vjeçare në vitin 1904 me Qanon, që ngeli bashkëshorte e denjë edhe kur u vra Çerçizi pas 11 vjet martesë. Por sikurse thotë Mihal Grameno: "Çerçizi u "martua" me pushkën dhe nagantën dhe me lëvizjen kombëtare". Ai ishte veprimtar i shquar i Rilindjes, shkrimtar dhe atdhetar i njohur, një udhëheqës i luftës së armatosur të çetave kundër osmanëve dhe kundër andartëve për çlirimin e vendit. Çerçiz Topulli ishte një djalosh energjik 27 vjeçar kur në prill të vitit 1907 krijoi dhe komandoi çetën e armatosur që vepronte në Shqipërinë e Jugut, sidomos në krahinat e Gjirokastrës dhe Korçës. Me vendim të Komitetit të Gjirokastrës, anëtarë të çetës së Çerçizit vranë më 9 mars 1908 në Gjirokastrë komandantin turk të xhandarmërisë së qytetit binbashin osman Halil Musa Beu. Çerçiz Topulli njihet në të katër vilajetet shqiptare për herë të parë si prijës në Luftën e Mashkullorës më 18 mars 1908. Në thirrjen "Nga malet e Shqipërisë" drejtuar bashkatdhetarëve të tij dhe botuar në janar 1907 në gazetën "Shpresa e Shqipërisë" Çerçiz Topulli pasi dënonte grabitjet e administratës osmane kërkonte që, "Shqipëria të shpëtohet nga perandoria osmane dhe të bëhet e lirë dhe e pavarur... e vetmja rrugë për çlirimin e Shqipërisë ishte ajo e kryengritjes së përgjithshme të armatosur, ku gjithë shqiptarët të ngriheshin me armë në dorë në luftën për lirinë e Shqipërisë". Ambjenti familjar në të cilin u rrit Çerçiz Topulli e sidomos vëllai më i madh Bajo Topulli, ndikuan në formimin e tij si atdhetar i vendosur dhe i palëkundur në principet e tij. Ai u bë pjesë e veprimtarisë së Komitetit të Fshehtë "Për lirinë e Shqipërisë" në Gjirokastrë. Breza të tërë shq-



iptarësh e panë Çerçiz Topullin ashtu sikurse ishte në të vërtetë, si bij dhe at i shqiptarizms, me pushkë e penë për mëmëdhenë, shtetar me kontribute dhe përmasa mbarëkombëtare. Kur filloi revolucionin xhonturk (turqit e rinj) më 1908, Çerçiz Topulli u aktivizua energjikisht për formimin e klubeve shqiptare dhe për çeljen e shkollave shqipe në viset e ndryshme të vendit sidomos në jug të vendit. Në shoqëritë dhe klubet patriotike mbrojti interesat e kombit shqiptar. Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912 u vu në shërbim të qeverisë së përkohshme të Ismail Qemali Vlorës dhe luftoi për mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut, në disa kryengritje të armatosura, për sprapsjen e andartëve grekë nga tokat e pushtuara në jug (pas konferencës së ambasadorëve në Londër, por edhe kundër rebelimit të Haxhi Qamilit në Shqipërinë e Mesme. Në fakt edhe pse nuk dihet saktë pjesëmarrja e Çerçizit, Bajo, Shahin Kolonjës, Ibrahim Temos, Dervish Himës, Kristo Iuarasit... etj. Ka edhe një mendim se Plakun e Vlorës me apo padashje kishte edhe "honxhobonxho" dhe të tjerë. Por

fakt është se plaku i bardhë i flamurit e priti me gëzim e nderime luftëtarin e parë të çetës së parë të lirisë, Çerçiz Topullin dhe e ngarkoi me detyrë në Komandë të Forcave Vullnetare të Jugut të Shqipërisë së porsakrijuar. Në shtator të vitit 1914 Çerçiz Topulli e Muço Qulli gjendet në Shkodër, që kishin shkuar për t'ju bashkuar mbrojtjes së trojeve shqiptare nga pushtimi serb e malazez. Por rrethanat në terren bëjnë që më 28 qershor 1915 të arrestohet për herë të parë, por të lirohen shumë shpejt. Pas ju kishin venë zbuluesat të specializuar të veshur civilë të cilët arritën që më 7 korrik

1915 në Fushën e Shtoit në Shkodër një togë malazeze rrugës për në Çetinë të bëjnë arrestimin e patriotëve shqiptarë. Kërkimet historiografike kanë mundur të zbulojnë bashkëbisedimin e Çerçiz Topullit e Muço Qullit. Të kapur pabesisht, Çerçiz Topulli dhe Muço Qulli u vunë para togës së pushkatimit të gjeneralit malazez Veshoviç, në fushën e Shtoit në Shkodër. Para se breshëria e armëve t'i rrëzonte të dy lisat e shqiptarisë, në të njëjtin varr, oficeri malazez i tha Çerçiz Topullit: "A e shikon se ku po e lini kokën? Në dhe të huaj, në vend që të rrini rehat aty, në vendin tuaj". Dhe Çerçizi Topulli aty për aty i'a priti: "Ne nuk kemi luftuar për shtëpinë tonë, por për vendin tonë dhe vendi jonë është gjithkund ku flitet gjuha shqipe e jetojnë shqiptarë në trojet e veta. Kjo është tokë shqiptare!". Për dy dekada eshtrat e dy heronjve mbetën anonimë, pa u njohur varri i trimave shqiptarë, në fshatin Shtoj të Shkodrës, deri sa u zbuluan në vitin 1936 nga Javer Hrushidi, i cili ishte mik fëmënie me Çerçiz Topullin dhe prefekt i Shkodrës aso kohe. Ishte pikërisht ai që identifikoi dhe eshtrat e Çerçizit nga një dhemb floriri, që e kishin të dy të njëjtë. Në zhvarrimin e eshtarve të tyre mori pjesë rinia shkodrane dhe rinia më e përparuar gjirokastrite, ku u mbajt edhe një fjalë

lamtumire në emër të rinisë gjirokastrite. Në fjalimin e lamtumirës të Pater Anton Arapi flet me zërin e mbarë kombit shqiptar: "Ndaluni! Ku veni burra?! Çerçiz e Muço, dy fjalë ka me ju Shkodra kreshnike, ktu në log të kuvendit para se të daheni. Do ta leni Shkodrën, të shkoni e të pushoni atje, ku së parit pat t'ambulat rreze të diellit, ku, si filiza të shndoshtë, gëzueshëm e rritët shtatin, atje prej kah Shqypnija u qiti dhe u ndriti! ...Veç, o burra, qi, dekun, flitni, të metun, njallen, të hupun, sod ndritni, kah rreth e rrokull t'i bini Shqypnis, deh, lshonie një za, at zanin t'uej kumbues si të luajve, diftoni djelmnis shqiptare shka u ushqeu idealin, shka u mbajti karakterin, shka u bani të pavdekshëm. ..T'i diftojmë, po, botës, se shqyphtarët janë njëmend burra; se mund të jemi Toskë e Gegë, muhamedan e kristjan, e njëherit shqyphtarë të njëmendtë. Zoti i vërtetë e atdheu le të na bashkoj, Zoti e atdheu të na mbajn, me Zot e me Atdhe të lumnojmë!" Çerçiz Topulli përfaqëson një nga "gurët më të rëndë" e të famshëm të kombit shqiptar që bashkë me çetën e tij u shndërrua në legjendë pas rezistencës me askerët osmanë në Mashkullorë dhe në dhjetra beteja të tjera antiosmane dhe antiandarte. Çerçiz Topulli në vitin 1914, si shumë politikanë të tjerë shqiptarë shkoi në Shkodër, ku bashkëpunoi me Muço Qullin në botimin e gazetës "Populli", por u vra pabesisht në Fushën e Shtojit, në Shkodër, nga trupat malazeze, më 15 korrik 1915, kur ishte vetëm 35 vjeç. Për Çerçiz Topullin dhe çetën që ai krijoi dhe që u bë e njohur në katër vilajetet shqiptare, është shkruar pak. Ai u rrit në një familje me 18 fëmijë, që kishin ardhur nga katër martesat e babait të tij Ago Topullit, një patriot i njohur në Gjirokastrë. Mes 16 vëllezërve shkëlqyen Bajo dhe Çerçiz Topullit. Vëllezërit dhe motrat e tyre, sipas "Topullarët e Gjirokastrës" ishin: Qamile, Isak, Jaçe, Lutfi, Mustafa, Kaman, Muho, Kapo, Bako, Sulejman, Bajo, Banush, Çerçiz, Namik, Jonuz, Halit, Nasuf dhe Akile Topulli, patriotë që ja ngritën më tej lavdinë fisit fisnik të Topullarëve gjirokastritë.

Bajo Topulli - "Garibaldi" shqiptar

Bajo Topulli është ringritur si nipi i Topullarëve, duke marrë emrin dhe shkroi monografinë më të kompletuar të fisit fisnik e të mençur të shquar për trimëri. Çerçizi dhe Bajua ishin intelektualë, që luftuan jo vetëm për mëvetësinë e Shqipërisë, por edhe për gjuhën shqipe. Nipi i Bajo dhe Çerçiz Topullit duke qenë edhe ushtarak hedh dritë mbi figurat e heronjve. Ata ishin jo thjesht komitë, por intelektualë e reformatorë të zotë. Monografia për Topullarët "Topullarët e Gjirokastrës: Bajo dhe Çerçizi", është e mbushur me material arkivor, me dëshmitë nga shtypi i kohës, ku bëmat e dy heronjve gjetën hapësira të mëdha; me fjalime e dorëshkrime të vetë heronjve, nga ato të pakta që i rezistuan kohës, me dëshmi mbi vrasjen e Dhespotit të Korçës, dhe të Bimbashit në Gjirokastrë, përplasjet e ashpra me pushtuesin Osman e grek, dialogu me Faik Konicën, arrestimet dhe pushkatimi i Çerçizit e deri tek ceremonitë e lamtumirës. Faktet historike flasin se Çerçiz dhe Bajo Topulli, nuk janë thjesht komitë që rrëmbyen armët e dolën maleve, por ata ishin edhe diplomatë, që trokitën në kryeqytetet evropiane e Amerikë, për të gjetur mbështetjen ndërkombëtare dhe për të organizuar shqiptarët, drejt çështjes madhore të pavarësisë. Është fakt se Bajoja e Çerçizi, paraardhësit i kanë nga i Vasil Sulioti e brez pas brezi, mbiemri i tyre

u shndrua në "Karagjozi" e më tej Topi- Topulli (për shkak të një beteje të ashpër që Mehmet Karagjozi bëri me Ali Pashë Tepelenën). E më pas tregohet mbi një dokumentacion të dendur jeta e Bajo dhe Çerçizit, dy nga 15 djemtë e Ago Topullit. Në vitin 1883, kur Bajo Topulli ishte vetëm 11 vjeç nisët për të studiuar në Stamboll, ku brumoset me idetë përparimtare dhe patriotike të vëllezërve Frashëri, Samiut, Naimit, Jani Vretos. Më vonë vendoset në Selanik, ku fillon aktivitetin e gjerë si propagandues i gjuhës shqipe, duke e vendosur veten në shënjestrën osmane dhe greke. Në moshën 32 vjeçare Bajon e gjejmë në Manastir, si profesor dhe zvendës-drejtor i gjimnazit të Manastirit. Gjatë punës në Manastir, filloi të mësonte gjimnazistëve shqiptarë shqipen dhe u solli libra shqip, u ngrit "Komitetit për Lirinë e Shqipërisë"(1905), nga shumë patriotë shqiptarë. Në nenin e parë të Kanonizms shkruhej qëllimi i komitetit: "...të ngjallurit e Shqipërisë, duke mbjellë vëllazërimin, dashurinë, bashkimin, duke përhapur udhën e qytetërimit me anën e librave që do të shtypen, duke dërguar njerëz në të gjithë anët e Shqipërisë të mbjellin këto mendime... për mbrothësinë kombit dhe të shpëtuarin nga zgjedha dhe errësira në të cilën gjendet sot". Bajo Topulli, ishte vullnetari i parë i çetës së parë çlirimtare, që është quajtur "Garibaldi i Shqipërisë". Aktiviteti në Jug të Shqipërisë dhe vrasja e Dhespotit të Korçës, për të larë gjakun e Papa Kristo Negovanit, e detyroi Bajo Topullin që në fund të nëntorit 1905, i shoqëruar nga Çerçizi dhe Zeman Hasko Mashkullora të udhëtojnë drejt Sofjes, ku e priti një grup shqiptarësh me në krye Shahin Kolonjën. Edhe atje situatë ishte e ndezur e patriotike. Në Sofje e Bukuresht u njohën me kronikanin e luftërave për liri Mihal Gramenon. Bajo Topulli merrej me propagandë jashtë vendit, çeta e drejtuar nga Çerçiz Topulli, kishte nisur veprimtarinë që do ta bënte të njohur në rrafshin mbarëkombëtar. Një ngjarje madhore ishte mbledhja e Kongresit të Manastirit, ku merrte pjesë dhe Bajo Topulli, madje ai u zgjodh në komisionin e ngushtë të Alfabetit, prej 11 vetësh, ku ndër të tjerë bënë pjesë edhe Fishta, Mjeda, Mit'hat Frashëri, Sotir Peci, etj. Bajo Topulli ishte përkrahës i variantit të alfabetit me gërma latine, i cili u pranua si një nga dy variantet, bashkë me alfabetin e Stambollit, që të përdorehin mes shqiptarëve. Është një enigmë e madhe mungesa e Bajos dhe Çerçizit në ngjarjen e madhe të shpalljes së Pavarësisë, një moment për të cilin ata kishin luftuar për vite të tëra. Ndërkohë që të dhënat historike janë të mangëta dhe nuk hedhin dritë mbi këtë fakt. Emri i Çerçiz Topullit do të ndeshet sërish pa shpalljes së Pavarësisë, në disa kryengritje të armatosura, për sprapsjen e andartëve grekë në Kuven-din e Shtëpëzit, kundër rebelimit të Haxhi Qamilit. Bajo Topulli pas shpalljes së Pavarësisë kthehet në Turqi, ku pati poste të larta drejtuese si vali e prefekt në kohën e Mustafa Qemal Atatürkut. Në moshën 53 vjeçare, në vitin 1925 ai kthehet në Gjirokastrë, ku bashkëqytetarët e shënuan kandidaturën e tij si kryetar bashkie, edhe pse Bajo, ishte i sëmurë nuk e dëshironte një gjë të tillë. Bajo Topulli zgjidhet kryetar Bashkie, të cilën e drejtoi për tri vjet. Gjatë kohës së drejtimit ndërmori një sërë reformash, me pritjen e popullit, pastërtia e qytetit, tregjeve, kontrolli ushqimor, ndriçimi, marrja nën kontroll e rendit publik, përkrahja e familjeve të varfëra, caktimi i ndihmave sociale, ngritja e shkollave, regjistrimi i të gjitha fëmijëve, heqja e feresheve tek gratë, shpallja zyrtarisht e së dielës ditë pushimi, etj.

Bajo Topulli u shua më 24 korrik 1930, në shtëpinë e të vëllait në Sarandë dhe ju dha lamtumira me ceremoni madhështore e dinjitoze nga sarandiotët dhe gjirokastritët. Fjalët e lamtumirës Eqerem Çabej për djalinë shqiptare ishin huazuar nga Leonardo da Vinçi: "Sikur njeriu gëzon muzgun e mbrëmjes pas një dite me punë plot, ashtu dhe vdekja është lumturi në fundin e jetës pas një jete të përdorur mirë", ashtu edhe ti o shpirt bujar, derdhe tërë gazin e jetës për këtë Shqipëri dhe tani, hero re dhe do flesh në këtë tokë që t'i e deshe gjithë jetën më tepër sesa shpirtin".

Krisma te "Gurit të Capit", lajmëtare e shekullit të ri shqiptar

Korçari Mihal Grameno ishte shkrimtar i lëvizjen kombëtare, 28 vjeç sekretari i shoqërisë patriotike shqiptare "Drita", drejtues gazetash në Korçë, emigrant në Amerikë në vitet 1915-1919; njëri nga përfaqësuesit e shqiptarëve të Amerikës në Konferencën e Paqes në Versajë-Paris, me një krijimtari letrare me frymë patriotike, por mbi të gjitha luftëtar i çetës së Çerçizit që i përcolli shekullit shqiptar heroiken për liri. Çeta "Çerçiz Topulli" u bë pishtari i Lirisë Kombëtare, u bë "Shpresa e Shqypnisë". Në janar 1907, në Raguzë (Dubrovnik) tek "Shpresa e Shqypnisë", Çerçiz Topulli shkruan: "Me anën e kësaj letre dua të lajmëroj të gjithë vëllezërit patriotë, shqiptarë, miqtë tanë, si dhe gjithë të tjerët që interesohen për Çështjen e Shqipërisë, se unë me gjithë shokët e mij (duke lënë shtëpijat, familjet e gjithë pasurinë), kemi dalë ndër male si kryengritës, kundër qeverisë barbare tiranike, për Lirinë e Shqipërisë...qeveria kërkon e i merr me pahir pagesat e ndryshme të rënda, jo vetëm, por edhe duke na grabitur, plaçkitur sa s'durohet dot më... Liria ishte sharti/kushti dhe ilaçi për tu ringjallur Shqipëria...". Patriotët e katër vilajeteve shqiptare, që synonin lirinë përmes Komitetit "Për Lirinë e Shqipërisë" (1905), me qendër në Manastir vendosëni themelimin e çetave sikurse ishte edhe çeta e parë kombëtare u ngrit nën udhëheqjen Çerçizit në shtator të vitit 1906 dhe po atë muaj u promovua me aksionin e "Gurit të Capit", më 9 shtator 1906, me asgjësimin të dhespot Fotit të qytetit të Korçës, që në fakt ishte një mësim për të gjithë ithtarët e shovinizmit antishqiptar. Fakt ishte se dhespoti i Korçës ishte kthyer në helm dhe thikë në kurriz të shqiptarëve, ai që kishte eliminuar Papa Kristo Negovanin (Humelica), këtë dëshmor të shkronjave shqipe. Besën në fakt Bajua dhe Çerçizi duke kaluar nga Gjirokastra në Korçë me luftëtarë të tjerë, ishin ndalur në Humelicë të Gjirokastrës në familjen e Papa Kristo Negovanit ku u kishin dhënë besën familjarëve se çeta e tyre do të merrte hakën e patriotëve të vrarë. Prandaj me këtë rast çeta e Çerçizit nuk merrte vetëm hakun, por çeta ndezte realisht fshat më fshat flakën e shqiptarizmes.

Epopeja e luftës së Mashkullorës-imazhi kombit shqiptar për liri

Çeta e Çerçiz Topullit me 11 vetë pas asgjësimin të Majorit të xhandarmërisë u strehua në "zonën luftarake" të Labërisë, që në fakt ishte në çdo vatër e zjarr të ndezur të lebërve. Çeta u çopëzua për tu bërë më e manovrueshme. Çerçizi kishte me vete: Mihalin, Hajredinin, Asllaninin, Zemanin, Hiton, Myftarin dhe

ditën e martë më 17 mars luftëtarët shkuan në shtëpinë e Myrto Haskës, i cili ishte babai i Zeman Haskës, siç njihet ndryshe Zeman Mashkullora. 18 marsi 1908, ishte ditë e martë duke u gdhirë e mërkurë. Pa u zbardhur mirë dita kur Çerçizi u ngrit i pari, pa nga dritarja si në mjegull një turmë njerëzish që po i afroheshin shtëpisë. Fillimisht i pandehu nxënës. Pasi vuri dylbinë dhe pa se ishin askerë osmanë dhe lëshoi kushtrimin, që është kthyer në legjendë: "O burrani, o shokë, se na rrethoi ushtria!". Trupa të shumta turke të garnizonit të Gjirokastrës dhe ato që erdhën nga Janina, u vunë në ndjekje të çetës. Luftëtarët rrëmbimthi morën ç'mundën dhe u drejtuan poshtë përroit. Por, spiuni Veip, të cilin Çerçizi e asgjësoi gjatë luftimit, i drejtoi askerët osmanë në drejtim të rrapit, në qendër të Mashkullorës (rrapi shekullor ka rënë në 2012 dhe mashkulloritët kanë mbjellë në vend të tij një të ri, po në vitin 2012). Edhe pse askerët hapen zjarr të befasishtëm, Çerçizi dhe Asllani zunë më shpejt se ushtarët haurin e Abaz Çanos dhe hapën zjarr mbi ta. Zemani, Myftari, Hajredini e Mihal, erdhën njëri pas tjetrit në drejtim të haurit. Gjatë rrugës nëpër lëndinën që të çonte tek hauri, u vra luftëtar i 18 vjeçar i çetës, përmetari Hajredin Tremishti. Mihal Grameno, i cili ishte më pranë tij, nuk mundi të merrte trupin e pa jetë të Hajredinit. I pikëlluar jashtë mase Mihal u dha shokëve lajmin e vrasjes së Hajredin Tremishtit. Marrja e hakut ishte flakë për flakë. "Tre askerë njëri pas tjetrit, thotë Mihal, qëlloi Çerçizi, e të tjerë të plagosur që u dëgjoheshin ulërimat, sa i detyroi të tërhiqen... Braktisja e shtëpisë dhe lëvizja përmes përroit sin dhe dalja tek hauri i braktisur i ndihmoi përkohësisht luftëtarët e çetës së Çerçizit; ndërsa Hito Lekdushi, duke parë strehën gërmadhë në pamundësi pozicionimi munda të largohej dhe çeta e rrethuar tek hauri mbeti me pesë vetë, përballë rreth 150-200 askerëve osmanë (sipas M. Gramenos). Hito Lekdushi ishte luftëtar që nuk mundi të futej në "kështjellën-haur", një grup askerësh arritën ti prisnin udhën dhe përgatiteshin ta kapnin. Por, labi kurveleshas nuk e humbi kontrollin. Ai çau trimërisht përmes shkrepave të Levenishtës, u përlesh me armë e trup me trup me askerët, pas 3-4 orësh luftim çau rrethimin dhe u ngjiti në malin e Gjerë. Rapsodi lab vargëzoi popullorçe: "Ndriçoi hëna ngjyrë prushi/Se shkonte Hito



Cercizi afer Bajos ne Kongresit e Manastirit si një nga personat e ngarkuar me sigurinë e kongresit

Lekdushi'/Për Hito Habibin thonë/Kërkonte haka të zonë.. "Hito Xhelil Habili (Lekdushi), i njohur në historinë kombëtare si Hito Lekdushi ishte shok armësh me Çerçiz Topullin e Mihal Gramenon, ku më 9 mars 1908, me Bajram Ligun nga Prongjia, shkroi historinë e atentatit të shekullit kundër komandant i xhandarmeisë në Gjirokastër, që terrotrizonte një popull të tërë. Kapedani dhe prijësi Çerçiz Topulli, pas humbjes së Hajredinit ju drejtua shokëve: "Të rrojë Shqipëria se edhe neve si Hajredini do të vritemi, por, o burrani, shok, të zëmë vendet e të luftojmë burrërisht dhe mos u trëmbni". Çerçizi, Zemani dhe Myftari zunë qendrën e haurit, mbrapa Mihal Grameno dhe Asllan Starja. Lufta filloi në mënjëse dhe përfundoi në mbrëmje ishte një luftë për jetë a vdekje, ku çeta e shtatë trimave, me kapedan Çerçizin në krye përballoi një tabor me osmanë, për një ditë rresht në një betejë krejtësisht të pabarabartë. Raporti i forcave ishte, tmerrues për çdo lloj kapedani e prijësi. Por historia shqiptare ka njohur edhe kapedanë të tillë si Çerçiz Topulli. Në librin e Mihal Gramenos "Kryengritja shqiptare", një prej dëshmitarëve okularë të kësaj epopeje të lavdishme kombëtare shkruan: "Çerçizi u tregua një dragua në këtë luftë. Ai replikonte me ushtarët. Jemi bijtë e Skënderbeut dhe nuk jepemi, por do të luftojmë gjër në orën e fundit. Shqiptari di të vdes sipas zakonit e nderit. Vetëm dhe vetëm atëherë munda të besoj historinë e kombit tonë. Atëherë munda të njoh burrin dhe trimërinë e stërgjyshërve tanë, të kuptoj e të çmoj vleftën e këtij djali trim se megjithëqë u rrit i përkëdhelur, nuk i trembej vdekjes. Zbathur, kolos, me leshra përpjetë, vërtitesh nga të gjitha anët si një komandant i madh, me pushkën në dorë e gjashtaren në dhëmbë, duke burrëruar neve, duke qëlluar mbi ushtarët. Fytyra e tij këtë ditë ishte më e çelur se kurdoherë". Kronikani i betejave dhe shërbëtor i paepur i historisë kombëtare shqiptare Mihal Gramenoja e kujton Çerçiz Topullin në betejën e haurit në Mashkullorë: "Zbathur, kokëjashtë, me leshrat përpjetë vërtiteshe në të gjitha anët si një komandant i madh, me pushkën në dorë dhe gjashtoren në dhëmbë duke na mburrur neve dhe duke qëlluar mbi ushtarët. Fytyra e tij, këtë ditë, ishte më e qeshur se kurdoherë, edhe jo sikur luftonte, por sikur kërcente", (Mihal Grameno, Vepra, Vëllimi II, Rilindja, Prishtinë, 1979). Rreth mbrëmjes, në vendin e luftimit erdhën trupa të reja, por edhe sulmi i tyre u zmbraps nga zjarri i kalibruar i luftëtarëve të Çerçizit. Trupat osmane dhe komanda e tyre, u lodhën dhe më shumë u çoroditën si nga humbjet e shumta ashtu edhe nga shiu që kishte rënë gjatë gjithë ditës, nga nata që po afrohej, por edhe mjegulla që sapo ra. Kapedani dhe strategu i betejës Çerçizi, iu drejtua Zeman Mashkullorës dhe Asllan Starjes: "Vëzhgoni vendin përreth për të gjetur shtegun se nga mund të çajmë rrethimin". Ky ishte një urdhër në kohën dhe vendin e duhur. Zemani si mashkullorët e njihte me pëllëmbë vendin. Propozoi të bënin poshtë përroit dhe ashtu u bë. Çerçizi ndau detyrat: Zemani dhe Mihal të parët, atëherë Çerçizi do të vazhonte zjarrin, Asllan Starja do të merrte në krah Myftarin e plagosur. Myftari u lutej shokëve ta vrisnin, se mos binin në dorë të armikut. Por, Çerçizi i tha: "Po të vdesim ne, aherë do të vdesësh edhe ti, nuk të lëmë në dorë të halldupëve edhe sikur të japim jetën tonë, ti e bërë tënden. Po, bëj kurajo o trim. Pastaj iu drejtua shokëve: Mblidhi forcat, se do çajmë rrethimin". "Gjaku Hajredinit u bëftë dritë, përpara me shpetësi drejt përroit më të poshtë.. përpara nap resin betejë të reja".

Beteja e zhvilluar në një ditë që vesonte shi zgjati nga mënjësi deri në të ngrysur. Mes të ushtarëve osmanë të vrarë ishte dhe kallauzi tradhëtar, që i tregoi osmanëve vendin ku strehohej çeta. Nën udhëheqjen e Çerçizit në zjarr e sipër çeta e çau rrethimin dhe arriti në Kasollet e Dino Çiços, ku shërbente një punëtor i kësaj familje fisnike gjirokastrite, që quhej Shahin. Shahini kishte gatuar fasule dhe, u përgatiti luftëtarëve darken me ç'ju ndodhën. Mihal i lidhi plagën e Myftar Axhemit nga Gjirkastra që u plagos tek hauri, dhe luftëtarët e tjerë thanë rrobat e lagura në zjarrin e kasolles. Pasi u çlodhën dhe u siguruan se osmanët nuk kishin rënë në gjurmë, çeta shkoi në drejtim të Gjirokastrës mbi qytet në malin e Gjerë. Shahini shërbeu si korrier midis çetës dhe njerëzve të konakut të Çerçizit. Takimi i çetës me Banushin, nuk ishte i mundur (Banushi ishte vëllai që kishte lindur midis Bajos dhe Çerçizit). Në këto rrethana Çerçizi vendosi të hynte në qytet, njerëzit nuk i hapnin portën nga frika e askeërve, spiunëve dhe xhandarëve që ishin shpërndarë në qytet. Pasi trokiti në disa shtëpi, Çeçua u prit nga Resul Berberi. Në shtëpinë e tij u bënë takimet me njerëzit e Myftzrit, të cilin e lanë në qytet dhe Çeta shkoi në Dervician tek familja e Thomait dhe pas kësaj në pyllin e Luvinës. Ndihma e popullsisë së Dervicianit, Vanistrës dhe Goranxisë ishte e pakursyer. Stefan Bako nga Bularati, për gati një muaj e gjysëm e mbajtën çetën e Çerçizit me ushqime, veshmbathje e strehim, por edhe me ndërlidhje me komitetin e Gjirokastrës. Polizoi Gjini dhe djali i tij Mihi nga Vanistra ishin korrierë besnikë me vendin e strehimit të çetës. Një miqësi të veçantë kishte familja Topulli dhe djemtë e saj, me Thoma Papapanon etj. Ata i dhanë Çerçizit letrat nga Misiri, Bari, Gjirkastra, Korça, Janina nga shumë patriot shqiptarë, tek të cilët ishte ndezur fuqishëm zjarri i luftës për lirinë dhe pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Është kjo arsyeja që kënga për Çerçizin do t'ju përcillet shekujve: "Milazim largo taborrë/ Se të kuq, të bëj me bojë/Çerçiz Topulli më thonë..". Lufta e Mashkullorës mbetet ende sot, një epope e ndritur e guximit dhe trimërisë shqiptare, ku kapedani i jugut, trimi i paepur Çerçiz Topulli dhe burra me fishekë të numërruar luftuan për një ditë rresht kundër një ushtrie të tërë ushtarëve dhe oficerë akademikë. Kjo betejë pasoi edhe me suksese të tjera në luftimet e zhvilluara në Frashër, Delvinë, Labovë, Shtëpëz, Çepunë, Virua, Lunxhëri, Skërficë etj. Në Gjirokastër, shtëpia e Topullarëve edhe sot qëndron si një kështjellë krenare kombëtare që do t'ju flasë brezave për Bajon, për Çerçizin dhe për çetën e parë të lirisë.

Bibliografia:

- Historia e Popullit Shqiptar, në katër vëllime, Tiranë, 2002-2008.
- Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë. Dokumentat e Vjenës, shkresa dt.04.12.1907.
- Arkivi Qendror i shtetit-Tiranë. Fondi dokumentar 101, dosja 27, fleta 3.
- Arkivi Qendror i shtetit, - Tiranë, Fondi 9, dosja 30, fleta 302.
- Gazeta "Drita" – Sofje, Bullgari, 15.02.1908.
- Mihal Grameno "Kryengritja Shqiptare", faqe 106.
- Bajo Topulli (I ri), "Topullarët e Gjirkastrës, SHB "Albin", Tiranë, 2008.
- J.Dilo "Çerçiz Topulli me shokë", Tiranë 1961, faqe 14.
- Zaho Golemi, Lufta e Mashkullorës, Revista Mbrotjtja, organ i Min.Mbrotjtjes së RSH, 03/2003.

